



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Data	XXXXXXX
Referencë:	
Për:	KPF-Asamblesë Komunale-Deçan
Kopje / CC:	Kryetarit të Komunës, z. Bashkim Ramosaj
Përmes:	DKA-Deçan
Nga:	Komisioni për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal
Tema:	Plani Zhvillimor Komunal i Arsimit 2024/27

PLANI ZHVILLIMOR I ARSIMIT I KOMUNËS SË DEÇANIT 2024-2027

Deçan, Maj 2024

PERMBAJTJA

Fjala e kryetarit te komunës, z. Bashkim Ramosaj

Fjalët kyçe

Hyrja

1.Pershkrim i përgjithshëm i komunës

2.Përshkrim i përgjithshëm për sistemin arsimor të Kosovës

3.Arsyeshmëria e e planit (PZHAK)

4. Te dhëna rreth Drejtorisë Komunale të Arsimit

5. Metodologjia

6.Deklarata e vizionit dhe misionit

7.Konteksti i planifikimit zhvillimor

8.Plani zhvillimor i arsimit në komunë është i lidhur me planet e tjera të përgatitura nga komuna dhe me akteret tjerë të interesit:

8.1. Planet zhvillimore të shkollave;

8,2 Plani Zhvillimor Komunal;

8.3. Korniza afat-mesme e shpenzimeve (kash) të planeve zhvillimore të shkollave.

9.Përmbledhja grafike e Planit Zhvillimor Komunal

10.Prioritetet, rezultatet dhe masat: detajet

11.Plani Zhvillimor i Arsimit – plani i burimeve

12. Përmbledhja e prioriteteve të shkollave

13.Prioritetet tjera të arsimit në komunë

14.Raporti mbi planin e vitit paraprak.

Shtojca

Referenca

FJALA E KRYETARIT TË KOMUNËS SË DEÇANIT Z. BASHKIM RAMOSAJ

Fjala Hyrëse

Të dashur nxënës, të nderuar mësimdhënës dhe prindër të komunës së Deçanit,

Dokumenti që ju mbani në duar, “PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL I ARSIMIT NË KOMUNËN E DEÇANIT 2024-2027”, paraqet një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të cilësisë dhe gjithëpërfshirjes në sektorin e arsimit parauniversitar në komunën tonë. Ky plan strategjik është bazuar në dokumente të rëndësishme që rregullojnë arsimin në Republikën e Kosovës dhe merr parasysh specifikat e komunës së Deçanit. Qëllimi ynë përfundimtar është realizimi i vizionit dhe misionit tonë për një edukim dhe arsimim të barabartë dhe të përshtatshëm me standardet e shekullit 21.

Përgatitja e këtij dokumenti strategjik ka qenë një proces sfidues që kërkonte përkushtim të madh në mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, si dhe në propozimin e zgjidhjeve të detajuara që na çojnë drejt përmirësimit të sistemit arsimor në komunën tonë. Angazhimi, kontributi dhe pjesëmarrja në këtë proces kanë qenë të jashtëzakonshme dhe falënderojmë të gjithë aktorët e përfshirë: mësimdhënësit, drejtorët e shkollave, specialistët e fushës së arsimit, urbanizmit, financave, zyrtarët e arsimit nga DKA dhe përfaqësuesit e prindërve.

Ky dokument strategjik është një udhërrëfyes për mënyrën se si duam të edukojmë brezat e rinj dhe për nivelin që duam të arrijmë në të ardhmen e afërt. Ai është gjithmonë i bazuar në kërkesat e shoqërisë dhe të kohës, duke u krahasuar me nivelet regjionale dhe evropiane. Kjo është një ngjarje e rëndësishme për arsimin në komunën e Deçanit.

Një element kyç i këtij plani është digjitalizimi i arsimit, që synon të integrojë teknologjinë moderne në procesin mësimor dhe administratë për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënies. Duke pajisur shkollat me infrastrukturë digjitale dhe duke trajnuar mësimdhënësit për përdorimin efektiv të mjeteve teknologjike, synojmë të krijojmë një mjedis arsimor që reflekton kërkesat e shekullit 21 dhe i përgatit nxënësit për sfidat e së ardhmes.

Uroj dhe njëkohësisht kërkoj që tani e tutje, të gjithë së bashku të angazhohemi për të vënë në jetë këtë Plan Zhvillimor për arsimin në komunën tonë, për të mirën e përgjithshme dhe, me theks të veçantë, për të mirën e fëmijëve tanë.

Me respekt i juaji:
Bashkim Ramosaj

Maj, 20, 2024 Deçan

LISTA E SHKURTESAVE TË PËRDORURA

BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
FNV	Fëmijët me Nevoja të Veçanta
IEAA	Institucionet edukative-arsimore dhe aftësuese
IP	Institucioni parashkollor
IPK	Instituti Pedagogjik i Kosovës
KC	Koordinatori i Cilësisë
KDSH	Këshilli Drejtues i Shkollës
KKK	Korniza e Kurrikulit të Kosovës
LLL	Mësimi gjatë gjithë jetës
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe inovacionit
MVP	Mësimi në Vendin e Punës
DUAL	Mësimi Dual
N/A	Nuk aplikohet
OS	Objektiv Strategjik
PSAK	Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës
PZHA	Plani Zhvillimor i Arsimit
PZHS	Plan Zhvillimor i Shkollës
QNP	Qendrat për Ngritje Profesionale
SHFMU	Shkolla fillore dhe e mesme e ulët
SHML	Shkolla e mesme e lartë
SMIA	Sistemi për Menaxhimin e Informatave në Arsim
SWOT	Sukseset, Dobësitë, Mundësitë, Rreziqet
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe e Komunikimit
ZHPM	Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve
ZHPM-BSH	Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve me Bazë në Shkollë

HYRJE

Nisma për Planin Zhvillimor të Arsimit në Komunën e Deçanit erdhi nga Kryetari i Komunës, z. Bashkim Ramosaj, si pjesë e planit qeverisës për zhvillimin dhe ngritjen e cilësisë së arsimit në komunën tonë.

Ky plan synon të zbatojë Planin Strategjik të Arsimit të Kosovës 2022-2026 si udhëzues për të avancuar arsimin parauniversitar në Deçan, duke u bazuar në kornizën ligjore të Arsimit në Republikën e Kosovës si, Ligji për Arsimin Parauniversitar në Kosovë, Strategjinë për Sigurimin Cilësisë, Strategjinë së Dixhitalizimit dhe Planin Zhvillimor të Arsimit në Deçan për periudhën 2019-2022 si dhe Planin Zhvillimor Komunal.

Plani Zhvillimor Komunal i Arsimit për komunën e Deçanit shërben si një implementim praktik i strategjisë së arsimit të Kosovës për periudhën 2022-2026. Bazuar në strategjinë e arsimit të Kosovës, ky plan ka për qëllim të përparojë arsimin në nivel lokal duke u përqendruar në disa shtylla themelore të strategjisë që janë identifikuar për të përmirësuar cilësinë dhe qasjen në arsim në nivel kombëtar.

Nevoja për këtë plan u shfaq pas suksesit të PZHAK 2019-22, i cili është realizuar në masën mbi 90%. Synimi kryesor është përmirësimi i cilësisë së arsimit në komunën tonë. Ky plan, i hartuar nga DKA-ja, identifikon prioritetet dhe objektivat për të përmbushur qëllimet afatmesme të arsimit.

Bazuar në analizën e situatës së tanishme në Deçan, me këtë plan synojmë të përcaktojmë prioritetet për zhvillimin e arsimit parauniversitar në periudhën 2024-2027, duke u koordinuar politikatat arsimore të Qeverisë së Kosovës me prioritetet zhvillimore lokale. Ky plan përmban qëllimet e komunës për të siguruar arsim cilësor dhe gjithpërfshirës, në përputhje me ligjin dhe strategjitë për zhvillimin e arsimit.

Ky plan do të shërbejë si një instrument për të siguruar se Deçani po përmbush përpjekjet dhe objektivat e strategjisë së arsimit të Kosovës për të avancuar arsimin dhe për të përgatitur nxënësit për sfidat dhe mundësitë e së ardhmes. Nëpërmjet një implementimi efektiv të Planit Zhvillimor Komunal, komuna e Deçanit është në rrugën e duhur për të arritur standarde më të larta të cilësisë në arsim dhe për të kontribuar në zhvillimin e arsimit në nivel lokal dhe kombëtar.

1. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I KOMUNËS



Deçani është një komunë në pjesën perëndimore të Kosovës, me një sipërfaqe prej 180km² dhe 37 fshatra, përfshirë edhe qytetin. Sipas regjistrimit të vitit 2011, numri i banorëve rezidentë të Deçanit është rreth 40,847 qytetarë. Si njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës, Komuna e Deçanit ofron shërbime komunale përmes 11 Drejtorive të ndryshme. Kuvendi i komunës përbëhet nga 27 asamblistë dhe organet kryesore janë Kuvendi i Komunës dhe Kryetari. Këto organe marrin masa dhe miratojnë akte për zbatimin e tyre, në përputhje me fushën e tyre të kompetencave, duke respektuar sistemin kushtetues dhe ligjor të Republikës së Kosovës.

Sipas Statutit të komunës, Kryetari bën debat me qytetarët dy herë në vit. Komuna e Deçanit njihet për transparencën e saj në shërbimet dhe projektet për qytetarët dhe zbaton Planin e Veprimit për Transparencë. Për të siguruar transparencën dhe informacionin e nevojshëm për qytetarët, ofrohet një faqe interneti të dedikuar, ku publikohen informacione të rëndësishme dhe zhvillimet e fundit në nivel komunal.

2. PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I SISTEMIT TË ARSIMIT NË KOSOVË

Arsimimi parauniversitar dhe parashkollor, organizohet përmes një kornize të mësimi tërë jetësor, sipas niveleve të ISCED-it si vijon dhe në pajtim me fazat kryesore të Kornizës Kombëtare të Kurrikulit:

1.1. niveli 0: Arsimi parashkollor -0 deri ne 5 vjeç

1.2. niveli 1: Arsimi fillor: nga klasa I deri ne klasën V

1.3. niveli 2: Arsimi i mesëm i ulët: nga klasa V deri ne klasën IX

1.4 . Arsimi i mesëm i lartë:

1.4.1 niveli 3: Shkollat profesionale (klasat X-XI)

1.4.2. niveli 4: Arsimi i mesëm i lartë Gjimnazi klasa X-XII, Shkollat profesionale (klasat X-XII)1.5

3. ARSYESHMËRIA E PLANIT ZHVILLIMOR TË ARSIMIT NË KOMUNËN E DEÇANIT (PZHAK)

Plani Zhvillimor Komunal i Arsimit është një iniciativë e destinuar për të përmirësuar arsimin në territorin e komunës së Deçanit, me një theks të veçantë për Drejtorinë Komunale të Arsimit. Synimi ynë përmes këtij plani është të realizojmë objektivat e zhvillimit të arsimit në komunën tonë.

Një nga pikat kryesore të këtij plani është bashkëpunimi i ngushtë me të gjithë aktorët e përfshirë në sistemin arsimor, përfshirë drejtorët e shkollave, mësimdhënësit, nxënësit, prindërit dhe komunitetin në tërësi. Duke konsideruar Planin Zhvillimor të Arsimit Komunal si një dokument orientues për organizimin, zhvillimin dhe sigurimit të cilësisë, duke na obliguar për një mbikëqyrje të vazhdueshme për të qenë në përputhje me Planin Strategjik të Arsimit 2022-2026, zhvillimet bashkëkohore dhe trendët evropiane.

Kjo strategji nxit bashkëpunimin dhe përfshirjen e të gjithë aktorëve të arsimit në procesin e hartimit dhe zbatimin e politikave arsimore, duke siguruar kështu një qasje të përbashkët drejt përmirësimit të cilësisë së arsimit në komunën tonë. Nëpërmjet këtij plani, synojmë të krijojmë një mjedis arsimor të përshtatshëm dhe të stimulojmë zhvillimin e aftësive dhe potencialeve të të gjithë nxënësve në komunitetin tonë.

Statistikat: Tabela 1. Numri i institucioneve arsimore sipas niveleve dhe numri i vijuesve sipas niveleve 2024

Niveli i shkollimit	Numri i institucioneve	Numri i përgjithshëm i fëmijëve, nxënësve të regjistruar
Edukimi parashkollor (0-5)	2 institucion privat i licencuar	78
Edukimi parafillor (5-6)	18-- shkolla amë 4-- paralele të ndara fizike	377
Edukimi fillor (6-11)	18-- shkolla amë 4-- paralele të ndara fizike	1854
Edukimi i mesëm i ulët (11-15)	18--shkolla amë 1--paralele të ndara fizike	1614
Edukimi i mesëm i lart (15-18)	1--shkolla gjimnaz 1-- shkolla e mesme teknike	504 419
		4846 nxënës

Tabela 2. Numri i personelit ne institucionet shkollore 2024

		REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIC OF KOSOVO REPUBLIKA KOSOVA		KOMUNA E DECANIT MUNICIPALITY OF DECAN OPSTINA DECAN															
	shkolla	Gjith	Mësimdhënës	Fillor	eduk	Mesazlet	ar spec	koord	glangl	Drejtorët	Zv dr	Sekretar	biblioteki	pedagog	Psikolog	asistentë	PT		
1	Gjimnazi "Vëllezërit Frashëri"	61	45					1	4	1	1	1		1	1		10		
2	IAAP "Tafil Kasumaj"	47	38					1	2	1		1		1			6		
3	"Lidhja e Prizrenit"	74	56	22	5	29	1	1	4	1	1	1	1		1	2	11		
4	"Isa Boletini"	45	34	15	2	16		1	3	1		1		1		2	6		
5	"Bajram Curri"	31	23	10	2	11		1	2	1		1				1	5		
6	"Drita"	20	14	5	1	8		1	1	1		1	1				3		
7	"Dëshmorët e Kombit"	20	14	5	1	8		1	1	1		1				1	3		
8	"Jusuf Gërvalla"	34	26	11	1	14		1	2	1		1				1	5		
9	"Sylë Alaj"	24	18	10	1	7		1	1	1		1					4		
10	"Heronjtë e Dukagjinit"	20	14	5	1	8		1	1	1		1					4		
11	"Lan Selimi"	26	22	10	1	11		1	2	1							3		
12	"Maxhun Çekaj"	20	14	5	1	8		1	1	1					1		5		
13	"Sylejman Vokshi"	19	13	5	1	7		1	1	1		1				1	2		
14	"Dëshmorët e Vokshit"	18	14	5	1	8		1	1	1							3		
15	"Ardhmëria"	18	14	5	1	8		1	1	1						1	2		
16	"Falk Konica"	19	15	5	1	9		1	1	1							3		
17	"Esad Mekuli"	17	13	5	1	7		1	1	1							3		
18	"Kuvëndi i Verrave të Ulukës"	16	11	5	1	5		1	1	1					1	1	2		
19	"Dëshmorët e Baballoqit"	17	14	5	1	8		1	1	1							2		
20	"Rexhep Kadriaj"	21	15	5	1	9		1	1	1						1	3		
		567	427	138	24	181	1	20	32	20	2	11	2	3	4	11	85		

4. TE DHËNA RRETH DREJTORISË KOMUNALE TË ARSIMIT

Drejtoria Komunale e Arsimit në Deçan mbështet të gjitha detyrat e saj organizative në përputhje me kompetencat, ligjet, udhëzimet administrative dhe rregulloret komunale, PZHAK-në dhe PZSHH-në. Ajo ofron dhe menaxhon institucionet edukativo-arsimore parauniversitare publike dhe private, për të gjitha nivelet arsimore.

DKA në Deçan ka 7 punonjës, përfshirë drejtorin. Pozitat e mbajtura nga secili zyrtar janë: Udhëheqësi i zyrës së arsimit, Zyrtari i arsimit parafillor, fillor dhe arsimit të mesëm të ultë, Zyrtari i arsimit të mesëm të lartë, Zyrtari ligjor, Zyrtari për zotime dhe buxhet dhe Koordinator i Qendrës për Ngritjen Profesionale.

Në kuadër të DKA-së funksionojnë edhe ekipet profesionale si:

- Ekipi për parandalim, braktisje dhe mos-regjistrim.
- Ekipi për vlerësim të fëmijëve me nevoja të veçanta.
- Ekipi profesional për zbatimin e KKK.
- Ekipi i task forcës për menaxhimin e rasteve emergjente.

si dhe:

- Koordinator i Kurrikulës në nivel komunal.
- Koordinator i cilësisë në nivel komunal.
- Shërbimi pedagogjik dhe psikologjik në nivel Komunal.

5. METODOLOGJIA

Metodologjia e punës për hartimin e Planit Zhvillimor të Arsimit për Komunën e Deçanit bazohet në analizën e gjendjes faktike duke përdorur: analizën SWOT, listat e kontrollit, krahasimin e dokumenteve (PZSHH të shkollave, PZHK, Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, planin Strategjik të Arsimit Parauniversitar të Kosovës, KKK). Ky Planin Zhvillimor Komunal mbështetet në objektivat strategjike kombëtare dhe është zhvilluar në pesë prioritetë që lidhen me pesë fushat e cilësisë dhe parimet e KKK.

Fushat e Cilësisë:

1. Udhëheqja dhe menaxhimi,
2. Kultura dhe mjedisi shkollor,
3. Zhvillimi profesional i mësimdhënësve,
4. Mësimdhënia dhe mësimnxënia,
5. Performanca e nxënësve.

Parimet e KKK-së:

1. Gjithëpërfshirja,
2. Zhvillimi i kompetencave,
3. Mësimdhënia dhe të nxëniet e integruar dhe koherente,
4. Autonomia dhe fleksibiliteti,
5. Përgjegjësia dhe llogaridhënia.

Procesi i hartimit të PZHAK u zhvilluar në katër faza kryesore:

Faza 1: Analiza e gjendjes ekzistuese

- U analizuan dokumentet e politikave, legjislacioni dhe raportet relevante.
- DKA ofroi të dhëna për institucionet arsimore para-universitare dhe planet tjera zhvillimore në komunë.

Faza 2: Përcaktimi i objektivave strategjike dhe pritoriteteve

Grupi punues për hartimin e PZHAK, ka përcaktuar katër objektiva dhe pesë pritoritete, të dhëna në vijim:

Objektivat e PZHAK-së janë:

- 5.1. Objektivi Strategjik 1 – Edukimi në fëmijërinë e hershme
- 5.2. Objektivi Strategjik 2 – Arsimi parauniversitar
- 5.3. Objektivi Strategjik 3 – Arsimi, aftësimi profesional dhe arsimi për të rritur
- 5.4. Objektivi Strategjik 4 – Digjitalizimi i arsimit

Prioritetet: PZHAK-së janë:

- Prioriteti 1: Sigurimi dhe zhvillimi i cilësisë
- Prioriteti 2: Zbatimi i kurrikulës së re e bazuar në kompetenca
- Prioriteti 3: Menaxhimi dhe udhëheqja cilësore në arsim
- Prioriteti 4: Gjithëpërfshirja në arsim
- Prioriteti 5: Ambiente të përshtatshme shkollore

Faza 3: Hartimi i planit të veprimit dhe buxhetit

Përgatitja e këtij plani punohet në bashkëpunim me zyrtarët e komunës dhe grupin punues për të hartuar planin e veprimit dhe buxhetimin për periudhën trevjeçare, duke përcaktuar burimet e financimit dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin.

Faza 4: Hartimi i dokumentit përfundimtar të PZHAK

Pas përgatitjes së dokumenteve, drafti përfundimtar do të shqyrtohet nga palët me interes, do të vendoset në diskutim publik dhe pas vërejtjeve dhe komenteve do të dërgohet në Kuvendin Komunal për aprovim.

6. DEKLARATA E VIZIONIT DHE MISIONIT

6.1 DEKLARATA E VIZIONIT

Deçani, një shoqëri e dijes, e përkushtuar për arsim cilësor dhe zhvillimin e potencialit të secilit nxënës dhe individ bazuar në konceptin e mësimi gjatë gjithë jetës, për një shoqëri demokratike dhe përmirësimit të mirëqenies së qytetarëve të Komunës së Deçanit.

6.2 DEKLARATA E MISIONIT

Komuna e Deçanit synon të përmirësojë cilësinë e arsimit duke siguruar hapësira shkollore të përshtatshme dhe të mirë-pajisura, si dhe duke përkrahur mësimdhënësit për mirë-përgatitje dhe në motivimin e tyre. Po ashtu, angazhohet për gjithpërfshirje dhe rritjen e përfshirjes së fëmijëve në arsimin parashkollor dhe nxënësve në edukimin fillor dhe të mesëm, duke ngritur cilësinë e arsimit dhe fuqizuar mekanizmat e përgjegjësisë dhe llogaridhënies.

7. KONTEKSTI I PLANIFIKIMIT ZHVILLIMOR

Objektivat strategjike të Planit Zhvillimor të Arsimit 2024-2027 në Komunën e Deçanit synojnë përmbushjen e vizionit dhe misionit për zhvillimin e arsimit. Plani përmban katër objektiva strategjike sipas fushave të intervenimit, të dhëna në tabelën vijuese.

Fushat e intervenimit	Objektivi strategjik
1. Edukimi në fëmijërinë e hershme	Rritja e përfshirjes dhe qasje e barabartë në edukimin në fëmijërinë e hershme.
2. Arsimi parauniversitar	Ngritja e cilësisë së arsimit parauniversitar përmes konsolidimit të mekanizmave për sigurimin e cilësisë dhe ofrimin e mësimdhënies cilësore.
3. Arsimi, aftësimi profesional dhe arsimi për të rritur	Harmonizimi i arsimit dhe aftësimit profesional me zhvillimet dinamike të teknologjisë dhe tregut të punës, në funksion të mësimi gjatë gjithë jetës.
4. Digjitalizimi i arsimit	Përdorimi i teknologjisë digjitale për përmirësimin e shërbimeve dhe të cilësisë në arsim, në përputhje me trendet e transformimit digjital.

Fusha e intervenimit 1: – Edukimi në fëmijërinë e hershme.

Objektivi i përgjithshëm: Rritje e përfshirjes dhe qasje e barabartë në edukimin në fëmijërinë e hershme.

Në komunën tonë, çështjet kyçe për këtë periudhë janë:

- Rritja progresive e përfshirjes së fëmijëve në nivelin parashkollor (0 deri në 5 vjeç): Nga 10% sa është tani, synojmë të arrijmë deri në 60%.
- Zgjerimi i numrit të çerdheve: Aktualisht kemi një çerdhe publiko-private dhe një private. Plani ynë është të ndërtojmë dhe adaptojmë gjashtë çerdhe të reja në lokacionet e mëposhtme: Deçan, Isniq, Strellc i Epërm, Irzniq, Gramaqel, Dranoc.

Sfidat:

Mungesa e çerdheve publike, kultura familjare, infrastruktura e pamjaftueshme, papunësia dhe fondet e pamjaftueshme janë faktorë që ndikojnë negativisht në rritjen e përfshirjes në edukimin parashkollor për fëmijët e moshës 0-5 vjeç.

Fusha e intervenimit 2: – Arsimi parauniversitar

Objektivi i përgjithshëm: Ngritja e cilësisë së arsimit parauniversitar përmes konsolidimit të mekanizmave për sigurimin e cilësisë dhe ofrimin e mësimdhënies cilësore.

Në komunën tonë, çështjet kyçe janë:

- Ndërtimi, funksionalizimi dhe monitorimi i ekipeve për sigurimin e cilësisë dhe ofrimin e mësimdhënies cilësore.
- Rritja e bashkëpunimit dhe menaxhimit më efektiv për sigurimin e cilësisë: përfshirja e SIA, DKA, shkollave, komunitetit, QPS, QKMF, policisë, bizneseve dhe OJQ-ve.
- Krijimi i mundësive për ofrimin e arsimit parauniversitar për të rritur. Kjo do t'u mundësojë qytetarëve të Deçanit përgatitje për jetën dhe arsimim të vazhdueshëm.
- Fillimi i procedurave për riorganizimin e rrjetit shkollor në nivel komunal që bazohet në raportet e rregullta të SMIA-së për numrin e nxënësve dhe ligjet në fuqi.

Sfidat:

Mungesa e buxhetit, mungesa e koordinimit dhe bashkëpunimit me akterët e mundshëm, rënia e vazhdueshme e numrit të nxënësve në të gjitha nivelet, teprica teknologjike e numrit të mësimdhënësve, qasja konservative e komunitetit ndaj ndryshimeve në riorganizimin e rrjetit shkollor dhe mungesa e ofrimit të arsimit për të rritur-janë sfidat kryesore që përballet komuna jonë në fushën e arsimit.

Fusha e intervenimit 3: – Arsimi, aftësimi profesional dhe arsimi për të rritur

Objektivi i përgjithshëm: Harmonizimi i arsimit dhe aftësimit profesional me zhvillimet dinamike të teknologjisë dhe tregut të punës, në funksion të mësimin gjatë gjithë jetës.

Në komunën tonë, çështjet kyçe janë:

- Nevoja e përputhjes së ofertës arsimore me kërkesat e tregut të punës.
- Identifikimi dhe planifikimi i nevojave për zhvillim të vazhdueshëm profesional të mësimdhënësve, duke përdorur burimet njerëzore brenda shkollës, komunës dhe më gjerë.
- Krijimi i mundësive për ofrimin e arsimit dhe aftësimit profesional për të rritur, për t'u përgatitur për jetë dhe punë.

Sfidat:

Mungesa e buxhetit, mungesa e trajnimeve, mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme për zhvillimin dhe sigurimin e cilësisë, si dhe mundësitë e kufizuara për punë praktike të nxënësve.

Fusha e intervenimit 4:– Digjitalizimi i arsimit

Objekti i përgjithshëm: Përdorimi i teknologjisë digjitale për përmirësimin e shërbimeve dhe të cilësisë në arsim, në përputhje me trendët e transformimit digjital.

Në komunën tonë, çështjet kyçe janë:

- Krijimi dhe funksionalizimi i një platforme digjitale gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme për fushën e arsimit në komunë.
- Përgatitja dhe prodhimi i materialeve mësimore digjitale të cilësisë së lartë dhe të përshtatshme për nivelet e ndryshme, klasat dhe lëndët.
- Sigurimi i aksesit në rrjetet e internetit cilësor dhe pajisjeve teknologjike të nevojshme për shkollat.
- Krijimi i mekanizmave institucionalë që mundësojnë implementimin dhe mbikëqyrjen e përdorimit të teknologjisë në arsim me një qasje të qëndrueshme dhe efikase.

Sfidat:

Shërbimet digjitale të pa mjaftueshme, nivel i ulët i përdorimit të teknologjisë digjitale, mungesa e kapaciteteve profesionale për digjitalizim, dhe mungesa e mekanizmave për mbikëqyrjen dhe mirëmbajtjen e pajisjeve teknologjike.

SWOT Analiza për Arsimin në Komunën e Deçanit:

Forcat	Dobësitë
Përmirësimi i infrastrukturës shkollore dhe krijimi i qendrave të reja të arsimit parashkollor do të ndihmojë në rritjen e përfshirjes së fëmijëve në edukimin parashkollor. Angazhimi për të krijuar një marrëdhënie më të fortë mes komunitetit dhe institucioneve arsimore mund të ndihmojë në zgjidhjen e sfidave të kulturës familjare dhe në rritjen e përfshirjes në arsimin parashkollor. Përpjekjet për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe krijimi i mundësive për arsimim të vazhdueshëm për të rritur mund të kontribuojnë në përmirësimin e burimeve	Mungesa e burimeve financiare dhe infrastrukturës së mjaftueshme mund të bëjë të vështirë realizimin e objektivave për rritjen e përfshirjes në arsimin parashkollor dhe për ngritjen e cilësisë së arsimit parauniversitar. Koordinimi i dobët mes institucioneve arsimore dhe mungesa e bashkëpunimit efektiv mund të krijojë pengesa në përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe në arritjen e objektivave për aftësim profesional dhe arsim për të rritur. Mungesa e infrastrukturës digjitale dhe kapaciteteve për digjitalizimin mund të

njerëzore dhe të sigurojnë një fuqi punëkërkuuese më të aftë për tregun e punës në të ardhmen.	kufizojë përparimin e arsimit në përputhje me trendet e transformimit digjital në arsim. Mungesa së informimit të mjaftueshëm për përfitimet e arsimit profesional, si dhe perceptimeve të gabuara për këto programe.
Mundësitë Mundësitë për ndërtimin e qerëdheve të reja dhe për rritjen e ofertës së arsimit për të rritur mund të krijojnë ambiente të reja për arsim dhe punësim në komunitet. Zhvillimi profesional i mësimitdhënësve me bazë në shkollë. Përmirësimi i bashkëpunimit mes institucioneve arsimore dhe partnerëve të tjerë komunitarë mund të hapë rrugën për inovacion dhe përmirësim të proceseve arsimore. Zhvillimi i një platforme digjitale dhe prodhimi i materialeve mësimore digjitale mund të përshpejtojë përparimin e arsimit dhe të sigurojë një qasje më efektive në mësimitdhënie dhe mësim-njësim. Përmirësimi i këshillimit për karrierë dhe promovimi i profileve profesionale mund të ndihmojnë në rritjen e interesit të nxënësve. Bashkëpunimi më i ngushtë me bizneset dhe institucionet e tjera mund të ndihmojë në sigurimin e mundësive të praktikës për nxënësit.	Kërcënimet Mungesa e buxhetit për trajnime për ZHPM me bazë në shkollë. Mungesa e fushatave vetëdijësuese për rritjen e përfshirjes së fëmijëve në arsimin parashkollor. Kultura konservatore dhe rezistenca ndaj ndryshimeve në komunitet mund të krijojë pengesa në implementimin e reformave arsimore dhe në përshtatjen me trendet e arsimit modern. Mungesa e buxhetit për dixhitalizim dhe për pajisje të shkollave me mjete didaktike. Mungesa e koordinimit të drejtorë të shkollave me akteret e brendshëm dhe të jashtëm . Mungesa e trajnimeve dhe kapaciteteve për digjitalizim mund të paraqesë kufizime në përdorimin efektiv të teknologjisë në arsim dhe në përfitimin e përparësive të saj për mësimitdhënien dhe mësim-njësimin. Mungesa e përkrahjes nga MASHTI dhe donatorët për zbatimin e kurrikulës ka penguar përparimin e sistemit arsimor. Kjo mungesë mbështetjeje ndikon negativisht në cilësinë e arsimit, duke kufizuar burimet dhe mundësitë për përmirësime. Mungesa e interesimit të nxënësve për t'u regjistruar në profilet e arsimit profesional është një tjetër sfidë e rëndësishme. Mosrealizimi i duhur i praktikës profesionale për Arsimin dhe Aftësimin Profesional (AAP) është një pengesë e madhe për zhvillimin e aftësive praktike të nxënësve.

8. PLANI ZHVILLIMOR I ARSIMIT NË KOMUNË

PZHAK 2024-2027 është zhvilluar në përputhje me planet tjera të përgatitura nga Komuna dhe interesave me akterët tjerë.

8.1 Planet Zhvillimore të Shkollave

Çështjet kryesore nga planet zhvillimore të shkollave parashohin.	Te planet zhvillimore të shkollave: pesë fushat e cilësisë; - Menaxhimi dhe qeverisja, - Kultura dhe mjedisi shkollor, - Mësimdhënia dhe mësimnxënia, - Zhvillimi profesional i mësimdhënësve, performanca e nxënësve) dhe Parimet e Kurikulës: - gjithëpërfshirja, - zhvillimi i kompetencave, - mësimdhënia dhe mësimnxënia e integruar, - autonomia dhe fleksibiliteti, - përgjegjësia dhe llogaridhënia), - harmonizimi i PZSHS-së me PZHK-në dhe PSAK-në 2024-2027.
--	--

8.2 Plani Zhvillimor Komunal

Plani afatgjatë zhvillimor komunal parasheh këto zhvillime në sektorin e arsimit.	- Sigurimi dhe zhvillimi i vazhdueshëm i cilësisë në arsim. - Digjitalizimi në Arsim - Zbatimi e KKK-së - Menaxhimi i sistemit arsimor - Ambiente të përshtatshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies - Gjithëpërfshirja në arsim.
--	---

9. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH)

KASH-i shikon përpara për burimet në dispozicion për sektorin e arsimit dhe në vitin 2024 buxheti ynë bazë i planifikuar është Grandi specifik 4 611 056.00€ Grandi i përgjithshëm për DKA 72 743.30 € Totali GS+GP:4 683 799.30 €	Tabela 2. Buxheti për arsimin parauniversitar në vitin 2024.
--	---

Burimet	Arsimi fillor dhe i mesëm	Pagat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shërbimet komunale	Te hyrat vetanake	Shpenzimet kapitale	Gjithsejtë
Granti specifik i arsimit	Arsimi fillor	3 523 487.00	96 164.00	21 500.00	/	34 776.00	3 675 927.00 €
Granti i përgjithshëm	/	/	/	/	/	/	/
Granti specifik i arsimit	Arsimi i Mesëm	856 520.00	68 609.00	10 000.00	/	/	935 129.00 €
Granti i përgjithshëm	/	/	/	/	/	/	/
Granti i përgjithshëm	Adminis trata e arsimit (DKA)	57 743.30 €	15 000.00 €	/	/	/	72 743.30 €
Total Buxheti 2024		4 437 750.30	179 773.00	31 500.00	/	34 776.00	4 683 799.30 €

Tabela 2. Buxheti për arsimin parauniversitar në vitin 2024

10. PRIORITETET, REZULTATET DHE MASAT: DETAJET

Hartimi i Planit Zhvillimor të Arsimit në Komunën e Deçanit për periudhën 2024-2027 përqendrohet në pesë prioritet kryesore, të cilat janë thelbësore për përmirësimin dhe avancimin e sistemit arsimor në nivel komunal. Këto prioritet janë:

Prioriteti - 1 Sigurimi dhe zhvillimi i cilësisë	Prioriteti - 2 Zbatimi i kurrikulës së re e bazuar në kompetenca	Prioriteti - 3 Menaxhimi dhe udhëheqja cilësore në arsim	Prioriteti - 4 Ambiente të përshtatshme shkollore	Prioriteti - 5 Gjithëpërfshirja në arsim
Rezultati 1: Sistemi efikas për vlerësim të shkollës	Rezultati 1: Mbështetja e vazhdueshme e kapaciteteve dhe mekanizmave për zbatim dhe monitorim të KKK	Rezultati 1: Zhvillimi i kapaciteteve për menaxhim efektiv dhe të përgjegjshëm të sistemit në nivelin komunal	Rezultati 1: Infrastruktura shkollore bashkëkohore	Rezultati 1: Rritja e përfshirjes së fëmijëve në edukimin parashkollor
Rezultati 2: Përmirësim i vazhdueshëm i cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies	Rezultati 2: Rritja e bashkëpunimit Shkollë profesionale – me tregun e punës	Rezultati 2: Qeverisje, udhëheqje dhe menaxhim cilësor në të gjitha nivelet e arsimit	Rezultati 2: Digjitalizimi i shkollave	Rezultati 2: Përfshirje më e lartë e fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin arsimor parauniversitar
Rezultati 3: Vlerësimi i performancës së shkollës			Rezultati 3: Pajisja e kabineteve shkollore në funksion të mësimi praktik	Rezultati 3: Integrimi i nxënësve të komuniteteve pakicë
Rezultati 4: Zhvillimi profesional i mësimdhënësve	Rezultati 3: Realizimi i praktikës profesionale në ndërmarrje	Rezultati 3: Përgatiten dhe publikohen raporte të rregullta të bazuara në analiza dhe interpretim të të dhënave		Rezultati 4: Zhvillim profesional të mësuesve në kuadër të dixhitalizimit të arsimit
Rezultati 5: Ngritja e suksesit të nxënësve				

Prioriteti 1: Prioriteti - Sigurimi dhe zhvillimi i cilësisë

Rezultatet:	Çfarë veprimi do të ndërmerrni për të arritur ato rezultate?	Si do të dini nëse e keni arritur rezultatin?
Rezultati 1: <i>Sistemi efikas për vlerësim të shkollës</i>	1.1. Trajnimi i KC të shkollave 1.2. Trajnimi i drejtorëve të shkollave, në programe shtesë për udhëheqje në arsim.	1.1., 1.2. Në bazë të dëshmive për programin e trajnimeve dhe certifikatave .
Rezultati 2: <i>Përmirësim i vazhdueshëm i cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies</i>	2.1.Përkrahja e koordinatorëve të cilësisë me bazë në shkollë 2.2.Fuqizimi i aktiveve profesionale në shkolla, për mbështetjen e mësimdhënësve me përkrahjen e mentorëve. 2.3.Pajisja e shkollave me kabinete dhe laboratorë. 2.4.Sigurimi i qasjes në internet i të gjitha shkollave. 2.5.Trajnimi i mësimdhënësve bazuar në nevojat për zhvillim profesional të mësimdhënësve.	2.1. Raportet e koordinatorëve të cilësisë në nivel shkollë. 2.2. Raportet e Kryetarëve të Aktiveve profesionale 2.3,4,5. Evidentimi dhe raportimi i gjendjes nëpër shkolla.
Rezultati 3: <i>Vlerësimi i performancës së shkollës</i>	3.1. Formimi i ekipeve për VBSH-së, në të gjitha shkollat ku janë të trajnuara. 3.2. Realizimi i vlerësimit të performancës së shkollave dhe ndërmarrja e masave për përmirësimin e cilësisë .	3.1. Monitorimi i vazhdueshëm i dosjeve të vlerësimit të shkollës. 3.2. Pyetësor, Intervista, Lista kontrollit.
Rezultati 4: <i>Zhvillimi profesional i mësimdhënësve</i>	4.1. Ndërtimi i mekanizmave për zhvillim të vazhdueshëm profesional (zhvillimi profesional me bazë në shkollë dhe nivel komunal). 4.2. Identifikimi i nevojave për zhvillim profesional të mësimdhënësve. 4.3. Trajnimi mësimdhënësve për zbatim të KKK-së dhe programeve tjera.	4.1.Dëshmi, Portfolio etj. 4.2 Raport nga shkolla. 4.3.Raportet e Trajnimeve.

Rezultati 5: <i>Ngritja e suksesit të nxënësve</i>	5.1. Zbatimi i mësimi plotësues, mësimi shtesë dhe mësimi në një ndërrim në shkolla. 5.2. Organizimi i garave në nivel shkolle dhe komune. 5.3 Shpërblimi i nxënësve fitues në gara të nivelit komunal dhe nacional.	5.1, 2. Raportet nga shkollat dhe DKA-ja. 5.3. Mirënjohje, shpërblim dhe përkrahje në forma te ndryshme...
---	--	---

Prioriteti 2: Zbatimi i kurrikulës së re e bazuar në kompetenca

Rezultatet:	Çfarë veprimi do të ndërmerri për të arritur ato rezultate?	Si do të dini nëse e keni arritur rezultatin?
Rezultati 1. Mbështetja e vazhdueshme e kapaciteteve dhe mekanizmave për zbatim dhe monitorim të KKK	1.1. Përkrahja e KC-ve dhe KMB-ve për mbështetje të shkollave në zbatimin e KKK-së, nga DKA-ja. 1.2. Mentorim dhe monitorim i vazhdueshëm i shkollave gjatë zbatimit të KKK-së nga DKA. 1.3. Pajisja e shkollave me materiale të nevojshme për zbatimin e KKK-së.	1.1,2,3. Raportet nga Drejtorët dhe koordinatorët e cilësisë në nivel shkolle.
Rezultati 2. Rritja e bashkëpunimit Shkollë profesionale –me tregun e punës	2.1 Përmirësimi i cilësisë së punës të KC-ve , KMB-ve dhe Këshilltareve të Karrierës. 2.2 Promovimi i ofertës shkollore bazuar në kërkesat e tregut, java e dyerve të hapura të shkollës, Panaire, Takime me shoqata të bizneseve-institucioneve dhe mediave. 2.3 Formimi i Këshillit lokal për AAP.	2.1, Raportet e punës KMB dhe KESH 2.2 Raporte për aktivitet. 2.3 Dëshmi me procesverbal.
Rezultati 3. Realizimi i praktikës profesionale në ndërmarrje.	3.1. Identifikimi i ndërmarrjeve për realizimin e mësimin në vendin e punës 3.2. Sigurimi i nxënësve nga aksidentet gjatë mësimin në vendin punës . 3.3. Krijimi i lehtësirave nga komuna për ndërmarrjet që sigurojnë realizimin e praktikës profesionale. 3.4.Monitorimi MVP-es – Dual nga mekanizmat të shkollës dhe DKA-s	3.1 Nënshkrimi i memorandumeve të mirëkuptimit. 3.2 Fletë dëshmia 3.3 Subvencione nga Komuna. 3.4 Raportet nga Shkolla dhe DKA-ja

Prioriteti 3: Menaxhimi dhe udhëheqja cilësore në arsim

Rezultatet :	Çfarë veprimi do të ndërmerrni për të arritur ato rezultate?	Si do të dini nëse e keni arritur rezultatin?
Rezultati 1: Zhvillimi i kapaciteteve për menaxhim efektiv dhe të përgjegjshëm të sistemit në nivelin komunal.	1.1.Funksionalizimi dhe monitorimi i të gjitha organeve në nivel shkolle. 1.2. Përpunimi i të dhënave statistikore për planifikim të politikave arsimore në mes të shkollave - DKA-së - MASHT-it 1.3. Ngritja e bashkëpunimit dhe komunikimi efektiv në fushën e udhëheqjes dhe zhvillimit profesional në mes të shkollave.	1.1,2,3-Raportet
Rezultati 2: Qeverisje ,udhëheqje dhe menaxhim cilësor në të gjitha nivelet e arsimit në Deçan	2.1. Zhvillimi i kapaciteteve për qeverisje, udhëheqje dhe menaxhim të DKA-s, drejtorë, zv. drejtorëve, stafi administrativ, KC, KMB-ve dhe këshilltareve të karrierës në Shkolla. 2.2. Plotesimi i mekanizmave për monitorim dhe vlerësim të performancës së drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në nivel DKA-je.	2.1, 2- Vendime dhe Raporte.
Rezultati 3: Përgatiten dhe publikohen raporte të rregullta të bazuara në analiza dhe interpretim të të dhënave nga SMIA, dhe raporteve të rëndësishme që shfrytëzohen për politikë-bërje.	3.1. Zhvillimi i kapaciteteve për mbledhjen, përpunimin dhe interpretim të avancuar të të dhënave statistikore. 3.2. Analiza e të dhënave të SMIA-s dhe raporteve tjera dhe përdorimi i tyre për ngritje të cilësisë së arsimit në komunën e Deçanit. 3.3. Riorganizim-i rrjetit shkollor – paraleleve në rregullimin e numrit të normativit me numrin e nxënësve sipas formulës së financimit dhe legjislacionit në fuqi.	3.1,2- Vendimet, Raportet 3.3 Plani i riorganizimit.

Prioriteti 4: Ambiente të përshtatshme shkollore

Rezultatet :	Çfarë veprimi do të ndërmerrni për të arritur ato rezultate?	Si do të dini nëse e keni arritur rezultatin?
Rezultati 1: Infrastruktura shkollore bashkëkohore	1.1. Vazhdimi i punimeve në ndërtimin e 3 shkollave të reja , 1.2. Ndërtimi i 2 shkollave 1.3. Ndërtimi i dy sallave të Edukatës Fizike 1.4. Vazhdimi i punimeve në ndërtimin e Sallës edukatës Fizike, 1.5. Renovimi i 10- terreneve sportive, 1.6. Rregullimi i 5 rrethojave të shkollave. 1.7. Ndërtimi i këndit të lojërave 1.8. Krijimi i ambienteve të sigurta rreth shkollave.	1.1,2,3,4,5,6,7,8 <i>Projektet dhe Raportet</i>
Rezultati 2: Digjitalizimi i shkollave	2.1. Pajisja e shkollave me kamera vëzhguese dhe mirëmbajtja e tyre. 2.2. Pajisja e kabineteve me kompjuterë, tabela të mençura dhe pajisje moderne. 2.3. Instalimi i rrjetit të internetit në të gjitha shkollat. 2.4. Krijimi i një data baze të dhënave me të dhëna për arsimin e Komunës së Deçanit.	2.1,2 Dosja e inventarizimit në nivel DKA-së dhe shkollave. 2.3, Raport, e Programeve etj. 2.4. Raportet
Rezultati 3: Pajisja e kabineteve dhe punëtorive shkollore në funksion të mësimi praktik.	3.1. Identifikimi i nevojave për kabinate, punëtori dhe laboratorë, 3.2. Sigurimi i burimeve financiare (gjetja e donatorëve). 3.3. Inkurajimi i shkollave nga DKA për shfrytëzimin e buxhetit për plotësimin e nevojave për mjete didaktike dhe kabinate shkollore. 3.4. Mbështetja e shkollave nga DKA për aplikim në grante për projekte të ndryshme.	3.1 Raport 3.2 Buxheti i siguruar. 3.3 Raport financiar. 3.4 Raport

Prioriteti 5: Gjithëpërfshirja në arsim

Rezultatet :	Çfarë veprimi do të ndërmerrni për të arritur ato rezultate?	Si do të dini nëse e keni arritur rezultatin?
Rezultati 1: Rritja e përfshirjes së fëmijëve edukimin parashkollor.	1.1 Ndërtimi i 3- qerdheve te reja, Dranoc, Strellc i Epërm dhe Gramqel 1.2 Adaptimi i dy qerdheve -Isniq, Irzniq 1.3 Përfundimi i qerdhes në Deçan në proces.	1.1,2,3. Projektet dhe raportet
Rezultati 2: Përfshirje më e lartë e fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin arsimor para-universitar.	2.1. Identifikimi i fëmijëve me nevoja të veçanta. 2.2. Vlerësimi i fëmijëve me nevoja të veçanta bazuar në UA16/2017 . 2.3. Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në klasa të rregullta. 2.4. Përkrahja e mësimeve në klasë me asistent për fëmijë me nevoja të veçanta.	2.1. Raportet, të dhënat nga gjendja civile, qendra mirëqenies sociale. 2.2. Dosja e vlerësimit. 2.3,4. Të dhënat statistikore.
Rezultati 3: Integrimi i nxënësve të komuniteteve pakicë	3.1. Identifikimi i fëmijëve të komuniteteve pakicë. 3.2. Bashkëpunimi me Zyrën për Komunitete në komunë rreth regjistrimit, braktisjes dhe vijueshmërisë së nxënësve nga komunitetet pakicë. 3.3. Rritja e përfshirjes së fëmijëve të komuniteteve pakicë në sistemin e arsimit.	3.1. Raporte nga zyrat përgjegjëse. 3.2. Raport mbi përfshirjen e komuniteteve pakicë në sistemin e arsimit ne komunën e Deçanit. 3.3. Raportet EPRBM/ e ekipeve për parandalim dhe braktisje.

11. PLANI ZHVILLIMOR I ARSIMIT – PLANI I BURIMEVE

Për prioritetet e Planit Zhvillimor të Arsimit në Komunën e Decanit për periudhën 2024-2027 është dhënë edhe plani i burimeve:

Prioriteti 1: Sigurimi dhe zhvillimi i cilësisë

	Shpenzimet për vitin e parë në €	Shpenzimet për vitin e dytë në €	Shpenzimet për vitin e tretë në €	Vërejtje:
Rezultati 1. Sistemi efikas për vlerësim të shkollës.	Pa kosto	Pa kosto	Pa kosto	Shpenzimet mbulohen nga shkolla, DKA dhe MASHT

Rezultati 2. Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies	Pa kosto	Pa kosto	Pa kosto	Shpenzimet mbulohen nga shkolla, DKA dhe MASHT
Rezultati 3. Vlerësim i performancës së shkollës	Pa kosto	Pa kosto	Pa kosto	Shpenzimet mbulohen nga shkolla, DKA dhe MASHT
Rezultati 4. Zhvillimi profesional i mësimdhënësve.	4 000.00 euro	5 000.00 euro	6 000.00 euro	Shpenzimet mbulohen nga shkolla, DKA dhe MASHT dhe OJQ
Rezultati 5. Ngritja e suksesit të nxënësve	Pa kosto	Pa kosto	Pa kosto	Materialet dhe mjetet e nevojshme mbulohen nga shkolla, DKA, MASHT-, Donatoret dhe OJQ
Gjithsejtë	15 000.00 €			

Prioriteti 2: Zbatimi i Kurrikulës së re dhe ndërlidhja e programeve shkollore me nevojat e tregut të punës

Rezultatet	Shpenzimet për vitin e parë në €	Shpenzimet për vitin e dytë në €	Shpenzimet për vitin e tretë në €	Vërejtje:
Rezultati 1: Mbështetja e vazhdueshme e kapaciteteve dhe mekanizmave për zbatim dhe monitorim të KKK	Pa kosto	Pa kosto	Pa kosto	Koston e planifikon dhe mbulon shkolla dhe DKA-ja
Rezultati 2: Rritja e bashkëpunimit Shkollë profesionale – me tregun e punës	450.00 €	1 500.00€	1600.00 €	Shpenzimet mbulohen nga shkolla, DKA dhe MASHT-OJQ dhe donatoret

Rezultati 3: Realizimi i praktikës profesionale në ndërmarrje	1300 .00€	1 600.00 €	1700.00 €	Shpenzimet mbulohen nga shkolla, DKA dhe MASHT-OJQ dhe donatorët
Totali	1 750.00 €	3 100.00 €	3 300.00 €	
Gjithsejtë	8 150.00 €			

Prioriteti 3: Menaxhimi i sistemit arsimor

Rezultatet	Shpenzimet për vitin e parë në €	Shpenzimet për vitin e dytë në €	Shpenzimet për vitin e tretë në €	Vërejtje:
Rezultati 1: Zhvillimi i kapaciteteve për menaxhim efektiv dhe të përgjegjshëm të sistemit në nivel komunal	2 000.00 euro	2 500.00 euro	3 000.00 euro	Shpenzimet mbulohen nga shkolla, DKA dhe MASHT-OJQ dhe donatorët.
Rezultati 2: Qeverisje, udhëheqje dhe menaxhim cilësor në të gjitha nivelet e arsimit në Deçan	Pa kosto	Pa kosto	Pa kosto	Në bashkëpunim me DKA-n dhe MASHT-in
Rezultati 3: Përgatiten dhe publikohen raporte të bazuara në analiza dhe interpretim të dhënave nga SMIA si dhe shfrytëzohen për politikëbërje.	Pa kosto	2 000.00 euro	Pa kosto Pa kosto	Komuna dhe OJQ
Totali	2 000.00	4 500.00	3 000.00	
Gjithsejtë	9 500.00 €			

Prioriteti 5: Gjithëpërfshirja në arsim

Rezultatet	Shpenzimet për vitin e parë në €	Shpenzimet për vitin e dytë në €	Shpenzimet për vitin e tretë në €	Vërejtje:
Rezultati 1. Rritja e përfshirjes së fëmijëve në edukimin parashkollor	Pa kosto	Pa kosto	Pa kosto	Obligim ligjorë
Rezultati 2. Rritja e përfshirjes e fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin arsimor parauniversitar	400.00	600.00	800.00	Krijimi i kushteve për funksionimin e qendrës së vlerësimit.
Rezultati 3. Integrimi i nxënësve të komunitetit pakicë	Pa kosto	Pa kosto	Pa kosto	Obligim ligjorë

12. PËRMBLEDHJA E PRIORITETEVE TË SHKOLLAVE

Shkollat	Prioriteti	Prioriteti	Prioriteti	Prioriteti	Prioriteti
Gjimnazi “Vëllezërit Frashëri” Deçan	Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësimdhënësve dhe menaxhmentit të shkollës	Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënësve dhe zhvillimi i personalitetit të nxënësve	Mirëmbajtja e kabineteve dhe pajisjeve. Molerimi dhe gjetimi i mureve të brendshme. Zëvendësimi i 150 pllakave të bankave të vjetra në klasat mëimore.	Rinovimi i fushave të jashtme me standarte bashkëkohore	Zavendesimi i 30 dyerve të vjetra me dyer me kapak xhami në mes, në klasa mësimi dhe kabinete.
SHMT “Tafil Kasumaj” Deçan	Trajnimi i mësimdhënësve për aplikim të teknologjisë bashkëkohore gjatë mësimdhënies dhe nxënies. Trajnimi i mësimdhënësve të rinjë për metodikë dhe didaktikë profesionale. Ofrimi i arsimit parauniversitar për të rritur, me të cilin qytetarëve të Deçanit ju mundësohet përgatitje për jetë dhe arsimim të vazhdueshëm.	Bashkëpunimi me shkollat si motra në vend dhe jashtë vendit.	Ngritja e cilësisë përmes bashkëpunimit me sektorin privat.	Pajisja e punëtorisë të automekanikës. Pajisja e punëtorisë të IUNK. Pajisja e punëtorisë të metalpunuesve Minibusi për nevojat e praktikave profesionale. Pajisja e punëtorisë të për asistent hotelier.	Trajtimi i ujërave të zeza.
SHFMU “Lidhja e Prizrenit” Deçan	Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësimdhënësve	Objekti i ri i shkollës - projekti vazhdon! Ndërtimi fushave të jashtme të	Rrethoja e objektit të shkollës dhe ndarja fizike me	Bashkëpunimi me shkollat si motra në vend dhe jashtë vendit	Ndërtimi i këndit të lojërave.

		futbollit të vogël dhe basketbollit dhe infrastrukturës percjellese	qerdhen e shkollës. Ndertimi i parkingut te shkollës. Pajisja me kabinete të (TIK dhe shkencave natyrore).		
SHFMU "I. Boletini" Isniq	Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësimdhënësve	Aktivitete jashtkurikulare me nxënës.	Kompletimi dhe funksionalizimi i kabinetit të matematikës, artit figurativ dhe te edukatës muzikore	Pajisja e shkollës me 25 tabela te menqura	Riparimi dhe ngjyrosja e rrethojave metalike te oborrit te shkollës
SHFMU "B. Curri" Strellci i Epërm	Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësimdhënësve	Trajnimet e vazhdueshme të mësimdhënës ne zbatimin KKK	Pajisja me kabinete të (TIK dhe shkencave natyrore)	Pajisja bibliotekës me tituj të rinjë	
SHFMU "J. Gërvalla" Prapaqan	Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësimdhënësve	Eficienca energjetike e shkollës	Pajisja e Kabineteve të TIK, Kimisë-Fizikës, Biologjisë, Historisë e Gjeografisë me mjete të nevojshme didaktike.	Ndërtimi i Sallës së sportit	Instalimi i Paneleve solare

SHFMU ”Dëshmorët e Kombit” Strellci i Ulët	Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësimdhënësve	Trajnimet e vazhdueshme të mësimdhënësve në zbatimin e KKK	Pajisja me kabinete (TIK dhe shkencave natyrore)	Pajisja e kabineteve mesimore me mjete të konkretizimit	Rregullimi i rrethojës së shkollës dhe fushës sportive
SHFMU ”Sylë Alaj” Drenoc	Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësimdhënësve	Trajnimet e vazhdueshme të mësimdhënësve në zbatimin e KKK	Lyerjen e paraleles në Voksh Riparimine e kulmit të shkollës amë Pajisja e shkollës me 15 Llaptopa, 15 projektor, 3 tabela të menqura dhe 6 kondicioner	Mermetimin dhe sanimin e kulmit të salles së Sportit	Riparimi i rrethojës së shkollës
SHFMU “Rexhep Kadrijaj” Rastavicë	Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësimdhënësve	Pajisja me kabinete (TIK dhe shkencave natyrore) Rregullimi i kulmit të sallës së edukatës fizike	Trajnimet e vazhdueshme të mësimdhënësve në zbatimin e KKK	Pajisja e kabineteve, Fizikë, Kimi, Biologji dhe Gjeografi, Art figurativ dhe Art muzikor me mjete të konkretizimit	Furmizimi i bibliotekës me lektura
SHFMU “Maxhun Çekaj” Irnj	Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësimdhënësve	Trajnimet e vazhdueshme të mësimdhënësve në zbatimin e KKK - së	Digjitalizimi, pajisja me 15 laptop dhe pajisje tjera dixhitale.	Pajisja e kabineteve me mjete didaktike	Ndërtimi i këndit të lojërave

SHFMU “Sylejman Vokshi” Prejlep	Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësimdhënësve	Trajnimet e vazhdueshme të mësimdhënësve ne zbatimin e KKK - së	Digjitalizimi i shkollës dhe inventarizimi Pajisja me tabela te menqura	Renovimi i objektit shkollor. Renovimi i tereneve sportive dhe infrastrukturës përcjellëse.	Ndërtimi i Objektit i ri i shkollës. Rregullimi i hapësirës së jashtme të shkollës-parkingu.
SHFMU ”Drita” Gramaqel	Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësimdhënësve	Trajnimet e vazhdueshme të mësimdhënësve ne zbatimin e KKK - së	Pajisja me 10 tabela te menqura		
SHFMU “L. Selimi” Lumbardh	Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësimdhënësve	Trajnimet e vazhdueshme të mësimdhënësve ne zbatimin e KKK - së	Ndërtimi i sallës së edukatës fizike Rregullimi i inf kanalit të ujitjes Demolimi i objekteve të vjetra dhe largimi i mbeturinave	Rregullimi i infrastrukturës së shkollës: rrethoja, gjelbrimi, ndricimi, trotualet, parkingu i automjeteve.	Gjelbërimi i oborrit të shkollës
SHFMU “H. e Dukagjinit” Glllogjan	Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësimdhënësve	Trajnimet e vazhdueshme të mësimdhënësve ne zbatimin e KKK - së	Rregullimi i infrastrukturës së shkollës: rrethoja, gjelbrimi, ndricimi, trotualet, parkingu i automjeteve.	Pajisja e klasave me perde, për klasa dhe kabinete Inventar për zyrën e drejtorit	Pajisje a kabinetit të muzikës me vegla muzikore

SHFMU “D. e Vokshit” Pobërgjë	Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësimdhënësve	Trajnimet e vazhdueshme të mësimdhënësve ne zbatimin e KKK - së	Pajisja e shkollës me kabinete levizese per shkencat e natyres (biologji i realizuar), fizike dhe kimi.	Pajisja e shkollës me tabela të menqura.	Molerimi i mjedisit te brendshëm. Ndertimi i nje aneksi (nje mini salle per edukatës fizike dhe dy klasa per kabinete) Rregullimi i rrethojes se shkollës dhe ambienteve te jashtme.
SHFMU “Ardhmëria” Beleg	Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësimdhënësve	Trajnimet e vazhdueshme të mësimdhënësve ne zbatimin e KKK - së	Ndërtimi i shkollës së re		Rregullimi i hapësirës së jashtme të shkollës-parkingu.
SHFMU “Dëshmorët e Baballoqit” Baballog	Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësimdhënësve	Trajnimet e vazhdueshme të mësimdhënësve ne zbatimin e KKK - së	Digjitalizimi i Shkollës – Pajisja me monitor në klasa dhe rritja e kapacitetit të rrjetit. Regullimi i kulmit të shkollës.	Rrethoja mbrojtëse e fushës sportive. Rrethoja e oborrit me grila dhe dyert	Ndërtimi i aneksit dhe tualetëve (projekti është i hartuar nga DUPHMM-Deçan dhe gjindet për miratim në MASHT dhe DKA)
SHFMU “Kuvendi i V. te Llukës” Llukë e Epërme	Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësimdhënësve	Trajnimet e vazhdueshme të mësimdhënësve ne zbatimin e KKK - së	Rregullimi i fushës së futbollit.	Largimi i mbeturinave (ferrave dhe dheut të tepërt) në rrethoja mbrenda shkollës.	Rrafshimi i bunarit (i cili e rrezikonte jetën e nxënësve) dhe mbushja .

SHFMU “F.Konica” Ratishë	Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësimeve të mesimit	Trajnimet e vazhdueshme të mësimeve të mesimit në zbatimin e KKK - së	Demolimi i objekteve të vjetra dhe largimi i mbeturinave Pajisja e kabineteve, TIK, Fizikë, Kimi, Biologji dhe Gjeografi, Art figurativ dhe Art muzikor me mjete të konkretizimit Pajisja me inventar të ri	Rregullimi i ambienteve sportive	Rregullimi i infrastrukturës së shkollës: rrethoja, gjelbrimi, ndricimi, trotualet, parkingu i automjeteve. Ndërtimi i këndit të lojërave
SHFMU „E. Mekuli” Maznik	Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësimeve të mesimit	Trajnimet e vazhdueshme të mësimeve të mesimit në zbatimin e KKK - së	Rregullimi i nyjeve sanitare Pajisja me inventarë të ri të shkollës	Përgaditja e klasëve për punë me një ndërrim	Rregullimi i jashtëm i ambientit (oborrit) shkollor: gjelbrimi, ndricimi dhe ndërtimi i trotuarëve

SWOT analiza për PZHAK 2024-2027, të Komunës së Decanit:

Forcat - Përmirësimi i aftësive pedagogjike dhe metodologjike të mësimitdhënësve. - Rritja e cilësisë së menaxhimit shkollor dhe udhëheqjes efektive. - Përkushtimi për cilësi më të lartë arsimore. - Investimet në ndërtesa dhe ambiente të përshtatshme për edukimin e hershëm. - Mësimdhënës dhe edukatorë të trajnuar për të punuar me fëmijët e vegjël. - Angazhimi i prindërve dhe komunitetit në mbështetjen e edukimit të hershëm. - Angazhimi në zhvillimin gjithëpërfshirës të nxënësve. - Kapacitete të përmirësuara menaxheriale në nivel shkollor. - Rritja e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies. - Angazhimi për përfshirje të plotë të të gjithë nxënësve, pavarësisht prejardhjes dhe aftësive. - Përmirësimi i ndjeshmërisë dhe ndërgjegjësimi për diversitetin. - Përkushtimi për të ofruar mjedise të sigurt dhe të shëndetshme për nxënësit. - Investimet në infrastrukturë dhe teknologji shkollore.	Dobësitë - Mungesa e burimeve financiare për zhvillim të vazhdueshëm profesional. - Rezistenca ndaj ndryshimeve dhe përshtatjes së mësimitdhënësve të rinj me praktikën e reja. - Mungesa e materialeve didaktike dhe pajisjeve teknologjike. - Rezistenca ndaj ndryshimeve të metodave të mësimitdhënies. - Mungesa e trajnimeve specifike për menaxhmentin. - Përballja me sfida burokratike dhe administrative. - Fondet e kufizuara për materialet didaktike dhe pajisjet e nevojshme për edukimin parashkollor. - Mungesa e hapësirës dhe e kapacitetit për të akomoduar të gjithë fëmijët e moshës parashkollore. - Nevoja për trajnime të vazhdueshme për stafin për metodologjitë më të reja për të punuar me fëmijët e moshës parashkollore. - Mungesa e burimeve për të mbështetur nxënësit me nevoja të veçanta. - Pengesat kulturore dhe sociale që ndikojnë në gjithëpërfshirje. - Mungesa e fondeve për mirëmbajtjen dhe rinovimin e ndërtesave shkollore. - Problemet infrastrukturore që ndikojnë në cilësinë e mësimitdhënies.
Mundësitë - Bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare dhe donatorë për sigurimin e fondeve. - Trajnime dhe programe profesionale të ofruara nga institucione të specializuara.	Kërcënimet - Largimi i mësimitdhënësve të trajnuar drejt vendeve më të zhvilluara. - Ndryshimet e shpeshta në politikat arsimore dhe mungesa e stabilitetit. - Zvogëlimi i numrit të fëmijëve për shkak të ndryshimeve demografike

- Shkëmbimi i praktikave të mira me shkolla brenda dhe jashtë vendit. - Mundësia për të aplikuar për fonde dhe grante nga organizata ndërkombëtare dhe qeveritare për përmirësimin e edukimit të hershëm. - Mundësia për të bashkëpunuar me organizata joqeveritare që ofrojnë mbështetje në fushën e edukimit parashkollor. - Zhvillimi dhe implementimi i programeve të reja edukative që janë të përshtatshme për fëmijët e vegjël - Përmirësimi i bashkëpunimit me komunitetin dhe prindërit. - Përdorimi i teknologjisë për menaxhimin më të mirë të burimeve. - Trajnime dhe seminare të organizuara nga ekspertë të fushës. - Programet dhe grantet për përfshirje të barabartë. - Partneritetet me organizata që mbështesin gjithëpërfshirjen në arsim. - Financime dhe projekte nga donatorë dhe partnerë të ndryshëm. - Përdorimi i energjisë së rinovueshme dhe teknologjive moderne për përmirësimin e infrastrukturës.	mund të ndikojë në financimin dhe mbështetjen e programeve të edukimit të hershëm. - Politikat e papërshtatshme ose mungesa e mbështetjes nga autoritetet qendrore mund të pengojnë zhvillimin e programeve të edukimit të hershëm. - Familjet me kushte të vështira ekonomike mund të mos kenë mundësi të përfshijnë fëmijët e tyre në programe edukative të hershme. - Ndryshimet demografike që ndikojnë në numrin e nxënësve. - Mungesa e mbështetjes financiare për projekte të reja arsimore. - Ndryshimet në strukturat e udhëheqjes dhe politikave arsimore. - Konfliktet e mundshme midis stafit dhe menaxhmentit. - Diskriminimi dhe stigmatizimi i nxënësve me nevoja të veçanta. - Politikat dhe praktikat që mund të pengojnë gjithëpërfshirjen. - Dëmtimi i infrastrukturës nga faktorë natyrorë dhe dëmtuesit tjerë. - Mungesa e mirëmbajtjes së vazhdueshme që çon në degradim të shpejtë të ndërtesave dhe pajisjeve.
---	--

13. PRIORITETET TJERA TË ARSIMIT NË KOMUNË

Në Komunën e Decanit, përpos prioritetëve të përcaktuara më parë, në PZHAK janë të përcaktuara edhe disa prej prioritetëve tjera të arsimit për periudhën 2024-2027.

1. Riorganizimi i rrjetit shkollor

Implementimi i një plani për riorganizimin e rrjetit shkollor në nivel komune, duke përdorur normat e përcaktuara nga organet kompetente komunale në bashkëpunim me MASHT, MF dhe duke pasur parasysh trendët e zhvillimeve në të ardhmen. Kjo përfshin rregullimin e numrit të shkollave dhe lokacionin e tyre në mënyrë që të përmirësohet qasja dhe cilësia e arsimit.

2. Bashkëpunimi me organizata, partnerë dhe donatorë

Përmirësimi i bashkëpunimit dhe cilësisë së bashkëpunimit me organizatat, partnerët dhe donatorët, përfshirë shkollat kampione, shkollën e shekullit 21, dhe të tjerë, për të siguruar burime shtesë dhe përvoja që do të ndihmojnë në avancimin e arsimit.

3. Promovimi i mësim-gjatë gjithë jetës dhe orientimi në karrierë

Krijimi i një programi për të promovuar vetëdijësimin për rëndësinë e mësim-gjatë gjithë jetës dhe orientimin në karrierë për nxënësit, duke përfshirë sesionet e këshillimit për karrierën dhe trajnimet për zhvillimin personal dhe profesional.

4. Shkollat me një ndërrim

Zbatimi i mundësive për shkollat të punojnë në një ndërrim dhe zhvillimi i mësimi tërë ditor, duke përdorur modele të reja mësimi që promovojnë mësimin efikas dhe të përshtatshëm për nevojat e nxënësve.

5. Shtimi i qerdheve në nivel komune

Investimi në shtimin e numrit të qerdheve në nivel komune për të adresuar nevojat e fëmijëve të vegjël dhe për të ndihmuar në lehtësimin e barrës së kujdesit për fëmijët nga prindërit.

6. Formimi i komuniteteve "Të mësuarit së bashku"

Ndërtimi dhe përmirësimi i komuniteteve "Të mësuarit së bashku" për shkollat në nivel komune, duke inkurajuar bashkëpunimin dhe ndarjen e resurseve dhe përvojave në mes tyre.

7. Ofrimi i mësimi për të rritur

Organizimi i programeve të mësimi për të rritur për të siguruar mundësi për të gjithë ata që dëshirojnë të mësojnë dhe zhvillojnë aftësitë dhe potencialin e tyre për jetë dhe punësim.

8. Përkrahja e nxënësve nga familjet me kushte të vështira ekonomike

Ngritja dhe implementimi i programeve për të ofruar përkrahje financiare për nxënësit e shkollave të mesme që vijnë nga familjet me kushte të vështira ekonomike.

9. Shpërblimi për nxënësit fitues

10. Vendorsja e një sistemi shpërblimi për nxënësit fitues të vendeve të para në garat komunale të matematikës, fizikës dhe shkathtësi dixhitale, për të inkurajuar motivimin dhe arrijten në fushën e shkencave dhe teknologjisë.

DRAFT

Prioriteti 4: Ambienti shkollor dhe infrastruktura

I. SHFMU - "Lidhja e Prizrenit" - Deçan

Nr	Prioritetet e shkollave	2024	2025	2026	2027	Bartësit e buxhetit
1	Objekti i ri i shkollës- projekti vazhdon!	Shuma ?				MASHTI
2	Rinovimi i banjave (dy anët e shkollës)	28.000.00€				DKA, , Donatoret dhe OJQ-et
3	Rrethoja e objektit të shkollës dhe ndarja fizike me qerdhen e shkollës		3000.00€			DKA, MASHTI, Donatoret dhe OJQ-et
4	Ndërtimi fushave të jashtme të futbollit të vogël dhe basketbollit dhe infrastrukturës përcjellëse			180.000.00€		DKA, MASHTI, Donatoret dhe OJQ-et
5	Ndërtimi i parkingut të shkollës				50.000.00	DKA, Donatoret dhe OJQ-et
	Totali:	28.000.00€	3000.00€	180.000.00€	50.000.00€	
	Gjithsejtë: 261000.00€					

II. SHFMU - " Dëshmorët e Baballoqit" - Baballoq

1	Pajisja me monitor në klasa dhe rritja e kapacitetit të rrjetit.		5 200.00€			DKA, , Donatoret dhe OJQ-et
2	Pajisja me kabinete		1500.00€		1 500.00	DKA, MASHTI, Donatoret dhe OJQ-et
3	Ndërtimi i aneksit (projekti është i hartuar nga DUPHMM-Deçan dhe gjendet për miratim në MASHT dhe DKA)			90.000.00€		DKA, MASHTI, Donatoret dhe OJQ-et
4	Rrethoja mbrojtëse e fushës sportive.		1500.00€			DKA, Donatoret dhe OJQ-et
5	Rrethoja e oborrit me grila dhe dyert			2 000.00€		DKA, Donatoret dhe OJQ-et
6	Regullimi i kulmit të shkollës.		20.000.00€			DKA, MASHTI, Donatoret dhe OJQ-et
	Totali		23.000.00€	97 200.00€	1 500.00€	
	Gjithsejtë : 121 700 .00€					

III. SHFMU - "Sylë Alaj"- Dranoc

1	Lyerjen e paraleles në Voksh			20 000.00€		DKA-ja dhe Donatorë
2	Renovimi e kulmit te sallës së Sportit		15 000.00€			DKA-ja dhe Donatorë
3	Riparimi ne e kulmit të shkollës amë		20 000.00€			DKA, MASHTI
4	Riparimi i rrethojës së shkollës			2000.00€		DKA-ja MASHTI
5	Pajisja e shkollës me 15 Llaptopa, 15 projektor		12 000.00€	4500.00€		MASHTI dhe Donatoret.
	Totali		47 000.00€	26 500.00€		
	Gjithsejtë: 73 500.00 €					

IV SHFMU - "Dëshmorët e Vokshit"- Pobërgjë

1	Pajisja e shkollës me kabinete levizese per shkencat e natyres (biologji i realizuar), fizike dhe kimi.	Vazhdim , shuma?				DKA, MASHTI, Donatoret dhe OJQ-et
2	Pajisja e shkollës me tabelave te mençura		15 000.00€			MASHTI dhe Donatoret
3	Molërimi i objektit brenda.	+		20 000.00€		DKA-ja
4	Ndertimi i nje aneksi (nje mini salle per edukatës fizike dhe dy klasa per kabinete)			80 000.00€		DKA-ja MASHTI
5	Rregullimi i rrethojës se shkollës dhe ambienteve te jashtme.				6000.00€	DKA-ja dhe Donatoret
	Totali		15 000.00€	100 000.00€	6 000.00€	
	Gjithsejtë: 121 000.00€					

V. SHFMU - "Esat Mekuli" - Maznik

1	Rregullimi i nyjeve sanitare		10 000.00			DKA, Donatoret dhe OJQ-et
2	Përgaditja e klasëve për punë me një ndërrim			15 000.00		DKA, Donatoret dhe OJQ-et
3	Pajisja me inventarë të ri të shkollës		10.000.00			MASHTI, Donatoret dhe OJQ-et
4	Rregullimi i jashtëm i ambientit (oborrit) shkollor: gjelbrimi, ndricimi dhe ndërtimi i trotuareve	1 000.00	1 000.00			DKA, Donatoret dhe OJQ-et
	Totali	1 000.00	11 000.00	15 000.00		
	Gjithsejtë: 27 000.00€					

VI. SHFMU- " Drita" – Gramaqel

1	Rregullimi i nyjeve sanitare		10 000.00			DKA, Donatoret dhe OJQ-et
1	Pajisja e shkollës me 12 tabela të menqura		6 000.00	6 000.00		DKA, MASHTI, Donatoret dhe OJQ-et
	Totali		6 000.00	6 000.00		
	Gjithsejtë: 12 000.00€					

VII. SHFMU-"Kuvendi i Verrave të Llukës"- Llukë e Epërme

1	Rregullimi i Fushës së Futbollit.			16 000.00		DKA, MASHTI, Donatoret dhe OJQ-et
2	Rregullimi i ambientit të jashtëm të shkollës .		5 000.00			DKA, Donatoret dhe OJQ-et
	Totali		5 000.00	16 000.00		
	Gjithsejtë: 21 000.00€					

VII Gjymnazi "Vëllezërit Frashëri " në Deçan

1	Rrethoja e fushës së sportit ne vazhdim			120 000.00		DKA, MASHTI, Donatoret dhe OJQ-et
2	Mbyllja e stazës prej shkollës deri te salla e edukatës fizike – ne vazhdim	28 000.00				DKA,
3	Renovimi i dy nyjeve sanitare ne sallë të Ed Fizike		10 000.00			DKA, Donatoret dhe OJQ-et
4	Punimi i kanalizimit për kyqjen e ujërave te zeza të objektit të shkollës	6 000.00				DKA,
5	Zavendesimi i 30 dyerve të vjetra me dyer me kapak xhami në mes, në klasa mësimi dhe kabinete.			9 000.00		DKA, MASHTI, Donatoret dhe OJQ-et
6	Molerimi dhe gletimi i mureve të brendshme		35 000.00			DKA, Donatoret dhe OJQ-et
7	Zëvendësimi i 150 pllakave te bankave te vjetra ne klaset mesimore.		3 000.00			DKA, Donatoret dhe OJQ-et
8	Menjanimi i lagështisë se mureve në banjo dhe klasa			30 000.00		DKA, , Donatoret dhe OJQ-et
9	Pajisja e shkollës me 15 smart tabela		30 000.00			MASHTI, Donatoret dhe OJQ-et
10	Rinovimi i fushave të jashtme me standarte bashkëkohore				140 000.00	DKA, MASHTI, Donatoret dhe OJQ-et
	Totali	34 000.00	78 000.00	159 000.00	140 000.00	
	Gjithsejtë: 411 000.00€					

IX SHFMU "Sylejman Vokshi" Prilep

1	Ndërtimi i Objektit i ri i shkollës			80,000.00		MASHTI,
2	Renovimi i terenve sportive dhe infrastrukturës përcjellëse.		60 000.00			DKA, MASHTI, Donatoret dhe OJQ-et
3	Pajisja e shkollës me tabela te menqura				6 000.00	MASHTI, Donatoret dhe OJQ-et
4	Rregullimi i hapësirës së jashtme të shkollës-parkingu.			6 000.00		DKA, , Donatoret dhe OJQ-et
	Totali		60 000.00	86 000.00	6 000.00	
	Gjithsejtë: 152 000.00€					

X SHFMU "Dëshmorët e Kombit" - Strelci i ulët

1	Këndi i lojrave për fëmijë .			5 000.00		DKA, Donatoret dhe OJQ-et
2	Ndërtimi i rrethojës së Fushës së Sportit dhe rregullimi i saj		17 000.00			DKA, MASHTI, Donatoret dhe OJQ-et
3	Pajisja e kabineteve mesimore me mjete te konkretizimit			5 000.00		MASHTI, Donatoret dhe OJQ-et
	Totali:		17 000.00	10 000.00		
Gjithsejtë: 27 000 .00€						

XI SHFMU "Jusuf Gërvalla"- Prapaqan

1	Ndërtimi i Sallës së sportit			300 000.00		DKA, MASHTI, Donatoret dhe OJQ-et
2	Pajisja e Kabineteve të TIK, Kimisë-Fizikës, Biologjisë, Historisë e Gjeografisë me mjete të nevojshme didaktike.		6 000.00	6 000.00		MASHTI, Donatoret dhe OJQ-et
	Totali:		6 000.00	3006000.00		
Gjithsejt: 312 000 .00€						

XII SHFMU "Ardhmëria Beleg

1	Ndërtimi i shkollës se re		350 000.00			DKA, MASHTI,
2	Rregullimi i parkingut			15 000.00		DKA, Donatoret dhe OJQ-et
3	Mbjellja e fidanëve	1 000.00				Donatoret dhe OJQ-et
	Totali:	1 000.00	350 000.00	15 000.00		
Gjithsejt: 375 000 .00€						

XII SHFMU – “Isa Boletini” Isniq

1	Kompletimi dhe funksionalizimi i kabinetit të matematikës, artit figurativ dhe te edukatës muzikore		5 000.00			MASHTI, Donatoret dhe OJQ-et
2	Pajisja e shkollës me 25 tabela te menqura		10 000.000	10 000.00		MASHTI, Donatoret dhe OJQ-et
3	Riparimi dhe ngjyrosja e rrethojave metalike te oborrit te shkollës		3 000.00			DKA, Donatoret dhe OJQ-et
	Totali:		18 000.00	10 000.00		
	Gjithsejt: 28 000 .00€					

XIV. SHFMU – “Isa Boletini” Lëbushë (paralele e ndarë)

1	Instalimi i kamerave të sigurisë dhe interneti		3 500.00			DKA, Donatoret dhe OJQ-et
	Totali:		3 500.00			
	Gjithsejt: 3 500.00					

XV. SHFMU “Maxhun Çekaj” Irzniq

1	Pajisja e kabineteve me mjete didaktike, të shkencave natyrore		5 000.00			MASHTI, Donatoret dhe OJQ-et
2	Pajisja me 15 laptop dhe pajisje tjera dixhitale.		7 500.00	10 000.00		MASHTI, Donatoret dhe OJQ-et
	Totali:		12 500.00	10 000.00		
	Gjithsejt: 22 500.00					

XVI SHFMU "Bajram Curri" - Strellci i epërm

1	Pajisja bibliotekës me tituj të rinjë			1 000.00		Donatoret dhe OJQ-et
2	Pajisja e kabineteve me mjete didaktike, të shkencave natyrore		5 000.00			MASHTI, Donatoret dhe OJQ-et
	Totali:		5 000.00	1 000.00		
	Gjithsejt: 6 000 .00€					

XVII SHFMU "Heronjtë e Dukagjinit" – Glllogjan

1	Rregullimi i infrastrukturës së shkollës: rrethoja, gjelbrimi dhe ndricimi		10 000.00	5 000.00		DKA, Donatoret dhe OJQ-et
2	Pajisja e klasave me perde, për klasa dhe kabinete			10 000.00		DKA, Donatoret dhe OJQ-et
3	Inventar për zyrën e drejtorit		1 500.00			DKA, Donatoret dhe OJQ-et
4	Pajisje a kabinetit të muzikës me vegla muzikore		2 000.00			MASHTI, Donatoret dhe OJQ-et
6	Instalimi i Paneleve Solare	25 000.00				KFOR, Donatoret dhe OJQ-et
	Totali:	25 000.00	13 500.00	15 000.00		
	Gjithsejt: 43 500.00					

XVIII SHFMU “Lan Selimi”, Lumbardh

1	Ndërtimi i sallës së edukatës fizike		350 000.00			DKA, MASHTI, Donatoret dhe OJQ-et
2	Rregullimi i infrastrukturës së shkollës: rrethoja, gjelbrimi, ndricimi, trotualet, parkingu i automjeteve.		70 000.00			DKA, Donatoret dhe OJQ-et
3	Rregullimi i kanalit të ujitjes	2 000.00				DKA, MASHTI, Donatoret dhe OJQ-et
4	Rregullimi i tereneve sportive			30 000.00		DKA, MASHTI, Donatoret dhe OJQ-et
5	Demolimi i objekteve të vjetra dhe largimi i mbeturinave		5 000.00			DKA, Donatoret dhe OJQ-et
	Totali:	2 000.00	425 000.00	30 000.00		
	Gjithsejt: 457 000 .00€					

XIX SHFMU “Lan Selimi” Llukë e ulët (paralele e ndarë)

1	Ndërtimi i toaleteve fushore	20 000.00				DKA, Donatoret dhe OJQ-et
2	Rregullimi i infrastrukturës së jashtme të shkollës		15 000.00			DKA, Donatoret dhe OJQ-et
	Totali:	20 000.00	15 000.00			
	Gjithsejt: 35 000 .00€					

XX .SHMT "Tafil Kasumaj" – Deçan

1	Pajisja e punëtorisë të automekanikës		50 000.00			MASHTI, Donatoret dhe OJQ-et
2	Pajisja e punëtorisë të IUNK		50 000.00			MASHTI, Donatoret dhe OJQ-et
3	Pajisja e punëtorisë të metalpunuesve			100 000.00		MASHTI, Donatoret dhe OJQ-et
4	Minibusi për nevojat e praktikave profesionale	10 000.00				DKA, Donatoret dhe OJQ-et
5	Trajtimi i ujërave të zeza	2 000.00				DKA, , Donatoret dhe OJQ-et
6	DysHEMEJA e shkollës				25 000.00	DKA, Donatoret dhe OJQ-et
7	Pajisja e shkollës me inventar të ri		20 000.00			MASHTI, Donatoret dhe OJQ-et
8	Molerimi i ambienteve të mbrendshme të shkollës		20 000.00			DKA, Donatoret dhe OJQ-et
9	Laboratorin e mjekësisë			20 000.00		MASHTI, Donatoret dhe OJQ-et
	Totali :	12 000.00	140 000.00	120 000.00	25 000.00	
	Gjithsejt: 297 000 .00€					

XXI SHFMU- "Rexhep Kadrijaj" Rastavicë

1	Rregullimi i kulmit të sallës së edukatës fizike		10 000.00			DKA, MASHTI, Donatoret dhe OJQ-et
2	Pajisja e kabineteve, Fizikë, Kimi, Biologji dhe Gjeografi, Art figurativ dhe Art muzikor me mjete të konkretizimit		5 000.00			MASHTI, Donatoret dhe OJQ-et
3	Furmizimi i bibliotekës me lektyra	1 000.00				Donatoret dhe OJQ-et
4	Molerimi i ambienteve të mbrendshme të shkollës			20 000.00		DKA, Donatoret dhe OJQ-et
	Totali:	1 000.00	15 000.00	20 000		
	Gjithsejt: 36 000 .00€					

XXII. SHFMU - "Faik Konica"- Ratishë

1	Rregullimi i infrastrukturës së shkollës: rrethoja, gjelbrimi, ndricimi, trotualet, parkingu i automjeteve.			30 000.00		DKA, Donatoret dhe OJQ-et
2	Demolimi i objekteve të vjetra dhe largimi i mbeturinave		5 000.00			DKA, , Donatoret dhe OJQ-et
3	Pajisja e kabineteve, TIK, Fizikë, Kimi, Biologji dhe Gjeografi, Art figurativ dhe Art muzikor me mjete të konkretizimit			7 000.00		MASHTI, Donatoret dhe OJQ-et
4	Ndërtimi i këndit të lojërave			5 000.00		DKA, Donatoret dhe OJQ-et
5	Rregullimi i ambienteve sportive			10 000.00		DKA, Donatoret dhe OJQ-et
	Totali:		5 000.00	52 000.00		
	Gjithsejt: 57 000 .00€					

15. MONITORIMI, RAPORTIMI DHE VLERËSIMI

Monitorimi

Monitorimi është një proces i vazhdueshëm që synon të sigurojë informacion për Drejtorinë Komunale të Arsimit (DKA) dhe Komunës për progresin drejt arritjes së objektivave dhe realizimit të masave. Ky proces përfshin mbledhjen e të dhënave në lidhje me Planin Zhvillimor të Arsimit në Komunë (PZHAK), përmes vizitave në terren, takimeve me palët relevante dhe analizës së raporteve në dispozicion.

Plani i veprimit është mjeti kryesor për monitorimin e aktiviteteve, duke përcaktuar kalendarin e implementimit për secilin aktivitet. Çdo devijim nga orari i përcaktuar duhet të analizohet për të vlerësuar ndikimin e tij në burime dhe aktivitete të tjera. Arsytet për këto devijime duhet të shqyrtohen dhe plani i zbatimit duhet të korrigjohet në përputhje me ndryshimet.

Raportimi

Raportimi është pjesë integrale e monitorimit, me synim ofrimin e informacioneve në mënyrë sistematike dhe në intervale të caktuara kohore. DKA është përgjegjëse për përgatitjen e dy raporteve kryesore: raportin gjashtëmuor për zbatimin e planit të veprimit të PZHAK dhe raportin vjetor mbi zbatimin e PZHAK. Këto raporte ofrojnë informacion të rëndësishëm për vlerësimin e progresit dhe ndihmojnë në përcaktimin e masave të nevojshme për përmirësim.

Vlerësimi

Vlerësimi është një proces më i hollësishëm për të analizuar suksesin e zbatimit të PZHAK, duke identifikuar se çfarë ka shkuar mirë dhe arsyet prapa çfarë ka shkuar keq. Ky proces përfshin përpilimin e pyetjeve të vlerësimit, mbledhjen dhe analizimin e të dhënave për të marrë përgjigjet e këtyre pyetjeve dhe mbledhjen e provave për të formuluar përfundimet dhe rekomandimet lidhur me realizimin e PZHAK.

Koordinimi dhe Përgjegjësitë

DKA duhet të sigurojë një bashkërenditje të mirë dhe efikase me drejtoratet e shkollave, drejtoratet e komunës, Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) dhe ministritë e tjera relevante, si dhe me nismat dhe projektet e donatorëve, organizatave vendore dhe ndërkombëtare.

Grupi për Zbatimin e PZHAK

DKA do të krijojë Grupin për Zbatimin e PZHAK, i cili do të drejtohet nga Drejtori i DKA. Ky grup përbëhet nga zyrtarë përgjegjës të DKA dhe zyrtarë të tjerë komunal të ngarkuar me zbatimin e aktiviteteve të PZHAK. Detyrat dhe përgjegjësitë e këtij grupi përfshijnë:

- Shqyrtimi dhe rishikimi i planeve vjetore të veprimit për zbatimin e PZHAK.
- Rishikimi i buxhetit vjetor për zbatimin e PZHAK në kuadër të kufijve buxhetorë të përcaktuar me KASH dhe qarkoret buxhetore përkatëse.
- Analiza e progresit në zbatimin e PZHAK, bazuar në informatat e mbledhura nga burime të ndryshme.
- Shqyrtimi dhe miratimi i masave plotësuese për të siguruar zbatimin e PZHAK.
- Hartimi i kërkesave për mbështetje nga buxheti qendror dhe programet e donatorëve me qëllim të sigurimit të zbatimit të PZHAK.

Grupi do të takohet të paktën një herë në tre muaj për të shqyrtuar progresin, analizuar sfidat dhe përmirësuar veprimet. Takimet e zgjeruara me pjesëmarrje të gjerë të palëve tjera të interesit do të mbahen të paktën dy herë në vit. Kryesuesi i Grupit është zyrtari përgjegjës për koordinimin e zbatimit të aktiviteteve të PZHAK në përputhje me aktivitetet e Strategjisë së Arsimit 2022-2026 të MASHTI.

Shtojca : Korniza përkatëse ligjore, dokumentet e politikave dhe referencat shtesë

REFERENCAT:

Plani Zhvillimor i Arsimit Komunal 2019-2023

Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës 2022-2026

Plani Zhvillimor Komunal 2018-2023

Korniza strategjike për zhvillimin e mësimdhënësve në Kosovë, 2017

Strategjia e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin Parauniversitar në Kosovë, 2016

Strategjia për Digjitalizimin e Arsimit në Kosovë 2021-2026 (Draftdokument), MASHTI 2021

Ligjet

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës ;
- Kodi Penal, Nr.04/L-082;
- Konventa për të Drejtat e Fëmijës;
- Kodi i Procedurës Penale, Nr.04/L-123;
- Ligji i Punës, Nr.03/L-212;
- Ligji për Arsimin Parashkollor, Nr.02/L-53 ;
- Ligji për Arsimin dhe Aftësimin Profesional, Nr.04/L-138;
- Ligji për Arsimin Parauniversitar, Nr.02/L-52 ;
- Ligji për Arsimin në Komunitet e RK, Nr.03/L-068;
- Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare, Nr.02/L-17;
- Ligji për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës, MASHT 2018,
- Ligji për edukimin në fëmijërinë e hershme 08/L-153,
- Ligji i punës 03/L-212,
- Ligji i pageve në sektorin publik 08/L-196,
- Rregullore QRK nr.21/2013 për Protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar;
- Udhëzimi Administrativ nr. 28/2012 për themelimin dhe funksionimin e Këshillit të Prindërve të Kosovës;
- Udhëzimi administrativ nr.34-2013 për përbërjen, funksionimi dhe mandati i Këshillit Drejtues tek institucionet e arsimit parauniversitar ;
- Udhëzimi administrativ nr. 02/2014, numrin e nxënësve në module dhe planifikime të AAP-së;
- Udhëzimi administrativ nr. 34/ 2014 për funksionimin e shërbimit pedagogjik dhe psikologjik në shkolla;
- Udhëzimi administrativ nr. 23/2016 për planin zhvillimor të shkollës;
- Udhëzimi administrativ 24/2016 për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar;
- Udhëzuesi- Kodi etik për vlerësimin e nxënësve (2011).
- Udhëzimi administrativ nr. 13/2005 për masat ndaj prindërve, fëmijët e të cilëve nuk janë regjistruar, apo nuk vijnë në arsimin obligativ.

- Udhëzimi administrativ 19/2012 për krijimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos regjistrimit në arsimin e obliguar
- Udhëzimi administrativ nr. 9/2011 për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave statistikore nga shkollat dhe institucionet parashkollore në arsimin parauniversitar duke përdorur sistemin për menaxhimin e informatave në arsim,
- Udhëzimi administrativ nr. 15/2011 për dokumentacionin shkollor parauniversitar,
- Udhëzimi administrativ nr. 08/2012 për dokumentacionin shkollor parauniversitar,
- U.A. 03/2012, Barasvlera dhe njohja e dokumenteve të arsimit parauniversitar të lëshuara jashtë Republikës së Kosovës,
- Udhëzimi administrativ për MVP 137/2020.
- Udhëzimi administrativ 06/ 2022 për vlerësimin e nxënësve në arsimin parauniversitar.
- Udhëzimi administrativ 15/ 2023 për vlerësimin e performencës së mësimitdhënësve.
- Udhëzimi administrativ 18/2023 për këshilltarët e karrierës në IAAP.
- Udhëzimi administrativ 151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit dhe zëvendës drejtorit për shkollat publike në arsimin parauniversitar.
- Udhëzimi administrativ 119/2020 për zhvillimin profesional të mësimitdhënësve me bazë në shkollë.

Ky draft i Planit Zhvillimor të Arsimit, është përgatitur me iniciativën e DKA-së, ndërsa është punuar nga Komisioni profesional, i aprovuar nga Asambleja Komunale e Deçanit.

Besnik Hulaj - Drejtor i DKA-së

Hysen Balaj, Koordinator, Dr. sc. Pedagog

Hamid Qorraj -drejtor shkolle - anëtar

Enver Osdautaj, Profesor, anëtar

Afrim Balaj, zv. drejtor, anëtar

Xhevat Boxhdaraj, anëtar, Udhëheqës i zyrës së arsimit në DKA

Gjylshahe Haklaj, anëtare, zyrtare finaciare në DKA

Zeqë Malaj anëtar, zyrtar - DKA

Ramiz Bajramaj, anëtar, zyrtar – DKA

Besart Cacaj zyrtar Ligjor

Jeton Hulaj –profesor, Lektorë

Konsulent i jashtëm: Prof. Dr. Ramë Likaj

DKA - i falënderon te gjithë pjesëmarrësit dhe kontributdhënësit në përpilimin e këtij drafti !



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Komuna e Deçanit - Zyra e Kryetarit

02 Nr. ___/2024

Dt. 19/ 04 /2024

Për:	Z. Hajdar Sutaj – Kryesues i kuvendit Komunal – Deçan Anëtarët e Kuvendit Komunal – Deçan
Nga:	z. Bashkim Ramosaj – Kryetar i Komunës së Deçanit znj. Dafina Cacaj – Drejtore për Buxhet dhe Financa
Tema:	Kërkesë për Rialokim të mjeteve Financiare në kategorinë e investimeve Kapitale

Të nderuar,

Bazuar në LIGJIN NR. 08/L-193 MBI NDARJET BUXHETORE PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2024 /neni 16 pika 1. për ndryshimet në shumatat e ndara për projektet kapitale në kuadër të nën programeve dhe kërkesës se dt.19.06.2024 me nr prot.18993:

Kërkojmë nga ju që të apromoni rialokimin e mjeteve financiare të kategorisë se Investimeve Kapitale pasi që të njëjtat nuk kemi mundur t'i shfrytëzojmë në vitin 2024 dhe kërkojmë që të rialokohen për projektet kapitale si më poshtë:

Mjetet financiare nga projekti ekzistues "Ndërtimi i Objektivit të Ri të Komunës, kodi të projektit: 21/631/18015/32000/55018/045 në vlerën prej 150,000.00 € nga Të Hyrat Vetanake.

Të rialokohen në projektet ekzistuese:

1. " Ndërtimi i 4 Urave për Roshkodol dhe parku i Isniqit me kod të projektit 21/631/18015/32000/55019/045 " Vlera e kërkuar 40,000.00€ dhe
2. Projekti "Ndërtimi i qendrës së kolonive, qendrës rinore, parqeve shesheve etj, me kod të projektit 21/631/18015/31510/53127/0451, Vlera e kërkuar 79,358.00€

Arsyeshmëria:

Projekti për Ndërtimin e Objektit të Ri të Komunës, të cilin e kemi planifikuar ta fillojmë këtë vit, nuk kemi mundur të fillojmë procedurat e tenderimit për shkak të lokacionit së ku ishte planifikuar të ndërtohet sepse është prone kontestuese dhe nuk përfunduar ende procedurat gjyqësore, për këtë arsye mjetet të cilat kemi planifikuar ti kemi për këtë projekt po kërkojmë që të rialokohen në dy projekte tjera.

- Njeri projekt është Ndërtimi i 4 Urave për Roshkodol dhe parku i Isniqit projekt ky që përmbyllët vitin e ardhshëm mirëpo kompania është e gatshme që ta përfundojë këtë vit për këtë arsye po kërkojmë që mjetet të rialokohen në këtë projekt.
- Projekti tjetër është për përfundimin e Ndërtimit të objektit të Kolonisë së Artisteve Faza e II – Inventari, edhe për këtë projekt kompania është e gatshme të përfundojë këtë vit dhe të pranohet teknikisht.


Z. IKRDEJARI 19073
02 20.06.24



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Për: Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Nga: Trimor Gjokokaj – Menaxheri Projektit

Projekti: 1) Kolonia e artistëve Faza II –inventari dhe paisje tjera
2) Ndërtimi i 4 urave që qon në Roshkodol dhe parkut në isniq – komuna Deçanit
RISHPALLJE

Data: 19.06.2024

Subjekti: Kërkesë për financim dhe perfundimin e projekteve

KËRKESE

Të ndëruar, kerkea ime si menaxher i kontratave, rrjedhë pas takimeve me kompanit e kontraktuara dhe kryetarin e komunës.

Për përfundimin e projekteve:

- 1) Kolonia e artistëve Faza II –inventari dhe paisje tjera
- 2) Ndërtimi i 4 urave që qon në Roshkodol dhe parkut në isniq – komuna Deçanit RISHPALLJE

Na nevoiten mjete financiare si në vijim:

Projekti 1) Kolonia e artistëve Faza II –inventari dhe paisje tjera, kontratë kjo e nënshkruar në vlerën – 129358.00. ku gjatë vitit të kaluar kemi paguar deri më tani vetëm 50000.00 dhe për përfundimin e këtij projekti na nevoiten edhe 79358.00 që të dorzohet dhe të pranohet teknikisht këtë vite.

Projekti 2) Ndërtimi i 4 urave që qon në Roshkodol dhe parkut në isniq – komuna Deçanit RISHPALLJE - kontratë e nënshkruar në vlerën 172206.32, deri me tani janë paguar dy pagesa në vlerën 60000.00 dhe kompania ka shprehur gadishmërinë që nëse arrim ti sigurojmë edhe 40000.00 arrinë ti përfundojë punimet 100%. Punime këto që duhet të kryhen brenda sezonit verorë shkakut që terreni është në viset malore

Andaj kërkojmë nga ju si drejtori që brenda mundësive të na siguronit mjetet financiare që ne të arrime ti përfundojmë këto projekte kaq të rëndësishme për komunën tonë.

Trimor Gjokokaj 18993
25 19.06.24



*Z. Prokurimit 39590
02 23.11.23*

KONTRATË

Numri i kontratës: ¹ 631-23-12264-5-2-1/C258

KUVENDI KOMUNAL-DEÇAN, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njerën anë, dhe

Grup i Operatorëve Ekonomik DENISI SH.P.K.; REA SH.P.K., Rruga e Demonstratave nr 8, Deçan, (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

Ndërtimi i 4 urave që qon në Roshkodol dhe parkut në Isniq- Komuna e Deçanit-RISHPALLJE me numër identifikues 631-23-12264-5-2-1 me nr. Të prok. Të bren. 631-23-043-521.

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit **Ndërtimi i 4 urave që qon në Roshkodol dhe parkut në Isniq- Komuna e Deçanit-RISHPALLJE**

No.	Lot
1	Ndërtimi i 4 urave që qon në Roshkodol dhe parkut në Isniq- Komuna e Deçanit-RISHPALLJE

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: 172.206.32 €; *[Njiqind e shtatëdhjet e dy mijë e dyqind e gjasht euro e tridhjet e dy cent] Euro.*

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e verimja pagese që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

¹ si lutemi referojmë këtyrë mumi të kontratës në dokumentet e fakturimit dhe pageses, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin

2.3 Pagesat do të behen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike,

Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria); 17.11.2023.

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën, dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet


4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.


4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhenien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonje miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Xhevdet Ramosaj
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	23.11.2023
Vula:	



Për Kontraktuesin

Emri:	Denis Kuçi
Pozita:	Menaxher
Nënshkrimi:	
Data:	23.11.2023
Vula:	



KUSHTET E PËRGJITHSHME

Numri i kontrates 631-23-12264-5-2-1/C258

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.

1.2 "Punë" konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 "Kontraktuesi" është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 "Menaxheri i Projektit" është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 "Çmimi Kontratës" do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 "Vendi i ndërtimit" do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 "Pajisjet e kontraktuesit" do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 "Skicat" nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruara dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.9 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontrates

1.10 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontrates

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i percakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet paleve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të ciles Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj të një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në keto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankiereve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Kontraktuesi nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njihë lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të sigurojë, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkitazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë të Autoritetit kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

OBLIGIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Kontraktuesit, pa pagesë, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Kontraktuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato janë në dispozicion. Pas lëshimit të certifikatës përfundimtare,

Kontraktuesi duhet ti kthen autoritetit kontraktues te gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera te kontrates.

5.2 Pervec nese eshte e nevojshme per qellime te kontrates, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera qe i jep autoriteti kontraktues nuk duhet te perdoren as nuk duhet t'i komunikohen nje pale te trete nga Kontraktuesi pa pajtim paraprak te autoritetit kontraktues

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin per t'i leshuar Kontraktuesit urdhra administrative qe inkorporojne ato dokumente plotesuese dhe udhezimet qe jane te nevojshme per ekzekutim te mire te kontrates dhe per kompensim dëmi nga ndonje defekt te saj.

Neni 6 Qasja në vend punishte

6.1 Autoriteti kontraktues, ne kohen e duhur dhe ne perputhje me ecurine e punimeve, do ti jap qasje dhe akses Kontraktuesit ne vend punishte, ne perputhje me programin e zbatimit te detyrave te percaktuara ne keto Kushte te pergjithshme.

6.2 Kontraktuesi, gjate shfrytezimit, duhet te mirembaje cdo objekt te vendosur ne dispozicion te tij ne gjendje te mire, dhe duhet, nese kerkohet nga Autoriteti Kontraktues, ti kthej ato ne gjendjen e tyre origjinale pas perfundimit te kontrates.

6.3 Kontraktuesi nuk do te ketë te drejte te ndonje pagese per permireshimet qe rezultojne nga puna e kryer me iniciativën e tij.

Neni 7 Ndihma lidhur me rregulloret vendore

7.1 Kontraktuesi mund te kerkoje ndihmen e Autoritetit kontraktues per marrjen e kopjeve te ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdherate apo ligjet anesore te Republikës se Kosovës te cilat mund te ndikojne te Kontraktuesi gjate realizimit te obligimeve te tij me kontrate. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kerkuar Kontraktuesit me shpenzime te Kontraktuesit.

7.2 Ne baze te dispozitave te ligjeve dhe rregulloreve mbi punën, Autoriteti Kontraktues do te beje te gjitha perpjekjet e nevojshme per te lehtesuar prokurimin nga Kontraktuesi per te gjitha vizat dhe lejet e nevojshme, duke perfshire lejen e punes dhe lejet e qendrimit, per personelin, sherbimet e te cileve Kontraktuesi dhe Autoriteti kontraktues i konsideron te nevojshme, si dhe lejet e qendrimit per familjet e tyre

OBLIGIMET E KONTRAKTUESIT

Neni 8 Obligimet e Kontraktuesit

8.1 Kontraktuesi duhet te veprojë sipas urdhrave administrative qe i jep autoriteti kontraktues. Nese Kontraktuesi konsideron se kerkesa e nje urdhri administrativ shkon pertej fusheveprimit te kontrates, ai, duke iu ekspozuar denimit per shkelje te kontrates, do ta njoftojë autoritetin kontraktues per kete duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditesh pas pranimit te urdhrat. Ekzekutimi i urdhrat administrativ nuk do te pezullohet per shkak te ketij njoftimi.

8.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe te veprojë sipas te gjitha ligjeve dhe rregulloreve ne fuqi ne Republiken e Kosovës dhe do te sigurojë qe personeli i tij, te afermit e tyre, dhe punetoret vendore te tij gjithashtu t'i respektojne dhe te veprojnë sipas ketyre ligjeve dhe rregulloreve.

8.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë te gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontraten si private dhe konfidenciale. Pervec ne rastet kur kjo eshte e nevojshme per qellime

të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

8.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përberja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

8.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord në programin e bërë sipas Nenit 12.

8.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përputhje me standardet, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe për më tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të pritët nga një kontraktues i aftë dhe me përvojë që ka ndërmarr punë të ngjashme.

8.7 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara.

8.8 Kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës për arsyet e mëposhtme:

- a. në qoftë se për kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: ekskavatore të llojeve të ndryshme, vinça, kamionë të llojeve të ndryshme, skela të larta, etj do të përdoren dhe
- b. në mënyrë që të mos dëmtojë kalimtarët e rastit, objektet përreth, trafikun etj.

8.9 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në vend punim.

Neni 9 Personeli

9.1 Kontraktuesi duhet të punësoj personel kyç dhe të përdor pajisje të identifikuar në tender e tij, për të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do të aprovoj çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.

Neni 10 Siguria e ekzekutimit

10.1 Kontraktuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

10.2 Sigurimi do të vazhdoj të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Pranimit të Përkohshëm.

10.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

Neni 11 Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit

11.1 Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korrigjimit të Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materialet, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

11.2 Kontraktuesi duhet të siguroj një sigurim nga dita fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuese të defekteve në shumat e përcaktuara në KVK për ngjarjet e mëposhtme të cilat janë për shkak të rreziqeve të Kontraktuesit:

- (a) humbje ose dëmtim i Punëve, Impianteve dhe Materialeve;
- (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve;
- (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Puneve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën; dhe
- (d) dëmtim ose vdekje e personelit të tij.

11.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën për sigurim që ka për qëllim kompensimin e nevojshëm për të siguruar humbjen apo dëmet e pësuar.

11.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

11.5 Në qoftë se ekzistojnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për zgjatjen e afatit të ofrimit të certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë afatin e caktuar për dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose të eliminojë sigurimin dhe të zbresë çmimin e shpërblimit nga fitimi i kontraktuesit.

Neni 12 Programi

12.1 Brenda kohës së specifikuar në KVK, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim. Programi do të përmbajë së paku me se vijon mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, afatin kohor që kërkohet për dorëzim dhe miratim të vizatimeve, metodat e përgjithshme që do të zbatohen, dhe afatin kohor për secilin aktivitet të specifikuar.

12.2 Nëse menaxheri i projektit për më tepër kërkon modifikime në programin e punëve në kuadër të punëve të kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'i kthejë prapë Menaxherit të projektit. Kontraktuesi do të azhurnojë Programin në intervale jo më shumë se periudha e përcaktuar në KVK.

12.3 Për çdo pakënaqësi apo mosmarrëveshje në lidhje me modifikimin e programit, kontraktuesi do të sigurojë argument me shkrim Menaxherit të Projektit.

12.4 Paraqitja e programit të tillë, duke përfshirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do të zvogëlojë ose të rrisë detyrimet e kontraktuesit sipas punëve të kontraktuara, si dhe çdo modifikim të përfshirë në programin e punimeve nuk do të rezultojë në ndonjë pagesë shtesë për kontraktuesin, nëse kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

Neni 13 Siguria në vend punishte

13.1 Kontraktuesi do të ketë të drejtën të ndalojë qasjen në vend-punishte për çdo person i cili nuk është i përfshirë në zbatimin e kontratës, me përjashtim të personave të autorizuar nga Autoriteti Kontraktues.

13.2 Kontraktuesi do të sigurojë sigurinë në vend-punishte gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit dhe do të jetë përgjegjës për të marrë hapat e nevojshëm, në interes të punonjësve të tij, agjentëve të Autoritetit Kontraktues dhe palëve të treta, për të parandaluar çdo humbje ose aksident i cili mund të rezultojë nga kryerja e punëve.

13.3 Kontraktuesi do të marrë të gjitha hapat e domosdoshme, për përgjegjësinë e tij dhe me shpenzimet e tij, për të siguruar që strukturat dhe instalimet ekzistuese mbrohen, ruhen dhe mirëmbahen. Ai do të jetë përgjegjës për sigurimin, me shpenzimet e tij, ndriçimin, sigurinë,

skermën dhe pajisjet e sigurisë të cilat janë të nevojshme për zbatimin e duhur të detyrave ose që me arsyë mund të kërkohen nga Autoriteti Kontraktues

Neni 14 Ndërhyrja me trafikun

14.1 Kontraktuesi do të sigurojë që punimet dhe instalimet nuk shkaktojnë dëme, ose pengojnë trafikun në, lidhjet e komunikimit të tilla si rrugët, hekurudhat, rruge ujore dhe aeroporte. Ai, në veçanti, do të marrë parasysh kufizimet në peshë kur zgjedh rrugët dhe automjetet.

14.2 Çdo masë të veçantë të cilën Kontraktuesi e konsideron të nevojshme, ose është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të mbrojtjes apo për të përforcuar pjesët e rrugëve, urave, do të bartet në shpenzime të Kontraktuesit, pa marrë parasysh se ato kryhen nuk ato kryhen nga Kontraktuesi. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin kontraktues për çfaredo masa të veçanta që ai synon të ndërmarrë para se kryej ato. Riparimet e dëmit të shkaktuara në rrugë, ura nga transporti i materialeve apo pajisjeve do të jetë në shpenzime të Kontraktuesit.

Neni 15 Tatimi

15.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

15.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

15.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të përfundimit të punëve.

15.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë kontraktuesi.

Neni 16 Kostoja e Riparimeve

16.1 Humbja ose dëmtimi i Punëve ose Materialeve që do të përfshihen në Punët në mes të Datës së fillimit dhe në fund të periudhës së Korrigjimit të Defekteve do të rregullohet nga Kontraktuesi në koston e Kontraktuesit nëse humbja ose dëmtimi lind nga aktet ose mosveprimet e Kontraktuesit.

FILLIMI DHE VONESAT

Neni 17 Fillimi i punëve

17.1 Kontraktuesi do të filloj punët brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

17.2 Kontraktuesi do të ndërtojë dhe instaloj Punët në pajtim me Specifikimet dhe Vizatimet dhe Punët do të kryhen në pajtim me Programin e dorëzuar nga Kontraktuesi, i përditësuar me miratimin e Menaxherit të Projektit, dhe do të plotësoj ato brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

Neni 18 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

18.1 Kontraktuesi mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritët se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës.

b) Forca madhore të përkufizuara si në Nenin 38;

18.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Kontraktuesi duhet ta lajmërojë Autoritetin Kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditësh i jep Autoritetit Kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

18.3 Brenda 30 ditësh pas pranimit të detajeve sipas Nenit 18.2 Autoriteti Kontraktues do t'i lejojë me shkrim Kontraktuesit këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Kontraktuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 19 Dëmet e likuiduara

19.1 Kontraktuesi do të paguajë dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkalojë shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbresë dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Kontraktuesit. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikojë në detyrimet e Kontraktuesit.

19.2 Nëse Autoriteti Kontraktues ka fituar të drejtën e vlerës maksimale në bazë të nenit 19.1 ai mundet, pasi ta njoftojë Kontraktuesin:

- (a) konfiskojë garancinë e realizimit; dhe / ose
- (b) të ndërpresë kontratën; dhe
- (c) të hyjë në një kontratë me një palë të tretë në koston e Kontraktuesit për ofrimin e bilancit të punimeve.

MATERIALET DHE MJESHTËRITË

Neni 20 Regjistri i punës

20.1 Një regjistër i punës do të, përveç kur parashikohet ndryshe nga KVK, mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit, i cili do të mbajë të paktën informacionin e mëposhtëm:

kushtet e motit, ndërprerjet e punës që detyrohen nga moti me shi, orët e punës, numrin dhe llojin e punëtorëve të punësuar në vend-punishte, materialet e furnizuara, pajisjet në përdorim, pajisjet jo në gjendje pune, testet e kryera në vend, mostrat e dërguara, rrethanat e paparashikuara si dhe urdhrat dhënë Kontraktuesit;

deklaratat e hollësishme të të gjitha elementeve sasiore dhe cilësore të punës së bërë dhe furnizimet e dorëzuara dhe të përdorura, të afta për tu kontrolluar në vend-punishte dhe të rëndësishme në llogaritjen e pagesave që duhet bërë Kontraktuesit.

20.2 Shenimet e bëra në regjistrin e punës, si pune në progres, duhet të nënshkruhen nga Autoriteti Kontraktues dhe të bashkë-nënshkruhen nga Kontraktuesi ose përfaqësuesi i tij. Nëse Kontraktuesi refuzon, ai do të komunikojë pikëpamjet e tij ndaj Autoritetit Kontraktues në afat prej 15 ditësh pas datës në të cilën janë regjistruar të dhënat apo deklaratat kundërshtuese. Nëse Kontraktuesi deshton që të nënshkruajë ose të paraqesë pikëpamjet e tij brenda periudhës së lejuar, do të konsiderohet se Kontraktuesi pajtohet me shenimet e paraqitura në regjistër. Kontraktuesi mund të shqyrtojë regjistrin e punës në çdo kohë dhe mund, pa hequr dokumentin, të bëjë ose të marrë një kopje të shënimeve të cilat ai i konsideron të nevojshme për informacionin e tij.

20.3 Sipas kërkesës, Kontraktuesi do ta sigurojë Autoritetin Kontraktues me informacionin e duhur për të mbajtur regjistrin e punës në mënyrën e duhur.

Neni 21 Origjina dhe cilësia e punimeve dhe materialeve

21.1 Punët, komponentët dhe materialet do të jenë në përputhje me specifikimet, vizatimet, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë dhe do të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë gjithë periudhës së realizimit.

21.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare do të jenë objekt i një kërkesë të dërguar nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues. Kërkesa duhet të referohet numrit të kontratës, numrin e Lotit dhe vendin ku do të zhvillohet pranimi i tillë, sipas rastit. Komponentët dhe materialet e specifikuar në kërkesë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në punë.

21.3 Edhe nëse janë pranuar teknikisht materialet apo artikujt që do të përfshihen në punë ose në prodhimin e komponentëve, ato mund të refuzohen dhe duhet të zëvendësohen menjëherë nga Kontraktuesi nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime. Kontraktuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikuj do të pranohen për inkorporim në punë vetëm nëse janë riparuar.

Neni 22 Inspektimi dhe testimi

22.1 Autoriteti Kontraktues do të emëroj *"Menaxherin e Projektit"*, të cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuese të defekteve dhe për raportim tek Autoriteti Kontraktues.

22.2 Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rëna dakord.

22.3 Kontraktuesi do të sigurojë që komponentët dhe materialet të dorëzohen në kohë në vend për të lejuar autoritetit kontraktues që të vazhdojë me pranimin e komponentëve dhe materialeve. Kontraktuesi konsiderohet se ka vlerësuar plotësisht vështirësitë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe nuk do të lejohet që të paraqesë ndonjë arsye për vonesë në përmbushjen e detyrave.

22.4 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë, ose nga vetë ose agjentit e tij, që të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë progresin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për ofrimin e sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vend-punishte ose në ndonjë vend tjetër, siç mund të specifikohet në kontratë.

22.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet, Autoriteti kontraktues do ta njoftojë Kontraktuesin ose do të miratojë certifikimin e procedurës lidhur me këtë.

22.6 Nëse Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do të japë një deklaratë për pikëpamjet e tij ndaj tjetrit brenda 15 ditëve pas ngritjes së mosmarrëveshjes së tillë. Autoriteti kontraktues ose Kontraktuesi mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrethana, ose nëse ndonjëra palë kërkon, nga një ekspert që zgjidhet me pëlqimin e përbashkët. Të gjitha raportet e testimit do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë të

Kontraktuesi. Rezultatet e ri-testimit do të jenë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e të cilit dëshmohet se është gabim nga ri-testimit.

Neni 23 Paralajmërim i hershëm

23.1 Kontraktuesi pa humbur kohë do të informojë Menaxherin e Projektit, në qoftë se vëren ndonjë gabim apo lëshim në skica (vizatime) apo edhe në specifikim gjatë kryerjes së punëve duke ia tërhequr vërejtjen se ato mund të ndikojnë me vone në kualitetin e punëve.

23.2 Nëse Menaxheri i Projektit vëren ekzistimin e disa gabimeve apo lëshimeve, qofshin ato në skica apo në specifikim teknik, ai/ajo do t'i evitoj menjëherë dhe do t'i konsideroj pasojat.

23.3 Nëse palët në kontratë vlerësojnë se ndërrimet substanciale të punëve janë bërë të nevojshme për shkak të gabimeve të tilla ose të përjashtimeve të cilat substancialisht ndikojnë në çmimin e kontratës, atëherë Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me autoritetin kontraktues do të korrigjojnë dhe kompensojnë situatën sipas Ligjit të Prokurimit Publik.

PAGESAT

Neni 24 Pagesa

24.1 Pagesat do të bëhen në Euro.

24.2 Pagesat do të rregullohen për zbritje për pagesat paradhënie dhe të mbajtjes. Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate. Nëse Autoriteti Kontraktues bën një pagesë me vonesë, Kontraktuesit do t'i paguhet interes për pagesë me vonesë në pagesën e ardhshme. Interesi do të llogaritet nga data në të cilën pagesa duhet të ishte bërë, deri në datën kur pagesa është bërë me vonesë, e rregulluar sipas bankave vendase për kredi në sektorin e ndërtimit.

24.3 Artikujt e Punëve për të cilat nuk është dhënë normë apo çmim nuk do të paguhet nga Autoriteti Kontraktues dhe do të konsiderohen të mbuluara nga normat dhe çmimet tjera në Kontratë.

24.4 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Kontraktuesi do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Kontraktuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

Neni 25 Paramasa dhe Parallogaria

25.1 Paramasa dhe parallogaria duhet të përmbajnë pajisje për ndërtim, instalim, testim, dhe punën e komisioneve që duhet të kryhet nga ana e Kontraktuesit. Paramasa dhe parallogaria përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktuesi do të paguhet për sasinë e punës së kryer në normën e Paramasës dhe Parallogarisë për çdo artikull.

25.2 Në rast të kontratës paushallë, Përshkrimi i Aktivitetit duhet të përmbaj aktivitetet me çmim për punët e kryera nga ana e Kontraktuesit. Përshkrimi i Aktivitetit përdoret për monitorim dhe kontroll të kryerjes së aktivitetëve në bazë të të cilave Kontraktuesi do të paguhet. Nëse pagesa për Materiale në vend punim do të bëhet veç e veç, Kontraktuesi do të tregoj shpërndarjen e Materialeve në vend punim veçmas në Përshkrimin e Aktivitetit.

Neni 26 Parapagimi

26.1 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesë paradhënie Kontraktuesit të shumave të përcaktuara në KVK nga data e caktuar në KVK kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një

Garancioni të Pakushtëzuar Bankar në një formë të pranueshme për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe valutë të barabartë me parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e parë, por shuma e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shuma që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim.

26.2 Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme posaçërisht për kryerjen e punëve. Kontraktuesi duhet të deshmojë se pagesa paradhanë është përdorur në këtë mënyrë me furnizim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit.

26.3 Parapagim do të paguhet duke zbritur shuma proporcionale nga pagesat përndryshe për shkak të Kontraktuesit, pas orarit të përqindjeve të përfunduar të Punëve në bazë të pagesës.

Neni 27 Mbajtja e Parasë

27.1 Shuma, e specifikuar në KVK, do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit deri në përfundim të tërë të Punëve. Kjo shume në asnjë rast nuk do të tejkalojë 10% e vlerës totale të kontratës origjinale. Kontraktuesi mund të zëvendësojë paratë e mbajtura me garancion bankar "me kërkesë".

27.2 Shuma e mbajtur ose garancia e mbajtjes do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit të deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29.

Neni 28 Vërtetimet e pagesës

28.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të projektit raportet mujore të çmimeve të vleresuara të punëve të përfunduara me minus shumën kumulative të vërtetuar më parë.

28.2 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit.

28.3 Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.

28.4 Vlera e punës së përfunduar përfshin:

- a) Në rastin e Kontratës së Paramasës dhe Parallogarisë, vlerën e sasisë së punës në Paramasë dhe Parallogari që është përfunduar, ose
- b) Në rast të kontratës paushallë, vlera e punës së ekzekutuar do të përbëjë vlerën e aktiviteteve të përfunduara në Përshkrimin e Aktivitetit.

28.5 Vlera e punës së përfunduar përfshin vlerësimin e ndryshimeve dhe shkaqeve për kompensim.

Neni 29 Llogaritja përfundimtare

29.1 Kontraktuesi jo më vonë se 90 ditë pas lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimi, do të dorëzojë tek Menaxheri i Projektit një draft të deklaratës së llogarisë përfundimtare me dokumentet mbështetëse që tregojnë në detaje vlerën e punës së bërë në përputhje me kontratën, së bashku me të gjitha shumat e metejshme të cilën Kontraktuesi konsideron se duhet paguar sipas kontratës, në mënyrë që Menaxheri i Projektit të përgatis deklaratën e llogarisë përfundimtare.

29.2 Brenda 30 ditëve pas pranimi të draft-deklaratës së llogarisë përfundimtare dhe të gjithë informacionit të kërkuar në mënyrë të arsyeshme për verifikimin e saj, Menaxheri i Projektit do të përgatisë deklaratën e llogarisë përfundimtare, e cila përcakton:

- a) Shumën e cila sipas opinionit të tij duhet t'i paguhet sipas kontratës, dhe

- b) pas evidentimit të shumave të paguara paraprakisht nga Autoriteti Kontraktues dhe i të gjitha shumave të cilat i takojnë Autoritetit Kontraktues sipas kontratës, bilanci, nëse ka, nga Autoriteti Kontraktues tek Kontraktuesi, ose nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues, siç mund të jete rasti.

29.3 Menaxheri i Projektit do të lëshojë te autoriteti kontraktues ose te përfaqësuesi i tij i autorizuar, dhe te Kontraktuesi, deklaratën e llogarisë përfundimtare që paraqet shumën përfundimtare për të cilën duhet paguar Kontraktuesi në bazë të kontratës. Autoriteti kontraktues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar dhe Kontraktuesi duhet të nënshkruajnë deklaratën e llogarisë përfundimtare, si një njohje e vlerës së plotë dhe përfundimtar të punës së realizuar sipas kontratës dhe menjëherë do të dorëzojë një kopje të nënshkruar të Menaxherin e Projektit.

Neni 30 Shkaqet për kompensim

30.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFEKTET

Neni 31 Parimet e përgjithshme

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të perkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jete pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara në shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët të cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kerkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues. përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdher të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jete lëshuar, ose konsiderohet të jete lëshuar, një certifikatë e pranimi të përkohshëm

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimi të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimi të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimi të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm, ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimi të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimi të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkojnë më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimi siç kërkojnë në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për menjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdojë vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjojë një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i

projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimi të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimi përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimi do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimi nga Menaxheri i Projektet dhe të jetë dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimi dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimi. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke u referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet, dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpermendura, mund të jepen dëmshperblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme, ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpre apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa me parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim.

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin

- iv. Afati për permbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa afte, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 dite mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet permbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të

arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: **631-23-12264-5-2-1/C258**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni, Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Jundiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% i vlerës së kontratës me vlefshmëri prej 25 muaj.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxhent të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjër në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me

		Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar (ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 15 ditë nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë [24.11.2023]
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë [24] muaj
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është [Caktohet me vendim të ZKA]
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: Nuk aplikohet.
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë [24.11.2023] ditë pas nënshkrimit të kontratës
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është [12 muaj pas pranimit teknik] ditë
Pagesa shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik - Divizioni i rregullave
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.

		ose b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.
--	--	--

PARAMASA PËR PROJEKTIN:
"NDËRTIMI I 4 URAVE NË RRUGËN QË QON NË ROSHKODOL"

1 STRUKTURAT E BETONIT		URA - 1			
Vërejtje: Të gjitha pozicionet përfshijnë, furnizimin me material, transportin, shkarkimin e dhe vurjen në vepër të materialeve për secilin pozicion					
1.1.1	Punët përgaditore	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
1.1.1.1	Rregullimi i punishtës, pastërtimi i terërit, largimi i humurit, pozicioni përfshinë edhe demtimin e shtresave të asfaltit ekzistues si dhe largimin e tyre deri në depot	m ²	170.00	20.00	3.400.00
1.1.1.2	Matjet gjeodezike dhe piketimi i urës në terren	m	10.00	20.00	200.00
Total					3,600.00
1.1.2	Punët e dheut				
1.1.2.1	Gërmimi i dheut i kategorisë së III dhe IV për taban të themelit, shpatulla dhe muret e urës me makineri në çmim hyjës dhe ngarkimi dhe transporti i dheut deri në depot	m ³	350.00	10.00	3,500.00
1.1.2.2	Mbushja me zhavor (gur i thyer) nën themelid të shpatullave dhe mureve të urës me fraksion 0-63 mm si dhe ngjeshja e tij deri në modulën e ngjeshjes (60 - 80 Mpa), ngjeshja duhet të testohet me plaken mëshore	m ³	30.00	15.00	450.00
1.1.2.3	Mbushja me zhavor (gur i thyer) me fraksion 0-63 mm në perimetrimin e mureve të urës dhe pranë krahëve të shpatullave si dhe ngjeshja bëhet në shtresa prej 50 cm deri në modulën e ngjeshjes (60 - 80 Mpa), kjo duhet të testohet me plaken mëshore	m ³	230.00	15.00	3,450.00
1.1.2.4	Përgaditja për mveshjen e skarpave pranë shpatullave me dheun e kategorisë së I-rë	m ²	20.00	20.00	400.00
Total 1.1.2					7,800.00
1.1.3	Punët e betonit				
1.1.3.1	Furnizimi me material, përgaditja e kallupëve, si dhe betonimi i shtresave nën themelid nga betoni i trashësi klasës C-12/15, t=10cm	m ²	6.00	85.00	510.00
1.1.3.2	Furnizimi me material, përgaditja e kallupëve, armimi si dhe betonimi i themelit plake dhe themelit të shpatullave të nënkallimit me beton C-30/37	m ²	44.00	85.00	3,740.00
1.1.3.3	Furnizimi me material, përgaditja e kallupëve, armimi dhe betonimi i soletës dhe mureve të nënkallimit dhe shpatullave me beton C-30/37 me dimensione sipas detajit në projekt	m ²	90.00	85.00	7,650.00
1.1.3.4	Furnizimi me material, përgaditja e kallupëve dhe betonimi i soletës për trotuar në të dyja anët me beton të klasës C20/25	m ²	2.00	85.00	170.00
1.1.3.5	Furnizimi me material si dhe punimi i skarpave 18x24cm në të dyja anët e rrugës	m	20.00	20.00	400.00
Total 1.1.3					12,470.00
1.1.4	Punët e armaturës				
1.1.4.1	Punimi i armaturës sipas të gjitha pozicioneve nga plani i detajeve të armimit, armatura e bronzëzuar S-500B	kg	17.138.49	9.90	15,424.64
Total 1.1.4					15,424.64
1.1.5	Punët e rrethojës				
1.1.5.1	Blerja, transporti dhe vendosja e rrethojës në të dyja anët e urës me të gjitha pozicionet	m	20.00	50.00	1,000.00
Total 1.1.5					1,000.00
1.1.6	Hidroizolimi				
1.1.6.1	Punimi i hidroizolimit tip Sika emulsion (ose të ngjashëm), në muret, plaken dhe shpatullat e urës	m ²	110.00	5.00	550.00
1.1.6.2	Blerja, transporti dhe vendosja e dy gypave Ø90 nën trotuar në të dyja anët e rrugës të cilat shërbejnë si gypa rezerve për rastet e caktuara publike	m	40.00	15.00	600.00
Total 1.1.6					1,150.00
Totali me TVSH:					41,444.64



S.1		NDËRTIMI I PARKUT NË LAGJEN E TAHIRSYLAJ			
Vërejtje: Të gjitha pozicionet përshijnë, furnizimin me material, transportin, shkarkimin si dhe vurjen në vepër të materialeve për secilin pozicion					
S.1.1	Punët përgaditore	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
S.1.1.1	Irregullimi i punështes, pastrimi i terrenit nga shkërrat dhe largimi deri në depozitë	m ²	1,000.00	1.00	1,000.00
S.1.1.2	Lavrimi dhe Frezimi i terrenit	m ²	1,000.00	1.00	1,000.00
S.1.1.3	Përgaditja për mbjelljen e barit	m ²	1,000.00	0.30	300.00
S.1.1.4	Matjet gjeodezike dhe pikturimi i platus dhe trouarit në terren	m ²	1,000.00	0.10	100.00
Total					2,400.00
S.1.2	Punët e dheut				
S.1.2.1	Hapja e kanalit, gërmimi i humurit për trotuar dhe largimin e tyre deri në depozitë	m ³	50.00	5.00	250.00
Total S.1.2					250.00
S.1.3	Punët e trotuarit dhe kanalit				
S.1.3.1	Furnizimi me material, zhavor 0-60, shtrirja dhe ngjeshja t=20 cm.	m ²	30.00	15.00	450.00
S.1.3.2	Furnizimi me material, zhavor 0-31, shtrirja dhe ngjeshja t=10 cm.	m ²	25.00	15.00	375.00
S.1.3.3	Furnizimi dhe montimi i gureve skajor 20x20x100cm, në kalkulin të logaritit betoni i nevojshëm për montim	m	90.00	25.00	2,250.00
S.1.3.4	Furnizimi dhe montimi i kubezave të betonit me trashësi t=6cm, për llojin dhe dizajnin vendos organik mbikqyrës	m ²	100.00	10.00	1,000.00
S.1.3.6	Furnizimi dhe montimi i gureve skajor për pilaton dhe trotuarin nga rruga deri në pilatën me dimensione (0.6x0.2x100cm)	m	120.00	10.00	1,200.00
S.1.3.7	Furnizimi me material të nevojshëm dhe ndërtimi i kanalit të ujitjes me beton në formë trapezi me dimensione: baza 0.4, unjtë e kanalit 45° me gjatësi 60cm, pas muatimit të lehen fugat me gureve, gjatësia e kanalit është L=50 m.	m	50.00	15.00	750.00
Total S.1.3					6,625.00
S.1.4	Punët e fidaneve				
S.1.4.1	Mbjellja e fidaneve të perimeve dekoruese për shesh	copë	15.00	5.00	75.00
Total S.1.4					75.00
S.1.5	Punët e ulseve				
S.1.5.1	Blerja, transporti dhe vendosja e ulseve për rreth platos	copë	5.00	50.00	300.00
Total S.1.5					300.00
S.1.6	Punët e kronit				
S.1.6.1	Punimi i pushtes për lidhjen e furnizimit të kronit me ujë furnizimi i të gjithë aksesoreve për të funksionuar kronin, furnizimi i gypave për kanalizim me të gjithë aksesoret e nevojshëm	copë	1.00	100.00	100.00
S.1.6.2	Furnizimi i materialit dhe punimi i kronit nga materiali i gurit me të gjitha materialet e nevojshme për të funksionuar	copë	1.00	100.00	100.00
Total S.1.6					200.00
Totali me TVSH:					9,850.00
REKAPITULIMI I PËRGJITHSHËM					
1-4	TOTALI I 4 URAVE ME TVSH				162,356.12
5	NDËRTIMI I PARKUT NË LAGJEN E TAHIRSYLAJ				9,850.00
TOTALI ME TVSH					172,206.12





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Drejtoria e Arsimit
02/Zyrtarisht
Datë: 15.02.2024

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-40 mbi Vetëqeverisjen Lokale, Statutit të Komunës së Deçanit 01.Nr.IX—datë 31.10.2019, Ligjit Nr.03/L-068 për Arsimin në Komuna të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Drejtori i Arsimit në Deçan, me datën 15.02.2024, bie këtë :

V E N D I M

Për: Emërimin e Grupit punues të Komunës së Deçanit për hartimin e Planit Zhvillimorë të Arsimit në Komunë e Deçanit (PZHAK) viti 2024 – 2026.

I

Formohet grupi punues me këtë përbërje:

1. Besnik Hulaj, drejtor i DKA-së
2. Hysen Balaj, koordinator, Dr.sc. Pedagog
3. Hamid Qorraj, anëtar, drejtor shkolle
4. Enver Osdautaj, anëtar, profesor
5. Jeton Hulaj, anëtar, profesor
6. Afrim Balaj, anëtar, zv. drejor
7. Xhevat Bozhadaraj, anëtar, shef i sektorit të arsimit
8. Zeqë Malaj, anëtar, zyrtar për arsimin fillor, të mesëm të ulët
9. Ramiz Bajramaj, anëtar, zyrtar për arsimin e mesëm të lartë
10. Gjylshahe Haklaj, anëtare, përgjegjëse për buxhet dhe financa – arsim
11. Besart Cacaj, anëtar, jurist – DKA
12. Prof. Dr.sc. Ramë Likaj, konsulent i jashtëm

II

Kompetencat dhe autorizimet e grupit, janë Hartimi i Planit Zhvillimor Komunal të Arsimit në komunën e Deçanit.

III


Pagesa e grupit punues do të behet sipas Ligjit të Pagave Nr. 08/L-196.

IV

Vendimi hyn në fuqi, menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës

-Me vendim njoftohen:

- Të emëruarit si në piken 1, të këtij vendimi;
- Arkivi komunal.






REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



RAPORT FINANCIAR
JANAR – QERSHOR 2024

Drejtoria për Buxhet dhe Financa



Dt.30.06.2024
Deçan



Hyrje

Qëllimi i këtij raporti është që të njoftojë Kryetarin, Bordin e drejtorëve, Komitetin për Politikë dhe Financa si dhe Kuvendin Komunal, për realizimin e buxhetit komunal përfshirë buxhetin e secilës Drejtori – Programet buxhetor, duke filluar prej programeve të Administratës së përgjithshme, Shëndetësisë primare, Arsim dhe Shkencë, për periudhën Janar – Qershor 2024, duke përfshirë kategoritë ekonomike të paga & mëditje, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione dhe investime kapitale.

Realizimin i të hyrave komunale - vetanake dhe strukturën e tyre sipas burimeve të tyre, në mënyre analitike, të hyrat nga gjobat e trafikut dhe të gjykatave.

- ❖ Prezantimi i të dhënave në këtë mënyrë mundëson:
 - Prezantimin e raportit financiar në formë transparente dhe të tërësishme,
 - Shikimin e realizimit, respektivisht shpenzimin e mjeteve sipas kategorive (pagave & mëditjet, mallra dhe shërbimet, shpenzime komunale, subvencione dhe investimet kapitale.
 - Mundësin e krahasimit në mes fondit të planifikuar, të alokuar dhe të shpenzuar sipas kategorive, se a është tejkaluar-shfrytëzuar apo nuk është shfrytëzuar fondi i planifikuar, alokuar,

- ❖ Në këtë mënyrë nga aspekti financiar është e arsyeshme të paraqitet:
 - Realizimi i të hyrave vetanake-komunale sipas burimeve,
 - Shpenzimet e krijuara sipas kategorive buxhetore,
 - Përqindja e realizimit të buxhetit për këtë periudhë kohore.

Të dhënat e poshtë shënuara, sa i përket shpenzimeve për paga, mallra & shërbime, shërbimeve komunale, subvencioneve, investimeve kapitale si dhe regjistrimi i të hyrave, sipas klasifikimit ekonomik janë të harmonizuara me Departamentin e thesarit të Ministrisë për Financa dhe raportet që dalin nga SIMFK - Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës.

Dt.31.03.2024

Deçan

TABELA 1 :

PLANIFIKIMI I BUXHETIT 2024 DHE SHPENZIMIMI SIPAS KATEGORIVE EKONOMIKE PËR PERIUDHEN JANAR – QESHOR 2024

PERSHKRIMI	PLANIFIKIMI	SHPENZIMI	DIFERENCA
GRANT QEVERTAR (10)	12,660,516.95	9,000,494.64	(3,660,022.31)
PAGAT DHE SHTESAT	7,294,439.95	4,939,012.50	(2,355,427.45)
MALLRA DHE SHERBIME	2,330,890.00	1,597,736.67	(733,153.33)
SHPENZIME KOMUNALE	250,000.00	138,184.82	(111,815.18)
SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	249,000.00	117,844.43	(131,155.57)
INVESTIMET KAPITALE	2,536,187.00	2,207,716.22	(328,470.78)
TE HYRA VETANAKE (21)	847,565.00	254,850.40	(592,714.60)
MALLRA DHE SHERBIME	217,938.00	116,515.71	(101,422.29)
SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	41,000.00	4,752.69	(36,247.31)
INVESTIMET KAPITALE	588,627.00	133,582.00	(455,045.00)
TE HYRA VETANAKE (22)	157,135.53	130,762.95	(26,372.58)
MALLRA DHE SHERBIME	118,044.60	96,162.95	(21,881.65)
SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	103.00	-	(103.00)
INVESTIMET KAPITALE	38,987.93	34,600.00	(4,387.93)
GRANT I DONAT.TË BRENDSHËM (31)	16,027.70	-	(16,027.70)
MALLRA DHE SHERBIME	4.00	-	(4.00)
INVESTIMET KAPITALE	16,023.70	-	(16,023.70)
GRANTE TJERA TË JASHTME (32)	974.50	-	(974.50)
MALLRA DHE SHERBIME	974.50	-	(974.50)
QEVERIA NORVEGJEZE (57)	7.98	-	(7.98)
INVESTIMET KAPITALE	7.98	-	(7.98)
QEVERIA JAPONEZE (59)	4,416.00	2,800.00	(1,616.00)
MALLRA DHE SHERBIME	4,416.00	2,800.00	(1,616.00)
COUNCIL OF EUROPE	43.65	-	(43.65)
MALLRA DHE SHERBIME	43.65	-	(43.65)
TOTALI :GRANTI + THV	13,686,687.31	9,388,907.99	(4,297,779.32)

Dt.31.03.2024

Deçan

TABELA 2.

PLANIFIKIMI I TË HYRAVE VETANAKE (21) DHE REALIZIMI JANAR –QERSHOR 2024

PERSHKRIMI	PLANIFIKIMI	REALIZIMI	DIFERENCA
TE HYRAT VETANAKE (21)	847,565.00	396,523.62	(451,041.38)

TABELA 3 :

RAPORTI I SHPENZIME SIPAS PROGRAMEVE FONDIT BURIMOR DHE KODEVE EKONOMIKE PËR PERIUDHEN JANAR- QERSHOR 2024

Kodi I programit	Kodi Ekonomik	Përshkrimi	Shuma
631		Total : Granti (10) + THV (21)	9,388,907.99
		10-GRANTI	9,000,494.64
16015		ZYRA E KRYETARIT	448,414.35
	11111	PAGA NETO	59,598.00
	11121	TATIMI NË TË ARDHURAT PERSONALE	4,454.46
	11131	KONTRIBUTI PENSIONAL - PUNËTORI	3,748.92
	11151	SINDIKATAT	121.26
	11211	PËRVOJA E PUNËS	2,833.40
	11311	KONTRIBUTI PENSIONAL - PUNËDHËNËSI	3,748.92
	11431	KUJDESTARIA, PUNA GJATË NATËS & PUNA JASHTË ORARIT TË PUNËS	825.63
	11611	SHTESAT TRANZITORE	3,394.31

	13142	AKOMODIMI PËR UDHËTIMET ZYRTARE JASHTË VENDIT	5,956.90
	13143	SHPENZIMET E TJERA PËR UDHËTIMET ZYRTARË JASHT VENDIT	5,432.95
	13320	TELEFONIA MOBILE	37,287.40
	13440	SHËRBIMET KËSHILLDHËNËSE DHE PROFESIONALE	5,331.58
	13445	SHERBIMET E VEQANTA -KONSULENTË DHE KONTRAKTORË INDIVIDUAL	17,718.20
	13460	SHERBIME KONTRAKTUESE TË TJERA	320.00
	13504	PAISJET E TJERA TË TEKNOLOGJISË INFORMATIVE DHE TË KOMUNIKIMIT	34,078.00
	13610	FURNIZIMET PËR ZYRË	28,293.80
	13780	DERIVATET PËR AUTOMJETE, GJENERATORË DHE MAKINERI	9,478.16
	13820	AVANCË (PARADHËNIA) PËR UDHËTIME ZYRTARE	2,614.72
	14060	MIRËMBAJTJA RUTINORE	12,113.10
	14310	KOMPENSIMI I PËRFAQËSIMIT BRENDIA VENDIT	3,749.40
	14410	VENDIMET GJYQËSORE	132,836.24
	21110	SUBVENCIONET PËR ENTITETET PUBLIKE	16,000.00
	21200	SUBVENCIONET PËR ENTITETET JOPUBLIKE	28,600.00
	22200	TRANSFERET SOCIALE PËR INDIVID	400.00
	22298	PAGESAT PËR SHËRBIMET E VARRIMIT	18,179.00
	22299	QIRAJA PËR RASTET SOCIALE	1,800.00
	22300	VENDIMET GJYQËSORE	9,500.00
16315		ADMINISTRATA	115,787.86
	11111	PAGA NETO	63,818.25
	11121	TATIMI NË TË ARDHURAT PERSONALE	3,404.95
	11131	KONTRIBUTI PENSIONAL - PUNËTORI	3,713.63
	11151	SINDIKATAT	181.01
	11211	PËRVOJA E PUNËS	3,029.16
	11311	KONTRIBUTI PENSIONAL - PUNËDHËNËSI	3,713.63
	11431	KUJDESTARIA , PUNA GJATË NATËS&PUNA JASHTË ORARIT TË PUNËS	126.11
	13140	TRANSPORTI PER UDHËTIME ZYRTARE JASHT VENDIT	5,460.00
	13330	SHËRBIMET POSARE	369.10

Dt.31.03.2024

Deçan

	13460	SHERBIME KONTRAKTUESE TË TJERA	1,462.60
	13610	FURNIZIMET PËR ZYRË	16,324.00
	13620	FURNIZIMI ME USHQIM DHE PIJE (JO DREKA ZYRTARE)	4,210.34
	13640	FURNIZIMET E PASTRIMIT	3,207.50
	13780	DERIVATET PËR AUTOMJETE, GJENERATORË DHE MAKINERI	315.40
	14010	MIRËMBAJTJA DHE RIPARIMI I AUTOMJETEVE	84.00
	14230	SHPENZIMET PËR INFORMIM PUBLIK	2,792.00
	14310	KOMPENSIMI I PËRFAQËSIMIT BRENDA VENDIT	3,576.18
16629		INSPEKSIONI	24,007.37
	11111	PAGA NETO	15,114.30
	11121	TATIMI NË TË ARDHURAT PERSONALE	1,181.70
	11131	KONTRIBUTI PENSIONAL - PUNËTORI	620.57
	11151	SINDIKATAT	30.98
	11211	PËRVOJA E PUNËS	770.79
	11311	KONTRIBUTI PENSIONAL - PUNËDHËNËSI	620.57
	13445	SHËRBIMET E VEÇANTA - KONSULENTË DHE KONTRAKTORË INDIVIDUAL	2,627.00
	13610	FURNIZIMET PËR ZYRË	743.40
	13620	FURNIZIMI ME USHQIM DHE PIJE (JO DREKA ZYRTARE)	146.58
	13780	DERIVATET PËR AUTOMJETE, GJENERATORË DHE MAKINERI	133.09
	13951	SIGURIM I AUTOMJETEVE	156.89
	13952	TAKSA KOMUNALE PËR AUTOMJETE	75.00
	13954	KONTROLLIMI TEKNIK I AUTOMJETEVE	30.00
	14310	KOMPENSIMI I PËRFAQËSIMIT BRENDA VENDIT	1,756.50
16775		PROKURIMI	17,076.30
	11111	PAGA NETO	13,061.64
	11121	TATIMI NË TË ARDHURAT PERSONALE	992.24
	11131	KONTRIBUTI PENSIONAL - PUNËTORI	800.10
	11151	SINDIKATAT	59.36
	11211	PËRVOJA E PUNËS	1,089.22

Dt.31.03.2024

Deçan

	11211	KONTRIBUTI PENSIONAL - PUNËDHËNËSI	800.10
	13440	SHËRBIMET KËSHILLDHËNËSE DHE PROFESIONALE	50.00
	13460	SHERBIME KONTRAKTUESE TË TJERA	66.00
	13450	SHËRBIMET E SHTYPJES/PRINTIMIT	54.04
	14310	KOMPENSIMI I PËRFAQËSIMIT BRENDA VENDIT	103.60
16915		ZYRA E KUVENDIT KOMUNAL	125,299.66
	11111	PAGA NETO	81,732.21
	11121	TATIMI NË TË ARDHURAT PERSONALE	7,016.57
	11131	KONTRIBUTI PENSIONAL - PUNËTORI	5,538.78
	11211	PËRVOJA E PUNËS	412.19
	11211	KONTRIBUTI PENSIONAL - PUNËDHËNËSI	5,538.78
	11411	SHTESA E VEÇANTË PËR TË ZGJEDHURIT	17,174.65
	13445	SHËRBIMET E VEÇANTA - KONSULENTË DHE KONTRAKTORË INDIVIDUAL	1,858.60
	13460	SHERBIME KONTRAKTUESE TË TJERA	1,500.00
	13501	MOBILJET	1,744.00
	13780	DERIVATET PËR AUTOMJETE, GJENERATORË DHE MAKINERI	415.08
	14010	MIRËMBAJTJA DHE RIPARIMI I AUTOMJETEVE	364.00
	14310	KOMPENSIMI I PËRFAQËSIMIT BRENDA VENDIT	2,004.80
17515		BUXHETI	833,230.76
	11111	PAGA NETO	39,487.89
	11121	TATIMI NË TË ARDHURAT PERSONALE	2,715.95
Po atëherë falënderit kryesues përshëndetje për të gjithë. Sa i përket raportin njëvjeçar të punës së kryetarit, atëherë, pra nëse do të vazhdojmë me fjalimin e tij, ndaj unë kam për të folur vetëm për transparencën komunale, e cila tregon më së miri qeverisje komunale. Kjo pra është e dhimbshme që komuna e Deçanit nga 31 komuna është radhitur, komuna e 27 me radhë, pra të nderuar ekzekutiv komunal. Kjo nuk është qeverisje që meritojnë qytetarët e Deçanit. Pasi qe mostransparenca komunale tregon 1 qeverisje jo te pastër dhe se nuk është në favor të qytetarëve. Por po ashtu për shkak të keqqeverisjes komuna jonë nuk ka qenë asnjë herë përfituese e grantit për performancë komunale.

Kryesuesi I Kuvendit, Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë, a ki me shtu diçka, Manjollë?

Manjolla Shala

Ashtu siç thashë, raporti performancës siç është publiku ka qenë për vitin 2022, jo për vitin 2023 ky raport, por ky raport është për vitin 2023. Nëse keni diçka për vitin 2023.

Hyri Dobrunaj

Meqenëse që u votu për me u diskutua sot raporti, kryetari nuk qenka këtu, thatë që i ka deleguar kompetencat te Nënkryetari, por as aj nuk qenka. Do të thotë kompetencat a i ka delegu te dikush tjetër nuk e di, por ajo shumë pak ka rëndësi, krejt qa po du me thon janë pyetjet me bazë, sepse nuk mundë të përgjigjet dikush i cili nuk është përgjegjës për tu përgjigjë. Por sa i përket Info raporti I ketij viti i progresit komunave, sa i përket komunës Deçanit e cilëson komunën e Deçanit si të papërmirësueshme në aspektin e prokurimit. Këte e tregon edhe kjo lista që keni paraqitur me projekte sepse kjo absolutisht nuk përputhet as me projektet

kapitale të komunës për viti 2023, të cilat ju vetë I keni pasur dhe i keni shfaqur. Kaq mjafton për këtë raport, sepse asnjë nga ju nuk jeni kompetent me ju përgjigj këtij raporti.

Hajdar Sutaj - mbetur tek 00:20:05 – 00:20:09

Falënderit shume, znj. Dobrunaj, dikush tjetër? Atëherë i mbylli diskutimin sa I perket këtij raporti.

III. Shqyrtimi i raportit analitik financiar për vitin 2023

Kryesuesi e ka prezentu raportin pastaj ka shtuar se e kemi prezent edhe drejtoreshën për buxhet dhe financa znj. Dafina Cacaj. Nëse ka dikush diçka lidhje me raportin e hapim diskutimin.

Blinera Lokaj

Raporti financiar ngërthen në vete të njëjtat dukuri negative sikurse raportet paraprake. Përkundër rekomandimeve të thëna nga auditori i jashtëm dhe kërkesave e çështjeve të ngritura nga ana e opozitës, ky raport shpërfaqë më së miri gjendjen financiare dhe shpërndarjen e buxhetit për një periudhë të caktuar kohore. Të gjeturat e buxhetit tregojnë që shpenzimet zyrtare është plot 66.000 euro, që nëse e përpjestojmë për ditë pune i bie që gjatë vitit 2023 për secilën ditë, ju keni shpenzuar nga 264 euro në ditë vetëm për dreka. Gje qe eshte Për të ardhur keq, pasi që këto mjete kanë mujt me u shpërnda për nevoja të qytetarëve. Po ashtu shpenzimi I buxhetit vjen edhe nga pagesa. Përmes vendimeve gjyqësore të cilat vijnë jo gjithmonë vetëm nga kontrata kolektive, por edhe nga operatorët ekonomik siç është Limi Vizion, Lika Trade. E pastaj ka edhe emra të përveçëm. Verejtje kam te Drejtoria për shërbime publike, çka nënkupton përshkrimi I investimeve në vijim. 2 herë është investime në vijim dhe është shumë i paqartë. Po ashtu tek drejtoria për buxhet dhe financa. Çfarë shërbimi ka kryer PRO ACC group, e cila buxhetit të komunës i ka kushtuar plot 27.500 euro? Këto ishin vetëm disa nga të gjeturat e këtij raporti. Ne si grup bëjmë thirrje ekzekutivit komunal që ta ruajë buxhetin dhe të mos e shfrytëzojë pa kontroll.

Drejtoresha per Buxhet dhe Financa, znj.Dafina Cacaj

Faleminderit për pyetjet, dashta me tu pergjigj pyetje që mu drejtove të dreka zyrtare është enorme. Ok, është mendim i yti. Po janë shpenzimet që nuk janë vetëm dreka zyrtare, kanë të bajnë edhe me furnizimin komplet që kemi aktiviteti nuk do me thonë që si eshte përshkrim drek zyrtare që na jemi duke shku me hongër dikun diçka. Po jan çdo aktivitet që ka të bëj me komunën që është i organizum edhe osht bo shpenzim ne emer te drekave zyrtare. Te investimet, investimet ne vijim dmth çdo kontrate që është në vazhdimësi trivjeçare është duke u investuar ajo përshkrimin ose kodin ekonomik e ka investime ne vijim. Ndërsa kompania PRO ACC Group. Është kompani që e ka fitu ni tender për vlerësimin e pronave për vlerësim monetar të pronave komunale dhe të objekteve. Pjesa e 1-rë, eshte kone ni pagese 27,000 euro tash e kam edhe pjesën tjetër eshte përmbyllë si projektit po duhet me bo pagesën ket vit unë emrat nuk jav kom ngjit, qeshtu qysh I kan pas jav qes paret. Shërbimi që ka kryer vlerësimin monetar pronave ka bo edhe të objekteve komunale që veç e kemi raportin . Hala nuk e kemi implementuar nëse vlerësoni me jav sjell muj me jav sjell edhe pse asht shume voluminoz.

Orges Tafilaj

Faleminderit kryesues përshëndetje për të gjithë. Prej fillimit të ktij mandati e kemi dëgju drejtoreshën duke thënë që po mundohet me u përmirësu çdo ditë. Kështu që fillimisht po fillojme me i lavdat, mirë që na keni sjellë raporte përmbledhëse për zëra caktum. Megjithatë, unë besoj që do të ishte e dobishme te hynin edhe zera tjerë financiar, një prej tyre do të thoja, unë do ishte e rëndësishme që pasqyrohen llogaritë e pagueshme, për shkak se edhe po ta studiojmë detajisht këtë raport, shohim që ne po bëjmë pagesat gjithmonë këtë vit për

vitin paraprak financiar, një numër të madh tyre dhe njëkohësisht po ta dinim për shembull, a kemi pagu faturat e papaguara, derivateve, fatura të papaguara, dreka zyrtare ndaj operatorëve të ndryshëm ekonomik do e dinim ose do kishim një pasqyrë ma të qarte edhe për gjendjen e komunës, duke e pasqyruar me buxhetin që e kemi. Te pjesa e dreka zyrtare janë 66.000 mbas përmbledhjes, pa përfshin 23.000 që ishin për ushqim dhe pije, karburante për vetura, 153.000 rreth 153.000 pa përfshirë 111.000 naftë për ngrohje dhe 46 mijë për derivate për gjeneratorë dhe ajo që është shqetësuese dhe që po diskutojmë çdo herë kur po diskutojmë raporte të tilla jonë, janë pjesa e mjeteve që merret përmes vendimeve gjyqësore dhe atyre përmbarimore. Për pjesën e vendimeve gjyqësore pashë te pasqyruar në raportin përmbledhës, por jo atë pjesën e atyre përmbarimore, sepse ishte vetëm një pjesë prej 137.000. Ndërkohë, vlera e tërë i afrohet afër 2 milionëve. Dhe n'këtë pjesë e rreth 500.000 euro merren vetëm nga operatori Lika Trade, afër 500 euro dhe e kemi diskutu prap që njëjtën kohë dhe higjiena ka marrë mjetet financiare përmes përmbarimeve. Besoj që duhet të ketë diskutime nëse jo me operatorët ekonomik, të paktën me kompaninë që ne e menaxhojmë si asamble edhe diskutojmë që mos të na dërgojnë te përmbaruesi kompania Higjiena. Pjesa tjetër që lind si pyetje është, çka është përfshirë në mirëmbajtje rutinore? Kemi mirëmbajtje të automjeteve. Ndërtesa, shkollës apo objekte shëndetësore, teknologjisë, mobiljeve. Pajisjeve të ndryshme dhe pastaj kemi edhe një vajtje rutinore që vlera në krahasim me vitin paraprak është rreth 110.000 më shumë. Nëse mundesh drejtoreshë me na u pergjigj çka përfshihet në mirembajtje rutinore.

Drejtoresha per Buxhet dhe Financa, Dafina Cacaj

Raportin financiar nëse dëshironi me te detajun Une mund te jau dergoj, aty jane te parapame edhe obligime të papaguara. Gjithçka është e inkorporume ne ta, na obligim nuk e kemi me sjell ne asamble, obligim e kam me publiku ne webfaqe. Mirëpo nëse ju e vlerësoni çdo vit kurdo që e përgatiti javë sjell, edhe aty keni taman ne detaje që mos të bëjnë 2 herë, 1 herë për juve ni raport, njëherë për ministrinë, nëse e vlerësoni në muajin shkurt ju sjell në asamble raportin financiar pasqyrat financiare, pasi veç i kom dorëzu edhe nese marr komente, atëherë deri me 20 shkurt ke mundësi me bo Ndryshimet në shkurt që me ardhe te ju me vlerësu edhe ju me diskutu nëse keni diçka me shtu. Te obligimet tjera ose te zërat unë nuk muj me ditë saktë çka kem me pagu, na kërkohet të hyjnë si mirëmbajtje rutinore. Mirëpo është kod i përgjithshëm sikur që është mirëmbajtja e ndërtesave, mirëmbajtjen e veturave ose të gjitha mirëmbajtje tjera që kanë një herë si kod pune me vazhdu me mirëmbajtje rutinore ose Mirëmbajtje e ndërtesave është e njëjta e njëjta gjë. Te vendimet gjyqësore ose operatorët, ata kanë pritur afatin kohor të pagesave, Momentin kur nuk janë paguar obligimet ata kanë shkuar me procedura tjera për realizimin e të drejtës së tyre.

Mon Selmanaj

Të nderuar kolegë tek ky raport vërejmë një tendencë të përmirësimit krahasuar me raportet paraprake, sepse na janë prezantuar të hyrat e rregullta të planifikuara dhe të realizuara për vitet 2022 dhe 2023 dhe krahasimi i tyre. Në fakt në faqen 3 të raportit na mungon planifikimit të hyra për vitin 2022. Përderisa kemi këtë mungesë, nuk mund të themi se kemi 1 krahasim të saktë të realizimit e as përqindjeve të realizimit të të hyrave. Risi tjetër e këtij raporti është se ne na ofruar të gjitha pagesat në vendimet gjyqësore përmbarimore për vitin kalendarik 2023, në mënyrë unike në faqen e fundit të kti raporti çka na e ka lehtësuar punën dukshëm ne përpunimin e tyre. Përveç këtyre 2 përpjekje për të përmirësuar pasurimin e tij, brendësi te ky raport nuk shohim ndonjë ndryshim krahasuar me raportet paraprake. Ky raport është tepër shpenzues ose shpenzime të pakontrolluara te të gjitha kategoritë ose programet buxhetore si, Subvencionet, karburantet, drekat zyrtare, kontratat për shërbime të veçanta, shërbimet intelektuale, udhëtimet zyrtare, kredit kartela, vendimet gjyqësore etj. Për të ilustruar këto që po i them, po i marr disa fakte të gjetura në raport e që për mua janë të papranueshme dhe shqetësuese për këto shpenzime buxhetore për këtë periudhë kohe. Vendimet gjyqësore

përmbartim 88. Në shumën prej 2.071.323 euro. Unë ju kam drejtuar zotit kryetar po tash po ju drejtohem ju si drejtoresh, se a mund të na shpjegojë pse janë të gjitha këtu vendimet gjyqësore përmbartim? Mbi 2 milion është dashtë me u pagu me përmbartues ku ne si komunë i kemi dëmtuar bizneset, duke mos ua paguan mjetet në këtë periudhë inflacioni të lartë. Duke i detyruar ata që me procedura gjyqësore ti marrim mjetet e tyre. Dhe sa është shumë shuma apo borxhet e mbetura për vitin 2023 që do të barten në vitin 2024. Pastaj karburantet i kemi në shumën prej 151.044 €. Dreka zyrtare, unë e kam në shifër tjetër 73.864 euro. Udhëtimet zyrtare dhe medita nga meditet nga zyra e kryetarit 10.164. Une, nuk e di që Kryetari, ne të gjithë këto udhëtime zyrtare asnjëherë nuk na ka dhënë 1 informacion për punën dhe angazhimet e tij në këto udhëtime zyrtare. Dhe cili ka qenë puna për benefitet e komunës nga këto udhëtime, pra meqenëse këtu janë shpenzimet me kredit kartelë 2.426 euro. Zyra e kuvendit karburante 3.887 euro euro, siç e dini ju koleg nderum Kuvendi nuk posedon makinë paktën zyrtarisht jo. Kur jemi te zyra e kuvendit, atëherë zoti kryesues i kuvendit. Përveç drekave zyrtare që normal pije këto sende të tjera që i duhen kuvendi të gjitha Me kontrata të veçanta ose të paguhet me kontrata të veçanta nga zyra e kuvendit. Mendoj nuk janë të arsyeshme këto. Dhe kisha pas dëshirë që ju të ndikoni që herave tjera në raporte tjera të mos vij në këtë formë, siç janë për zyrën e kuvendit, sepse janë të papranueshme. Janë shumë të papranueshme. Të nderuar kolegë. Unë jam i vetëdijshëm se 1 institucion edhe ma i vogli, qoftë ai nuk mund të funksionojë pa mjete buxhetore. Mirëpo shpenzimi i parësë publike duhet të jetë në përputhje me nevojat dhe kërkesat e qytetarëve, jo shpenzime të pakontrolluara jashtë planifikimeve buxhetore. Ndaj ky raport dëshmon qartë deri në detaje keqmenaxhimin dhe keq shpenzimin e parësë publike.

Dafina Cacaj

Te kriteret kryesore me rëndësi është kualifikimi ose raporti i auditorit Tjetra ka të bëjë me shpenzimin e buxhetit. Unë qata tparën hala skam mujt mi ra në fije qysh me përmirësu, buxhetin bile pe shpenzoj mbi 90 përqind, bile qeta mos ma permeni. Keshtu qe ku ka mjete tjera edhe nëse janë kontrata ose nuk janë të asaj drejtorie une i shpenzoj me afat kohor. Te kreditkartela kryetarit e 2.400€, krejt vitin 3.000 euro minus mund të merr, ose nëse ka udhëtime zyrtare me i shpenzu domethonë. Unë besoj se është njëri ndër kryetarët që mas paki bën shpenzime zyrtare kudo që shkon. Edhe është hera e 1-rë, viti i 1-rë që e ke zbuluar që mundem me bo tjerët e kanë prej pasluftes. Te karburantet shpenzimet për udhëtimet që I kan ose për faturat ose për udhëtimet qe I ka kuvendi ose zyrat. Edhe nëse nuk ka vetura zyrtare na karburantin javë qesim në vetura private për me mujt me kry ni shërbim ose ni punë zyrtare në Prishtinë. Te vendimet gjyqësore përmbartim pjesa më e madhe janë për shujta. Besoj e keni parë prej profesorave në arsim, pjesa tjetër janë prej kategorive tjera që nuk e kanë pritur afatin e pagesës se ka kaluar afati pagesës dhe na kanë detyruar që me shku në përmbartim. Mirëpo më shumë se 1 milionë janë që kanë të bëjnë me arsim me shujta.

Hyri Dobrunaj

Ne këto 2 fletë e fundit që janë pagesat me vendime gjyqësore dhe përmbartues, Për periudhën janar dhjetor 2023 figurojnë gjithsej 82 kolona. Shuma totale e paraqitur nga kryetari dhe drejtoresha në këtë kolonë është 1.885.976 euro. Fillimisht mendova edhe unë si Moni sa mirë na e paskan bërë punën ma t'lehtë. Por duke e ditë se si funksiononi, si funksionon edhe si maskoni abuzime që i bëni me paratë e taksapaguesve, isha e bindur që duhet shikuar secilën drejtori veç e veç. Do të thotë nuk i kemi vetëm 82 kolona ose thënë ndryshe. 82 lende gjyqësore, por i kemi 100 lëndë gjyqësore. Vendime me përmbartim. Ku janë edhe 12 pagesa tjera që nuk figurojnë këto faqe. Ju lutem shihni faqen e fundit tek raporti financiar. Drejtoria për shërbime publike dhe kolonat e pa paraqitura, shuma për këto kolona është 104 dhe 1.820. Të gjitha së bashku, atëherë i kemi me përmbartim 2.027.796 euro. Plus 2 kolona tek drejtorati për shëndetësi me numër rendor 352353 me shumën 85.000 tjera të paraqitura, që raportin e bien gjithsej m 2.112.796 euro Totali, prej këtyre mjeteve

904 3.880 janë paguar nga mallra dhe shërbime, ndërsa nga projektet kapitale janë paguar 1.168.915. Nuk ka rëndësi për çka janë pagu mjetet. A paguhen për shujta apo paguhen për operatorë të ndryshëm. Rëndësi ka që keni keq planifikim. Që do të thotë se komuna është dashur ti ketë investimet kapitale dikund rreth 4 milionë dhe ka vetëm 2.000.612, Ndonjëherë dhe mund të ndodh që ndonjë projekt të jetë vazhdimësi e një projekti paraprak i mbetur pa paguar për ndonjë arsye ose për një tjetër, por nuk guxon të ndodhë gjykata ti ketë 100 landë nga 1 komunë. Kjo i bie se keni 8,35 landë në muajë, për 12 muaj të vitit. Paramendojeni nga kapitalet i kemi pagu me përmbarues për dreka e darka. qe nuk arsyetohet? Keni paguar nga kapitalet për naftë, për vetura që nuk arsyetohet mobilje dhe autosallone. S'po hyj në projektin nëse keni bërë gjysmën e re dhe mbesin, mirëpo këto janë kategori që nuk duhet t'ju ndodhë për këto kategori më i madh i kapitaleve. Kjo është abuzim. Kjo me të vërtetë është e pafalshme.

Kjo është arsyeja pse komuna e Deçanit nuk i ofron asnjë shërbim normal qytetarëve të saj. Këtë e shpjegon ma së miri fakti nese shiqoni faqen 10 te kodi 1 4 0 3 2 mirëmbajtje auto rrugë lokale 0 euro për 2 vitet e fundit kjo është mjerim edhe tek mallra shërbime sipas programeve me kod 1 4 4 1 10 dhe i kemi mbi 92.950 euro pagesa për ndëshkime për vendimet gjyqësore, kjo do të thotë se nga mallra shërbime janë marrë gjithsej 1 milion. 0 36. E kom ni pyetje për drejtoreshën këtu, ket fletën e 1-rë tek kolona tek ky kodi 1 4 0 6 0 osht shuma 135.000 në vitin 2023. Çka nënkupton kjo? Edhe plus. Mirëmbajtja rutinore, çka çuni mirëmbajtja rutinore se nuk është pak 130.000 euro.

Dafina Cacaj

Na ka ardh hesapi mu mar me kolona domethonë un shumë mirë I kom punt edhe mum kqyr sa kolona I kam mungu prej cilit rresht. Te përgjigjja, mirëmbajtja rutinore service pyetje mrriva me me bo Jon, mirëmbajtja e rrugëve. Mirëmbajtja, ndërtesa, mirëmbajtja e makinave të gjitha hyn në mirëmbajtje. Nuk ka lidhje cili kod në e kemi ma të përshtatshëm për me bo rrugë. Mirëmbajtja e rrugëve nuk është kapitale.

Faton Selmanaj

Faleminderit kryesues, pyetja ime është lidhur me vlerësimin pronave nga Kompania PRO ACC grup. Cili është qëllimi i atij vlersimi?

Dafina Cacaj

Qëllimi i vlerësimit moneta të pronave , prona komunale është se ma herët nuk e kemi pasur një vlerësim të pronave. Ndoshta jemi ndër pak komuna që kemi bo sivjet e disa kan fillu, por shumica nuk e kanë bo hala, na jo pse jemi në hapat e 1-ra të tjerëve duke marrë vërejtje prej auditorëve 2 herë, 2 vite më herët rresht dhe e kemi vlerësu qe me ba prej një kompani private se është ma e sigurt ndoshta, se sa me ba vet me komisione dhe merr shumë kohë. Jam konsultu dhe me auditorët e me tjerë që është më e arsyeshme është me bo ni kompani e licensuar për këtë punë dhe Regjistrin e pasurive nuk figurojnë pronat komunale, edhe osht ni vlerësim i objekteve komunale që e kam pas deri tash e për këtë arsye kemi vendosur dhe kemi vlerë monetar edhe të pronave dhe objekteve që ka dalë vlerën 63 milion pasuria e komunës prej pronave dhe objekteve komunale.

Sylë Balaj

Pershendetje per te gjithëve e kisha 1 pyetje rreth raportit financiar, ku janë mbi 150.000 euro te shpenzimit të karburanteve a bon me dit sa vetura i posedon komuna e Deqanit, pse janë gjith ato shpenzime.

Dafina Cacaj

Veturat nuk I kam me numer sa i posedojmë ne pergjithesi, po karburantin ne mungesë të veturave zyrtare ja qesim në një veturë të zyrtarit që mundet me kry një shërbim deri në Prishtinë. Nuk mundemi me i blloku punët pse nuk kemi ni veturë zyrtare, vetura zyrtare janë edhe zjarrfiksat që kanë nashta shpenzime ma tmdhaja ose QKMF-ja me autoambulancë dhe këto te tjerat. Nuk e di sa i kem se nuk e di numrin e saktë.

Vatan Istrefaj

Kryesues, atëherë po rreth raportit financiar për të mos i përsëritur ato që i thanë kolegët në radhë. Po po shohim që është 1 avaz i njëjti përdorimit, i keqmenaxhimit financiar shihet se ka rregullisht përmbarues. Dreka darka mbi 88 000 euro, por përse drejtoreshë nuk e merrni asnjëherë vërejtje për bazë? Po e shihni pronën komunale si pronë private këtu, apo si institucion komunal, këtu është vërejtja. Pse ne e shohim ne çdo raport ku kemi domethënë dreka zyrtare, top, luks, non stop, edhe mos pahiri këto te dreka zyrtare është shfrytëzuar dhe për takime partiake.

Dafina Cacaj

Nuk mundet shpenzimet per dreke me pagu diçka tjetër. Unë çkado që kemi shpenzu dhe kemi pagu dhe gjithçka është arsyetu me faturë . Ne fakt për çdo shpenzim ne japin llogari, unë jap edhe dikujt tjetër, këtu japim sqarime për çka keni ba ju pyetje normale,jo me tendecë.

Miftar Ahmetxhekaj

Atehere Faleminderit, ndoshta e kemi thënë edhe në raste të tjera, komnatat I kanë 3 dokumente bazike qe realisht edhe ju si pushtet ekzekutiv duhet ti kushtoni rendesi edhe duhet ti merrni pak vërejtjet ose sugjerimet ma me gjakftoftesi ndoshta pak ma me sportivitet. E 2-ta po flasim për ni buxhet I cili shpenzohet nga taksat qytetarëve te Deçanit. Çka është raporti i 3-të nëse sgaboj në këtë legjislacion që po trajtohet është përgjigja ose premtimi juaj, ne do te bejme perpjekje, Unë e kam vetëm një pyetje kurë do të përfundojnë përpjekjet tuaja për të përmirësuar, une nuk e marr të drejtën shumë me thane keqperdorim, por tejkallim ligjorë, janë tejkallime ligjore, por ju nënshkruani kontrata për shërbime me persona fizik,të njëjtë, ku të njëjtëve persona ju nuk mundeni me jau pague dhe ata ju qesin ne permbarues dhe prap krijoni marrëdhënie detyrimore me te njejtit persona, e dyta une te uroj qe ju mos te zgjidhni rrugë tjera për , perndryshe krijoni prap shpenzime tjera.

Hajdar Sutaj

Falemnderit, pasi që nuk k ate lajmeruar tjerë për fjalë e mbylli si temë.

IV. Shqyrtimi dhe aprovimi i planit të punës së kuvendit për vitin 2024.

Kryesuesi e prezentoj piken pastaj kërkoj prej grupit AAK a ka dikush diçka më thonë. Ju prej grupit LDK-së. Ai ka thënë per matrialin të cilën e keni e keni përpara, e kemi edhe ni pikë të cilën e kemi shtu në muajin Qershor- Raporti i auditorit të jashtëm për NPL “Higjiena”, pastaj e hapi debatin rreth kësaj teme.

Hyrije Dobrunaj

Plani i punës së kuvendit unë besoj që duhet me shtu, sepse është 1 punë që e dimë që duhet të me ndodhë në komunë gjatë vitit, raportin analitik financiar tremujor, duhet me qenë prill qershor shtator. Plus edhe për përgatitjen e buxhetit edhe ato eshte dashte mu parapa ketu, plus edhe Korniza e 1-rë.

Hajdar Sutaj

D

Kështu ne, për shembull ne kete periudhe, ne prill e kemi raportin, shqyrtimi i raportit financiar periudhën janar 31.03.2004. Po ashtu e kemi në Nëntor Shqyrtimi i raportit nëntë mujor financiar.

Mon Selmonaj

Faleminderit. Për miratimin e këtij plani të punës, ne na duhet që për janar pikën 3 dhe 4 te parapame, me hartimin e planit që keni bërë ju këto dyja duhet të hiqen nga ky plan dhe pastaj të miratohet si tersi, nëse të gjithë pajtohen. Unë propozoj që këto 2 pika të largohen nga këtu sepse nuk mund të miratohen, ose ky plan nuk mund të miratohet nëse janë këto 2 pika Brenda tij, Marrja vendimit paraprak për dhënien e pronave në shfrytëzim afatgjatë deri në 99 vite, dhe Formimi i komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme. Nuk mund të miratohet ky plan me këto 2 pika brenda, prandaj unë kërkoj që këto dy pika të hjeken në mënyrë që ti ipet rrugë këtij plani kështu siq është, faleminderit.

Albesa Cacaj

Thotë se kam propozim për pika të rendit të ditës, e propozoi, Raporti i performancës komunale, edhe pse vitin e kaluar nuk ka qenë, pastaj konsideroj tejet e rëndësishme raportin për barazi gjinore. Edhe ky plan i punës parashihet që së paku 2 herë ne vit, kryetari i komitetit vjen dhe na jep raport për të arriturat, poashtu edhe objektivat e planit për barazi gjinore. Gjithashtu konsideroj të rëndësishme, edhe pse s'ka qenë praktikë deri më tani, por është edhe ky obligim ligjor i cituar që plani I aktiviteteve të komitetit për komunitete së paku 2 herë në vit, komiteti për komunitete të raportojë në kuvendin e komunës për punën, objektivat dhe aktivitetet. Kjo ishte rekomandim.

Miftar Ahmetxhekaj

Po ndaj tendencë definitivisht tash problematike është pjesa e janarit, na i kemi 3 ose 4 pika, të cilat realisht nëse votojmë diçka që nuk realizohet. Është mirë kjo të shënohet edhe pse unë e kam ni farë problemi, edhe pse ne kalum si i tillë të emërtimi raporti i kryetarit që ky raportim nëse lexojmë kështu është realisht raporti i Komunës së Deçanit, a ka nevoj me hy në këtë ose me ndryshu në faqen e parë të raportit mund të jetë teknik, po realisht raportet janë të ekzekutivit, raporti nuk është enkas i kryetarit të Komunës.

Albesa Cacaj

Raporti i performances Diskutohet por nuk votohet, është obligim ligjor brenda vitit kalendarik, tashme me propozim.

Hajdar Sutaj

Të falemnderit shumë diçka tjetër apo dikush. Kështu i qes në votim një nga një propozimet të cilat u japën nga ne, në radhë të parë Shqyrtimi i raportit të auditorit të jashtëm të NPL Higjiena, për shqyrtim në muajin qershor, kush është për, a ka kundër, a ka apstenim? Konstatoj që e kemi shti si propozim, që ti largojmë këto 2 pika të cilat i propozoi Mon Selmonaj, gjegjësisht pika 3 dhe 4, të cilat janë propozim, kush është për, a ka kundër, a ka apstenim, konstatoj që e kemi futur propozimin, që të futet si propozim Raporti i komitetit komuniteteve, në muajin korrik dhe dhjetor, kush është për, kush është kundër, a ka apstenim, Falemnderit Raporti për barazi gjinore, në qershor, kush për, kush kundër dhe kush apstenon, edhe raporti për performancë komunale. Atëherë ne me propozimet të cilat kanë qenë edhe me propozim, ndryshimet të cilat

i botë sot e qes në votim Planin e punës së kuvendit për vitin 2024, Konstatoj që në mënyrë unanime kuvendi ka miratuar planin e punës për vitin 2024.

V.Marrja e Vendimit për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta dhe mbledhjeve publike të Kuvendit dhe mbledhjeve të KPF-së

Kryesuesi e prezentoj kete pike pastaj hapi diskutimin rreth saj.

Hyrije Dobrunaj

Prapë qëndroj te propozimi im ku kam kërku qe mbledhjet e kuvendit të mbahen të premten e fundit të muajit. Vetëm në rastet kur ka ndonjë festë ose diçka tjetër për arsye se edhe ne jemi të koncentrumë në mendje që të premten e fundit ka mu majt mbledhja e kuvendit.

Miftar Ahmetxhekaj

Termi mbledhje publike, kështu që është nuk hasë shumë, ndoshta është mirë me konë takime publike të kuvendit, mbledhjet janë të rregullta të kuvendit, ndërsa çdo gjë tjetër është takim publik se s'ka mbledhje dhe kush e zbaton, unë këtu pak kam dilemë, unë mendoj se së pari do të jetë kuvendi për shkak se ne jemi sponsorizues, mund të jetë kryetari i 2-ti, po parësore duhet të jetë kryesuesi eventualisht Kuvendi e monitoron, kuvendi është ai i cili e zbaton.

Hajdar Sutaj

Koleg i kemi 2 propozime realisht 3 propozime të cilën e kemi sjellë ne, propozimin që edhe kolegëja Hyri Dobrunaj dha, dhe propozimet që dha zoti Miftar Ahmetxhekaj. Sa i përket propozimit për të premten e fundit, personalisht po foli, mendoj që të jetë fundi i muajit. Nuk na obligon vetem për një ditë të caktume, sepse kur e obligoi atë ne patjetër duhet me zbatu. Sa i përket propozimit të kolegut Miftarit, po, mundemi për me ba këtë ndryshim dhe e qes në votë.

Florim Mataj

Të propozimi qe tha kolegu për takimet publike që me i thirr kuvendi, na e kemi edhe në statut që të drejtën për thirrjen e takimeve publike e ka edhe kryetari.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë, atëherë e qes ne votim fillimisht propozimin për mbajtjen e mbledhes në të premten e fundit të muajit, propozim i cili nuk kalon, pastaj e qiti ne votim propozimin qe mbledhja te mbahet ne fund te muajit, me 14 vota miratohet, atëherë ne e kemi lënë që fundi i muajit jetë mbledhjet rregullta të kuvendit. Jemi të propozimi i zotit Miftar Ahmetxhekaj që të ndërrohet terminologjia, Jo mbledhje por takim të jetë, me të cilin propozim pajtohen.

Miratohet vendimi për mbajtjen e mbledhjeve te rregullta dhe mbledhjeve publike të kuvendit si dhe mbledhjeve të KPF-së për vitin 2024, me të cilin vendoset që mbledhjet e kuvendit të mbahen në fund të çdo muaji, si dhe te neni nr.3 duhet të bëhet ndryshimi te terminologjia në vend të mbledhje publike duhet të jetë takime publike të Kuvendit, te neni 7, zbatimin e vendimit e bënë, së pari- kryesuesi dhe kuvendi, pastaj Kryetari I Komunës, vendimi merret me 2 vota abstenim, 24 për.

VI. Marrja e vendimit për ndarjen e parcelave për ndërtimin e 3 çerdhe për fëmijë në fshatin Gramaqel, fshatin Isniq dhe në fshatin Strelle i Epërm

Kryesuesi- e prezentoj piken pastaj e përshëndeti drejtorin e arsimit, i cili është këtu Besnik Hulaj, e a ki diçka me prezantu tash apo vetëm më i referoheni materiali të cilin keni marrë.

Arjan Dobraj

Falemnderit kryesues, si grup e kemi mirëpritur këtë aksion, është një ide shumë e mirë dhe një plan shumë i mirë edhe natyrisht që do të duhet më përkrahë fuqishëm me çdo lloj kompetence secili prej neve, sepse është një projekt shumë i mirëseardhur. Nuk kemi diçka tjetër me shtu, falemnderit.

Hajdar Sutaj

Falemnderit shumë prej LDK Vatan Istrefaj.

Vatan Istrefaj

Sa i përket kësaj pike, pra jemi shumë në rregull. Projekt i qëllueshëm. Megjithatë unë kam një pyetje te fshati Strelle i Epërm, pra drejtori i shkollës ka mbajtur 1 takim me këshillin e prindërve, këshillin e shkollës dhe mësa kam informatë janë koordinuar që Qerdhja të jetë aty tek fusha sportive. A ka mundësi drejtori me na shpjegue, ku do të jetë saktë dhe nëse keni bërë ndërrimin e lokacionit afër shkollës vjetër me na treguar, pra edhe për kapacitetin sa do të jenë. A do të jetë me numër afërsisht e fëmijëve që do të jenë në ato lokalitete?

Drejtori I Arsimit, Besnik Hulaj

Ka sqaruar për lokacionin ku do të vedoset si dhe takimet që ka pasë me drejtorin e shkollës në fshatin Strelle dhe se janë koordinuar që Qerdhja të jetë aty tek fusha sportive, si dhe kapaciteti për 40 fëmijë që ndërtohet qerdhja.

Faton Selmanaj

Ne si grup e përkrahim këtë kërkesë, por unë po tani pyetje për drejtorin, sa është kapaciteti i gjithë së cilës çerdhe veç e veç. Sa ka kapacitet për akomodim.

Besnik Hulaj

Kapaciteti për çerdhe është më i vogël për 40 fëmijë, për momentin vetëm projekti i Strelle është sjellur nga Minitaria dhe nuk jemi të informuar saktë për kapacitetin.

Mon Selmonaj

Drejtor përshëndetje, në arsyetimin tuaj, në pikën 3 thuhet, mendojmë që do të kemi nevojë për këto çerdhe të reja në komunën tone, njëkohësisht janë bërë analiza të tjera, duke mos përjashtuar vështirësi të tjera

organizative që dalin në vazhdim për funksionimin e çerdheve që janë në kompetencën e komunës, atëherë nëse janë bo analiza të thukta të mirëfillta, atëherë cilat janë këto vështirësi që do të na paraqiten organizative? Sepse ne nuk mund të ndërtojmë çerdhe nëse paraprakisht jemi njoftuar për vështirësitë organizative, këtu nuk po thotë. vështirësitë që na dalin, po organizative, domethonë që komuna ka vështirësi në funksionimin apo menaxhimin e këtyre Qerdheve, mund të na shpjegosh çka keni desh me thone me këtë, duke mos përjashtuar vështirësi të tjera organizative.

Besnik Hulaj

Për pyetjen, fillimisht nuk janë vështirësi këto për ndërtim të çerdheve të fëmijëve, psh, vështirësi janë kompletimi komplet I dokumentacionit, Kjo është 1 ndër vështirësitë e 2-ta është prej këtu duke marrë. Marrë pëlqimin Pas plotësimit, duke organizuar edhe fjala, ka qenë për vështirësitë, por deri te rregullimi kompeticioni.

Miftar Ahmetxhekaj

E para të përgëzoj për projektet, është prej kërkesave të para që personalisht shikon drejt kuvendit për Infrastrukturë të tillë, siç janë. Por unë i kam 2, 3 dilema. Proceduralisht deri ku kanë shkuar ato projekte, kush i ka hartuar këto projekte edhe a ish dashte ne me qet material ne të na vijnë për shkak se për ta aprovuar, ne si kuvend të japin mbështetje, është dashtë paraprakisht ta dimë, cila është shtrirja. S'është problemi ndoshta shumë të Isniqi që e ka ni parcelë që është mjaftueshëm. Është problemi të Strellci, unë jam munduar pa dashur ta përcjellë, nëse ju i afërohemi shkollës, për dijeninë tuaj ajo është objekt i trashëgimisë, që ju thashë juve, që ju shtohet edhe një vështirësi, që nëse është më afër se 50 metra, ju duhet të shkoni te Ministria e kulturës ta merrni pëlqim. Këtë e them, a ka project, nëse e ka bo komuna pse so dashtë të vjen në kuvend pse keni sjellë në kuvend, ta shohim shtrirjen, bazat, prerja e objekteve në parcela, kaq. Përndryshe projektet e tilla janë të mirëpritura.

Besnik Hulaj

Planet për ndërtim të çerdheve I bën Ministria, ajo i ka gjitha zonat, të gjitha statistikën i cakton ministria na vetëm jemi të obligum me I nda parcelat, me nxjerrë një pëlqim prej komunës, edhe komplet me projektin, ne jemi duke krye procedura për me ardhë deri te leja e ndërtimit.

Miftar Ahmetxhekaj

Drejtor shkurt kështu, ka projektet të shkruar në letër dhe dilema ime është pse nuk I keni sjellë këtu, të paktën vetë baza, vetëm ku ka me u vendosë në parcelë,

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë drejtorja keni për ni koment shtesë. Ju e Besnik Hulaj e ka fjalën drejtor veç.

Besnik Hulaj

Si përgjigje, unë e kam materialin por është shumë voluminoz,

Miftar Ahmetxhekaj

Unë e kam një project I cili nëse vendoset në fshatin Strellc më afër se 50 m. unë këtu e bëj shkeljen, këtu e kam dilemen.

Besnik Hulaj

Ne Strellc është shkolla par shqipe edhe jemi te informuar se ajo është në mbrojtje Edhe kemi pasë kontakte me ministri dhe disa zyrtarëve që merren me e kulturore. Kemi pas kontakte dhe në të ardhmen gjithçka është e mundshme. Afër mundem sepse ne mungese te hapësira publike. Gjithçka i është aty, kemi edhe përgjigje pyetjeve, por gjithçka i kemi diskutuar sepse ju mi mar 1 vendim, Ju jini organe legjislativ, Jemi për me mbrojtë gjith qysh.

Hyri Dobrunaj

Edhe unë gjithashtu ju përgëzoj për ndarjen e parcelave, për punën që po beni per me nda ato parcela për çerdhet e fëmijëve, ka qenë kërkesë e kahershme, secilit anëtar të asamblesë besoj unë sepse ka qenë nevojë. Kjo është një lehtësim për nanat e reja qe dojnë me punu edhe e mirëpresin. Sa I përket dokumentacionit unë besoj që në suazat të ligjit keni me shiqu dhe me I nda këto parcellat dhe me pregatit dokumentacion. Nuk dyshoj aty që nuk e bëni mirë punën, por unë e kom ni pyetje tjetër komuna e Deçanit para ni kohe e ka ndërtu ni çerdhe për fëmijë, mirëpo ne si komunë nuk kemi qenë në gjendje me e menaxhua çerdhen dhe ajo ka kaluar në sektorin privat. Sot ne nuk e dimë as a paguajnë qira për ate çerdhe, a paguhet a s'paguhet hiç, çka merr komuna prej asaj, nuk e kemi asnjë informacion. Unë e kom pyetjen konkrete këto çerdhe a kan me mbetë publike, a ka me kon publiko-private apo kanë mu privatizue sikur edhe ata, por kjo është pyetja dhe dilema ime.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Hyrije Besnik Hulaj drejtori e ka fjalën.

Besnik Hulaj

Na jemi konsultu edhe me ministrinë edhe çerdhet kanë me qenë publike, me një kosto shumë të ulët, vetëm sa me I mbulu shpenzimet sepse gjithqka ka me qenë nën menaxhimin e DKA-së. Njëkohësisht edhe çerdhja që ka qenë e ndërtume ma heret do të merret në menaxhim.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shume. Atëherë e qes në votim, Marrja e vendimit për ndërtimin e 3 çerdhe për fëmijë, në fshatin Gramaçel, Isniq dhe Strellc i Epërm, kush është për, Falemnderit a ka kundër. A ka abstenim, konstatoj që kuvendi në mënyrë unanime ka marrë vendim për ndarjen e parcelës për ndërtimin e 3 çerdheve.

VII. Marrja e vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për kontigjentin e 3-të të lopëve qumështore, marrëveshje dhe aneks marrëveshje.

Kryesuesi: e ka prezentu piken pastaj ka thënë se prezent është edhe drejtori për bujqësi të cilit fillimisht ia kaloi fjalën.

Drejtori I Drejtorisë për BPZHR, Rifat Stojkaj

Kryesues i kuvendit e anëtar të kuvendit komunal shumë respect, poashtu edhe kolege nga ekzekutivi. Fillimisht me lejoni të theksoj se ne muajin e kalum kemi përfunduar me marrëveshjen që e kemi pasur me organizatën për zhvillim rajonal mëshqerra, me të cilat janë shpërndarë edhe 34 lopë për fermerët tanë e që gjithsej janë 100 krerë lopë që kanë ardhur për fermerët tanë në komunën e Deçanit, 1 projekt ky i cili ka

pasur me zgjatë 2 vite, por që fatmirësisht kanë përfunduar më herët me lope të cilësisë më të lartë sa i përket cilësisë dhe qumështit. Sa i përket varjateteve I lopëve qumështore, që është raca me prodhim më të lartë sa i përket qumështit. Bëhet fjalë për ndarjen e 34.000 euro që janë pjesë e participimit të komunës së Deçanit për realizimin final të projektit me 3 kontingjente. Nëse keni diçka pyetje shtesë për diçka jam këtu për ju.

Hajdar Sutaj

Falemnderit shumë drejtor. Të përgëzojmë për punën dhe për angazhimin. A ka dikush prej grupit AAK, Jo, prej grupit LDK-së Miftar Ahmetxhekaj.

Miftar Ahmetxhekaj

E vlerësoj punën tuaj, por unë vetëm 1 pyetje kam, kjo është vazhdim apo aneks kontratë, a i keni bërë analizë zbatimit të marrëveshjes, a ka pru ndonjë profit, apo mos është më mirë që bujkut dhe blegtorit ti afrohet 1 infrastrukturë që ai vetvetiu ta rrit kapacitetin duke i afuar mundësitë.

Hajdar Sutaj

Falemnderit Miftar, fjalën e ka drejtori.

Rifat Stojkaj

Miftar falemnderit për pyetjen e pyetje me vend. Realisht si staf i drejtorisë së bujqësisë, neve vit për vit e vizitojnë fermerët e marrim mendimin e tyre dhe pastaj i nxjerrim ato planet tona që mundet me qenë planin 1 vjeçare 2 vjeçare 3 vjeçare dhe 4 vjeçare. Ka qenë kërkesë e fermerëve që të ndihmohen në realizimin e këtyre projekteve pra subvencionohen apo ndihmohen në shtimin e krerëve, e për me pa efektin e 1-rë e kemi pa, kemi rritje, kemi rritje edhe e sasisë së qumështit të deponuar. Njëkohësisht kemi dhe fermerë të ri që po aplikojnë për subvencione. Ne thirrje të ministrisë së bujqësisë po ta japin informacion vitin 2019 kanë qenë 650 fermerë që kanë aplikuar për subvencione në ministrinë, ndërsa vitin që lam pas komuna e Deçanit janë 913-të fermer që kanë aplikuar për subvencione. Kriter ka qenë ata fermerë që posedojnë 1 deri 3 lopë, 1 fermer që ka. Informacion tjetër shtesë se Komuna e Deçanit këtë vit për herë të 1-rë renditet e 4-ta në Kosovë, sa i përket numrit të prodhimit të qumështit, ndërsa e para Kosovës sa i përket cilësisë së qumështit, kjo pak a shumë është për shkak të relievit që kemi që kemi ne vetë si Deçan. Po që i bjen që komuna e Deçanit ka potencial në zhvillimin dhe kultivimin e blegtorisë. Sa i përket investimit në infrastrukturë e siç e dini, gjithë neve kemi qenë përfituesi i projektit nga ministria e bujqësisë vitin e kaluar, të cilat po realizohen diku, ne fund të pranverës realizohen diku 9 kilometra kanal i ujitjes në 2 lokalitete në fshatin Isnik dhe në fshatin Llukë, ndërsa këtë vit besoj që do të përfundojë rreth 14 fshatra me kanalet e ujitjes që do të fillojë në pranverën e këtij viti do të jetë 1 projekt gjigant, i cili do t'ju ndihmojë jashtëzakonisht fermerëve në ujitjen e pronave të tyre bujqësore.

Orges Tafilaj

Kryesues drejtor përgëzime për punën. Fillimisht simbas numrave që i kemi këtu i bie që blegtori paguan 400 euro për kokë meshqerre komuna 1.000 dhe OJQ-ja rreth 2.000. Realisht, 2.000 euro. Njëjtën kohë është pare, është paraparë edhe pajisja me hortikulturë, ushqim dhe vitaminë, tashmë duket e kemi diskutuar dhe herë po që ta kemi 1 pasqyrë të qartë sa kushton 1 krerë lopë dhe sa është pjesa e ushqimit sipas marrëveshjes që kemi.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Orges, Rifat Stojkaj e ka fjalën.

Rifat Stojkaj

Faleminderit Orges për pyetjen e realiste në treg e 1 mëshqerrë me këto karakteristika sillet çmimi 2.500 deri në 3.000 euro. Fermerët nuk paguajnë 400 euro për kokë për krerë nuk është participim për mëshqerën por është participimi për shërbimet që do ti marr gjatë 3 viteve, duke filluar nga ato gjanat koncentrate që ju i përmendet edhe shërbimet e tjera veterinare. Pjesa tjetër e shkon participim domethonë 2.000 e për krerë nga organizata, ndërsa komuna participon për 1 krerë lopë, 1.000 euro për secilin fermer.

Mon Selmanaj

Bujqësia drejtor është një fushë e gjerë, në kuadër të saj hyn, Blegtoria, ujitja, Lavertaria, bletaria e kështu me radhë. Unë edhe kur është miratu buxheti kom kerku qe drejtorja ju të ketë buxhet më të madh për vitin 2024, çka nuk kom pas mbështetje. Ndaj unë jam mirënjohës dhe jam përkrahës që kjo kërkesë e juaja të aprovohet nga kuvendi. Mirëpo kjo nuk do të thotë që ju të mos kërkonit edhe fusha tjera, të mos bëni kërkesa të ndryshme e posaçërisht nga bletaria. Deçani sipas shoqatës bletarëve është kryeqyteti i bletarisë në Deçan. Dhe duke pas parasysh se vitet e fundit po ballafaqohet me shume mungesë te ushqimeve në natyrë. Pasi që unë jam në prej anëtarëve të shoqatës së bletarëve ndaj mendimin e tyre, që bletarët kanë nevojë për subvencione të ndryshme në fushën e mbjelljes së farave apo luleve mjaltëdhënëse. Dhe ju kisha sugjeru ju përmes jush edhe kryetari i komunës, ne si kuvend që ta kemi parasysh, që mujt ne vijim apo vitet në vijim, Shoqata e bletarëve bletaria në tansi të ketë prioritet në mënyrë qe mos te hupim epitetin e qendrës kryesore të bletarisë në Kosovë.

Rifat Stojkaj

Po është vërtetë, e them me gojën plot se Deçani është dhe do të jetë qyteti i bletarisë në republikën e Kosovës, Po e them sepse ne kemi punu pak a shumë t'ju ndihmojmë ne këtë aspekt vitin 2022. Je njoftu edhe ti, sepse ke qenë anëtar i kuvendit komunal. Komuna e Deçanit ka ndihmu me mekanizëm dhe mjete pune. Dhe ndërsa këtë vit takimin e 1-rë që e kam ba me 1 organizatë të tillë ka qenë takime me shoqatat e bletarëve. Realisht më pëlqejnë. Kam qenë vetë propozues. Të kemi 1 shoqatë përbashkët se nuk mund te quhet ky, pasi. 4 shoqata që kanë qenë grupacione të ndryshme që kanë ofru, ndërsa tani kemi 1 shoqatë të përbashkët, e cila e realizon aktivitetin e saj. Në të përbashkët për të mirën e qytetarëve të komunës së Deçanit e ka qenë ide e imja në takime me shoqatën ju kanë propozue qe ata takohen së bashku edhe të mabjë 1 numër të bletarëve që janë të interesuar me mielljen e parcelave për farëra apo që është e mirë dhe realisht ju pret përgjigjen e tyre. Dhe nëse ata shprehën gatishmërinë e tyre që të kenë parcelat apo punën atyre që janë të gatshëm ti mbjellin, pa dyshim që komuna e Deçanit do ti subvencionoj.

Florim Mataj

U Than t'githa sa i përket marreveshjes qe ka ardh sot. Ne e dimë që kontigjenti ka ardhë vetëm kanë mbetë mjetet financiare, une e kam falenderu publikisht drejtorin per angazhimet e veta..

Hajdar Sutaj

Atëherë e qesim në votim vendimin, për miratimin e mjete financiare për kontigjentin e 3-të me lope qumështore, marrëveshja dhe anex marrëveshja. A ka kundër abstenim. Konstatoj që mënyrën unanime kuvendi e ka marrë vendimin për ndarjen e mjeteve,

VIII. Ndryshimi dhe plotësimi i Komitetit për komunitete.

Kryesuesi: zyra lokale për komunitete dhe kthim dhe komuniteti boshnjak i komunës së Deçanit i propozojë kuvendit për plotësim të komitetit të komuniteteve me përfaqësues të komunitetit boshnjak. Zonja Ellda Sharohoviq, në vend të Hako Sharohoviq. E kemi këtu dhe përfaqësuesin e zyrës për komunitete, Zoti Shaban Pejçinoviç .Nëse Kini dicka më thonë koleg.

Arjan Dobraj

Faleminderit kryesues. I nderuar Shaban është hera dytë apo e 3-të deri me tani që po na vijnë ndërrime, anëtarësime të reja në këtë komunitet. Kemi pasur vërejtje edhe më herët nuk po na vjen prapë ni SiVi ose diçka që mundem na me e kuptu se çfarë kontributi mund të jep ai person në Komitetet. Edhe tani raportet e komuniteteve vijnë kështu, kurgjo hiq, s'kanë asnjë lloj vlere dhe kur vijnë, të perealizushme, se skan qysh mu realizu kur ne te marin pjesë persona, sikur kjo vajza këtu. Edhe kish qenë ma e udhës, po besoj me ardh kjo biografia shumë e pasur qenka, me nga 3 rreshta, në gjuhën shqipe, apo dorëheqja, po prapëseprapë në gjuhën shqipe ish kon mirë me ardhë. Se shqyr edhe mjetet përkthyes janë këtu. Prap se prap edhe është gjuhë zyrtare në kuvendi komunal, na flasin shqip dhe punojmë shqip.

Hajdar Sutaj

Arjan sa i përket gjuhës, komunitetet kanë të drejtë me përdor gjuhën e vet zyrtare. Unë e kom kërku edhe prej kryetarit që me planifiku domethonë që me pase dhe lektorë përkthyes, Zyrtarë ligjorë e tjerë, por çështja është se anëtarët e komuniteteve kanë të drejtë me përdor gjuhën e vet.

Hyri Dobrunaj

Fillimisht shfrytzoj rastin me kërku falje Shabanit që është prezent, sepse gjuha e komuniteteve dihet cila është gjuhë zyrtare, kështu që gjuha e tij, nëse unë se kuptoj duna me lyp ni përkthyes, ti je fajtor kryesues kur I thu Shabanit se nuk ardhe ne gjuhë zyrtare, këta I thonë gjuha e bosnjes, por është e njejta gja, por gjithsesi është gjuhë zyrtare dhe nuk kemi pse me diskutu rreth kesaj edhe unë e ndaj të njëjtin mendim me Arjanin. Po, shpesh po bëjnë ndërrime, po nashta ish konë e arsyeshme edhe ni biografi e kësaj zonjes ish kon mirë sikur kish ardhë ose t'ish prezantue sot, nuk është, herave tjera besoj që ka me qenë ma i kujdesshëm.

Orges Tafilaj

Faleminderit kryesues. Kjo puna e biografisë, puna që nuk janë pjesë e kuvendit është diskutuar edhe për komisione, Komitete tjera, do të thotë pajtohem me kolegë që duhet të bini një biografi. Nuk është vetëm rasti i Shabanit, janë rastet që po përsëriten gjithmonë. Do të thotë është mirë të bëhet shprehi që të kemi një biografi në lidhje me dorëheqjen e zotërisë. Shabani e japi arsyen për çka ka dhënë dorëheqje, personi paska shku në Gjermani, kështu që duke i besu Shabanit për personin që e kanë sjellë me u bashku në komitet, ne votojmë për.

Hajdar Sutaj

Falenderit shum Mon a ki diçka me shtu.

Mon Selmanaj

Biografia duhet të jetë patjetër e personit që ka me ardhë dhe kështu që nuk ka çështje tjetër.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë, e qes ne votim kush është për. A ka kundër, abstenim, okej faleminderit. E konstatoj që me. Ni vot abstenim dhe 23 për, e kemi votuar propozimin e zyrës lokale për komunitete dhe e kemi emëruar Zonja Elda Sharohoviç antare e këtij komuniteti.

IX.Marrja e vendimit për ndarjen e lokacionit për ndërtimin e pishinës gjysëm olimpike, sipas kërkesës së ministrisë për kulturë, rini dhe sport.

Kryesusi: Sipas kërkesës së ministrisë për kulturë, rini dhe sport naka ardhë kjo kërkesë, e kemi drejtorin për shërbime publike zoti Izet zenuni këtu, i cili mbron këtë pikë, por materialin e kemi marrë sot. E kemi votue që të jetë pikë diskutimi.

Izet Zenuni

Faleminderit kryesues të nderuar asamblistë, kolege është fakt se materiali ju ka ardhë me vonesë por ka ardhë me vonesë edhe nga niveli qëndrorë, nga Niveli qendror jemi njoftu se Komuna është përfituese, e nje granti prej 400.000 euro për ndërtimin e pishinës gjysmë olimpike, po kriteret të cilat i kanë parë pata që ti plotësojmë si komunë. Duhet te kryhen në afatin sa më shkurt që komuna te jetë përfituesi i grantit dhe fillojmë zbatimin. Prandaj kërkoj prej jush që ta votojmë edhe mos te lejome që këto mjete te shkojnë dikun tjetër.

Florim Mataj

Ne si grup I AAK-se e mbështesin, drejtori e dha arsyet që kanë pasë vonesë për projektin dhe Donacionin te cilin e kemi fitu dhe kërkoi edhe nga kolegët e asamblesë ta përkrahin, e nga drejtoria përkatëse të procedurës, dokumentacioni i nevojshëm.

Hyri Dobrunaj

Edhe ne e mbështesim donacion si donacion. Mirëpo sqarimin e drejtorit të nuk pajtohemi me ata se spo e kuptoj. Me sa e di une kjo pishina olimpike kjo pak pishina olimpike, faza e 1-rë e ndërtimit veç ka përfunduar. Këtu tashti fillon edhe problemi i prokurorimeve, që folëm parë, nuk me lat me fol, veq 3 minuta ke koha, do të thotë ju e paske fillu atë pa pas lokacion as pishinë olimpike a qysh osht, sepse ne e dimë që veç ka fillu punimi, faza e 1-rë e punimeve, tash është faza e 2-të tash po e kërkon vendimin e asamblesë komunale për ndarjen e lokacionit, e paske fillu pa e nda lokacionin, pa pas kopje të planit, pa pas flet poseduese, pa pas kurgjo. Aj sqarim që u dha është i pamjaftueshëm dhe i pavërtetë dhe nuk pajtohen me këtë. E. Materiali ka ardh me datën 22 parit kryesues, gjithmonë po flasim që materialet duhet me ardh me kohë për me mujt me diskutu rreth tyre sot edhe sikur të ishin plotësues kriteret që unë po them që s'janë kurrnjë, por është shumë shkurt për të diskutuar për tema që kanë rëndësi.

Hajdar Sutaj

Faleminderit drejtori Zenuni e ka fjalën.

Drejtori, Izet Zenuni

Shkresa është Protokolu me dat 22.01 ne ministri, ka ardh me poste ne Komunë, Projekti ka filluar vitin e kalum, vlerën e kam 900.000 euro pjesa e 1-rë, pjesa e komunës prej 500.000 euro, e 400.000 euro janë të ministrisë. Do të thotë është projekt realizimi për 2 vjet. Kjo është. Komuna ka pasë lokacionin në tërësi, por ministria ka kërkuar mi specifiku sakt për pishinë. Edhe këto e keni materialin përpara. Asnjë temë tjetër nuk

është. Kjo është e sakta dhe realiteti që është donacion. Ju mundeni mi votue ose mos me votu po por te sqaruar dhe qartë edhe në vendimin e ministrisë, njoftimin që jau kemi dërguar edhe materialet përcjellëse si e keni përpara që e definon saktë çka lypet prej neve, osht mirë me votue, se është interes komunës dhe qytetarëve dhe nuk është diçka që osht ka lypet që nuk mundem me bo këtë veprim, dmth. 5.000 euro komuna I ka investim, ndërsa 400.000 euro ministria e kulturës, ministria e kulturës kërkon vendim për caktimin e lokacionit këtu të realizohet, që ne të jemi përfituesit të grantit prej tij.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë. Ju ka përmend Hyrijes ka të drejt një minut replike.

Hyri Dobrunaj

Fillimisht thash që jemi për me mbështet, për me mar kete donacion. Mirëpo unë pyeta, ka përfunduar faza e 1-rë e pishinës olimpike, ka filluar ndërtimi, a e keni fillu atehere pa ndarjen e lokacionit, pa kopje të planit, pa projekt kryesor sipas kushteve ndërtimore. Qysh e keni fillu na jemi përë me mbështet këtë projekt, mirëpo unë po i kom këto pyetje, aty ka fillu dhe ka përfunduar faza e 1-rë. Qysh e keni fillu?

Hajdar Sutaj

Fjalën e ka, drejtori Zenuni.

Drejtori, Izet Zenuni

Projekti ka fillu vitin e kaluar, është projekt 2 vjeçar, nuk ka faza e pare dhe faza e dytë. Në qoftë se komuna i plotëson këto kriterë, ministria e kulturës e mbështet me vlerë 400.000 euro, domethënë është 900.000. Vlera e projektit 500.000 është komuna që ka bërë investim për momentin kur ka fillu komuna ndërtimet e saj ne kemi pasur në posedim në tansi projektin, të objektit qendrës rinore, kolonisë së artistëve, hapësirë koxha madhe. Ndërsa ministria ka kërkuar prej neve që me specifikue saktë vetëm me lokacionin e pishinës olimpike, sipas standardeve që ata i kërkojnë.

Orges Tafilaj

Unë besoj që edhe kur ka fillu ka pasë koordinim me Ministri dhe Komunë, e dyta a ka pasë hapsirë që pishina të jetë olimpike dhe e them këtë për shkak të lojrave mesdhetare që pritet të ndodhin në 2030-tën edhe do të ishte mire edhe për komunën tone që një pjesë e atyre lojrave të zhvilloheshin këtu.

Drejtori, Izet Zenuni

Fillimisht kur është mare iniciativa për mu ndërtu pishina gjysmë olimpike ka qenë ide e komunës dhe e Kyrterit për mu ndërtu dhe në momentin që është dhënë drita e gjelbërt për me fillue me u përgatit për lojërat mesdhetare në vitin 2030, ministria e kulturës dhe ministri Çeku, që ka qenë në vizitë në Deçan, së bashku me Kryetarin, kanë vendosë që pishina ti plotëson standardet gjysmë olimpike për lojërat mesdhetare. Por edhe kjo është arsyeja që e ka përkrahur edhe me grantin prej 400 euro komunën për mbështetje financiare të këtij projekti, domethënë është standard që është një lloj parapërgatitje për lojërat mesdhetare që kanë mu mbajtë në vitin 2030.

Miftar Ahmetxhekaj

Drejtor kështu një konsideratë, megjithatë sot nuk du shumë me të përgëzu për sqarime. Kur ka kërkesa, unë kam mrri me kuptue. Është dashtë ni shkresë, është dashtë një dokument me shkruar, me arsyetue Ju keni fillu ni projekt i cili paraprakisht e keni pasë një mbështetje. Dhe tash iu ka dalë që ju keni mbështetje financiare që po e kuptoj saktë dhe ata tash ju kërkojnë dokumenta shtesë. Dhe tash unë e kam një pyetje, Dimensionet e kësaj pishine, a është në parametrat ose ministria e kulturës e ka dhënë vizën që këto janë dimensionet që i përgjigjet. Aktualisht ju qysh e keni filluar ndërtimin.

Drejtori, Izet Zenuni

Faleminderit për pyetjen, se kur është bo projekti i pishinës gjysmë olimpike, do të thote se është gjitha parametrat që i ka sipas kriterëve të federatës së notit dhe ekspertët e asaj natyre, që pishina gjysmë olimpike i plotëson kriteret me qene e licencume edhe për garat ndërkombëtare dhe për format tjera të përdorimit. Domethënë Ministria e kulturës, momentin që ka pranuar të bashkëfinancojë projektin me neve do të thotë komuna e ka qitë tenderin dhe është zgjedhë operatori domethënë me mjete të veta me vlerë prej 900,000 euro. Gjatë rrugëtimit dhe maria e dritës së gjelbër që në Kosovë të mbahen lojërat mesdhetare 2030, Ministria e kulturës ka kërkuar që pishina të plotësojë edhe ato standarde që nuk i ka në projekt të jone të barabarta që të jetë e përdorshme për garat olimpike. Do të thotë edhe kur fillu edhe kur është projektuar I ka të gjitha standardet sipas ekspertëve të federatës së notit dhe ekspertët e drejtorisë së Urbanizmit.

Florim Mataj

Vetëm 1 fjali që u diskutu pak kur i dhashë mbështetje drejtorit për shpjegimet e arsyeshmërinë, e sqaroj pak edhe drejtori se projekti si projekt kur ka filluar, e kemi filluar si komune dhe komuna ka qenë vendosur të realizojë, por ka ardhë një mundësi që është një donacion nga ministri kur ka qenë ministër i kulturës, ajo është arsyeja që kërkoja për mi përkrahë, kështu që si projekt ka fillu ma herët, ndoshta si komunë nuk kishin mundur realizuar 2 vite, por ishte realizuar edhe nga komuna, por tash ka ardhë një mundësi tjetër që e sqaroj drejtoi.

Leotrim Hadergjonaj

E përshëndeti për gjithë, në bazë të kësaj shkrese drejtor, ministria ka lypë ndarjen e lokacionit vetëm për parcellën ekzistuese ku është fusha, se kjo është pronë komunale, si tërësi aty janë një 3 hektarë, por ata kanë lypë për shkak që më pajis me licencën e projektit, ashtu si janë rregullat dhe normat ndërkombëtare për fushë gjysmë olimpike për lojërat mesdhetare. Për atë arsye ata kanë lypë me bo ndarjen vetëm të pjesës së parkingut dhe hapësirës ku ka me qenë fusha gjysmë olimpike dhe ju përgëzoj për punën që keni bërë në këtë drejtim, shpresoj se edhe projektet është i gatshëm, në bazë të standardeve të reja që kanë kërkuar edhe të vazhdojmë punën më tutje.

Hajdar Sutaj

E faleminderit drejtor, meqenëse nuk lajmëron tjerë për fjalë, e qes në votim kush është për, A ka kundër, A ka abstenim. Konstatoj që kuvendi mënyrë unanime ka marrë vendim për ndarjen e lokacionit për ndërtimin e pishinës gjysmë olimpike.

X. Të ndryshme.

Yllarta Thaqi

Pyetje, Rregullorja për taksat komunale a ka hy në funksion apo nuk kanë funksione shumë rregullore gjatë vitit 2023 i kemi aprovu në kuvend, janë kthy po kërkush s'po na japin informacione se çka ka ndodhur me te, a janë kthy prapë me përmirësime, a janë aprovu nga MAPL-ja, çka ka ndodhë.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë, kështu koleg, jemi tek pika të ndryshme. Edhe e përfundojmë. Yllart, në këtë rast kush të jep përgjigje për këtë pyetje? Orges Tafilaj ka fjalën.

Orges Tafilaj

Faleminderit kryesues, realisht në mbledhjen e fundit e kemi diskutu me kryetarin problemin e vendosjes së kamerave dhe internetit në shkollë në Lëbushë, sot e paskemi edhe drejtorin e arsimit edhe drejtorin e shërbimeve publike, nëse kanë mundësi me na jap informacion çka po ndodh, do bëhet apo s'do bëhet, për shkak se në shkollë po përhapen fjalë që është anulë në tërësi ajo punë, e dyta drejtoresha e buxhetit, realisht kemi pasë bllokim të buxhetit prej përmbaruesve, a jan zhblloku mjetet dhe kur pritët të ndahen bursat për studentët përfitues.

Hajdar Sutaj

Ju falemnderit Orges, fillimisht Besnik Hulaj e ka fjalën.

Besnik Hulaj

Ne si drejtori dhe drejtori I shkollës jemi dakordu për vendosjen e kamerave në shkollën në Lëbushë, mirëpo nuk di deri ku kanë shku punët me vendosje të kamerave.

Hajdar Sutaj

Drejtor Zenuni e ka fjalën

Izet Zenuni

Kërkesa për vendosjen e kamerave ne shkollën e fshatit Lëbushë e kemi pasë në diskutim në Asamble por edhe një kërkesë prej drejtorit të shkollës Isniqit, operatorin e kam kontaktuar paraprakisht, në momentin kur kemi diskutuar në asamble, ne e kemi çuar në vendin e ngjarjes, por Operatorit i kemi pas borxh vitin e kaluar nuk e kemi paguar faktuar, ndërsa tash si të del buxheti menjëherë kemi me fill me e pague edhe në hapin e 1-rë ka me me bo vendosjen e kamerave ne fshatin Lëbushë, edhe osht ni temë tjetër që është diskutabile, monitorimin e atyre kamerave duhet të bëjnë shkollat, por Orges shumë shpejt kanë me u vendosë.

Hajdar Sutaj

Faleminderit drejtor, tash e ka fjalën.Drejtoresha Dafina Cacaj.

Dafina Cacaj

Për bursat Zyra e kryetarit I ka krye procedurat, kam planifiku ne mars me I ba shpenzim, edhe pse është vlerë bukur e madhe krahasuar me ate që ne e kemi planifiku, se pse me rregullore minimalja është 400 euro, do me thon mu ndel dyfishi i atyne sa na kemi planifiku dhe nuk e di ndoshta duhet me miratua mjete shtesë në asamble për me mujt me i kry krejt.

Hajdar Sutaj

D

Faleminderit drejtoreshë, Blinera Lokaj.

Blinera Lokaj

Pyetja ime ka të bëjë me drejtorin e Shërbimeve Publike, konkretisht ndriqimi public në fshatin Sllup, në seancën e muajit korrik poashtu e kam shtruar te njejten pyetje dhe ju kini premtuar drejtor se shumë shpejt do të rregullohet kjo problematikë, mirëpo kanë kaluar 6 muaj dhe ne ende nuk kemi ndriqim, a ka mundësi me na dhënë sqarim për këtë çështje.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Blinera, drejtori Zenuni e ka fjalën.

Izet Zenuni

Kjo temë është diksuar këtu pikërisht prej një qytetari, që është prindi yt. Momentin që kryhet pjesa ku janë duke punue në Dashinoc edhe në Ratish, kanë me kalu në fshatin Sllup domethonë. Edhe nuk qëndron fakti se 90% e teritorit është pa ndriqim public, por në momentin kur kryhen punët e filluara në fshtart e apostrofuara pastaj menjëherë do të kalojnë në pjesën e teritorit kah ju.

Hajdar Sutaj

Falemnderit drejtor, Hyri Dobrunaj e ka kryefjalën .

Hyri Dobrunaj

Në momentin kur po flasim komunën e Deçanit, në disa shkolla ka mungesë të kuadrove si për shembull arsimtarët e fizikës. Ka mungesë të kuadrove të arsimtarëve të matematikës që së shpejti për 1 afat kohor më largti 5 vjet kemi me pa që ka me qenë alarm për komunën e Deçanit, e posaçërisht për të ritë ç'e mendojmë me kriju familje, sepse nuk kanë me qene në gjendje me i çu fëmijët në shkolla kur nuk ka me pas kuadra me marrë mësimin e duhur dhe kanë mu detyru me shku me i shkollu në Pejë dhe në Gjakovë, ose me u shpërngul krejt, kjo duhet me kon kambanë alarmi për neve. Kom pyetje për drejtorinë e arsimit edhe për kryetarin, a keni mendu ni plan qysh keni me bon në afat shumë të shkurtë, sepse koha është shumë e shkurtër dhe nuk pret, çka doni me bo ket drejtim.

Hajdar Sutaj

Falemnderit Hyri, drejtori, Besnik Hulaj e ka fjalën.

Besnik Hulaj

Është e vërtetë që kemi mungesë, jo vetëm matematikë dhe fizikë, por kemi dhe në art dhe teknologji informative, kemi kater kuadër deficitare. Për momentin jemi tu shku me disa zëvendësime të përafërta, sepse është edhe me ligj e lejume. Si drejtori e arsimit dhe si komune i kemi subvencionu drejtimet deficitare me bursa, por për fat të keq kjo mungesë është në krejt Kosovën dhe jon tuj shku shumë pak kuadra në këto drejtime, edhe pse janë pak të vështira fizika e matematika, në teknologjinë informative dhe tjera.

Albesa Cacaj

Pyetje për drejtorin e drejtorisë së arsimit, pyetja është rreth ndërtimit të objektit të shkolles “Lidhja e Prizrenit” në Deçan, e cila ka filluar punimet në vitin 2019, punimet kanë fillu por objekti është ende i papërfundur, e dime që është investim i Misistrisë por a keni informacion ose a keni bërë diskutime me

ministrinë që punimet të rifillojnë, objekti të përfundojë, duke mos harruar asnjëherë gjendjen të cilët fëmijët tonë vijnë në mësimet në shkollën që as shkollë të mos quhet, Faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Albesa, Besnik Hulaj e ka fjalën.

Besnik Hulaj

Osht ni problem se besoj se gjithë këta çka jemi mbrenda përmrena në sallë është një problem që na preokupon shkolla e Carrabregut.. Problemi është se ministria e kanë arrit me ndërpre kontratën para një muaji, sepse ai ka dështue si punë kryes sepse ministrja I ka krejt në rregull letrat dhe dokumentacionin, por ai ka dështu, tash kanë arrit ministria e ka ndërprerë kontratën, tash duhet të hapin tender edhe sipas bisedave po jo diçka me shkrim se branda muajit e hapin tenderin, mirëpo gjithsesi aty do të ketë vonesë për kryerjen e punimeve.

Hajdar Sutaj

Albesa e ka një pyetje shtese .

Albesa Cacaj

Nuk e pata në kuptimin shkollë nuk mund të quhet për nga cilësia ose personeli. Asnjëherë, ai ka vlerësim maksimal. E pata fjalën nga brendësia dhe kushtet që ofron ajo shkollë. Të mos keqkuptohemi edhe nuk u referova te videot cilat janë postu nëpër media. Asnjëherë, iu referova në takimet ose vizitat që kam pasur në atë shkollë, nga momenti që hyn në atë shkollë, në korridor, nga dera, nga dyshemeja gjithçka është për të ardhur keq. Faleminderit.

Hajdar Sutaj

Falemnderit drejtori Besnik Hulaj e ka fjalën?

Besnik Hulaj

Vet fakti që ka filluar ndërtimi I një shkolle të re tregon se shkolla e vjetër ekzistuese nuk i plotëson kushtet.

Sylë Balaj

Për kërkesat e fshatit Isniq në mbledhjen e fundit pat thonë se në muajin dhjetor do përfundohen punimet, por spo di ne dhjetor 2024 a 2025, kërkoj përgjigje.

Hajdar Sutaj

Falemnderit shumë, Drejtorit Izet Zenuni ja kaloni fjalën.

Izet Zenuni

Ki të drejtë për shqetsim, por besoj që shumë shpejt do të kryhet, sepse nuk është ndonjë problem i madh. Shpresoj që shumë shpejt do të kryhen.

Hajdar Sutaj

Po. Yllarta Thaqi e ka fjalën.

Yllarta Thaqi

D

Dy pyetje I kamë, njëren për drejtorin Halil Tolaj, pse nuk është funksionalizu vendimin e mëhershëm për një të diele pushim për bizneset, Ose jo, Dhe drejtorit të zhvillimit ekonomik ose të Shërbime publike a e kini rregullu tenderin për emrime të rrugëve, shesheve, rugica për tabelat, sepse ni vjet prita asnjë përgjigje se mora.

Hajdar Sutaj

Drejtorit Halil Tolaj ja kaloni fjalën.

Halil Tolaj

E di se në KPF edhe ne kuvend eshte debatu qe te zhbëhet vendimi kryetarit I cili e pat pezullu ate vendim, dhe nuk mvaret nga drejtorati për inspeksion, por ne momentin kur merret vendimi që e shfuqizon vendimin paraprak Kryetari, me siguri do të mundohemi mi jetsu.

Izet Zenuni

Specifikacioni teknik dhe paramasa është gati e përgaditur, në muajin mars do te filloi procedura e tenderimit për emërtimin e fshatrave dhe shenjat e trafikut, qoftë horizontale ose vertikale, qoftë emërtimin e rrugës që janë të dëmtume, ne muajin mars fillojnë procedurat e tenderimit, shpresojmë se do të përfundoj shpejt sipas procedurave tyne edhe fillon kete vit..

Hajdar Sutaj

Falemnderit Mon Selmanaj e ka fjalën.

Mon Selmanaj

Falemnderit kryesues, unë e kom ni pyetje për drejtorin e arsimit dhe një për drejtorin e shërbimeve publike. Zoti, drejtor i arsimit, ditë më parë 1 punëtor i arsimit në shkollën Rexhep Kadrijaj Rastavicë, e ka postuar në facebookun e tij nje foto, ose ma sakt punëtori arsimit Adem Lushaj, i cili e ka pas nje foto të sallës së sporteve të dëmtuar dyshtemenë. Kjo ka rrjedhë nga të reshurat e shiut që aty pikojnë edhe prej se është ndërtu ajo sallë e sportit nuk keni mund me ndreqë ato dëme. A jeni në dijeni për këtë dëm? Edhe cilat janë? Ose, cili është aktiviteti juaj në këtë aspekt që ajo sallë sporti njëherë e përgjithmonë ta ketë 1 kulm adekuat i cili nuk do të nuk do të pikonte në fushën dhe kështu që do t'ia pamundësonte sikur e pamë edhe aktivitetet sportive në sallë. Falemnderit, ndërsa për drejtorin e shërbimeve publike. Drejtor, ditë më parë patëm të reshura të borës dhe sipas meje me vonesë kompanitë jonë dal në pastrimin e borës. Në fakt cila kompani është e kontraktuar për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve? Ne kemi pa që Kompania Lika e ka pastruar trotualet, mirëpo qe me vonesë janë pastru trotuarët. A është kompania Lika e kontraktuar apo është dikush tjetër? Dhe, 2. Disa shtylla elektrike i kemi gjatë rrugës kryesore nga Carrabregu deri të Ura e Demës të dëmtuara, a është bërë intervenimi aty. Cilët, kush e mirëmban rrjetin elektrik?

Hajdar Sutaj

Falemnderit shumë z.Mon, fillimisht ia kaloi fjalën Besnikut, me që se ke pyetja e 1-rë drejtori Besnik Hulaj e ka fjalën .

Besnik Hulaj

E për fat tmir salla osht bo por per fat keq nuk osht bo si duhet, drejtorja e arsimit nuk merr pjes ne pranim teknik, përpos vet Ministria. Për momentin e kemi 1 e- mail për investime kapitale nga ministria e arsimit, e Dokumentat gjitha shkollat jo vetëm për Shkolla për investime kapitale. Në mënyrë elektronike I kemi të D

gatshme edhe ta shofim, sepse ato e kan pasë 1 afat kohor, ne bejme përcjellje të vazhdueshme sipas kontratës, por kurrë nuk kanë intervene ne te.

Hajdar Sutaj

Faleminderit drejtorit Izet.

Izet Zenuni

Monin e çmoj për pyetjet, gjithmonë qe I ka të sakta dhe pa tendencë, në këtë rast nuk ja ki qellu fort te mirëmbajtja gjatë dimrit. Kam respekt shumë e singertë dhe mbi të gjitha pyetjet që i mban me tha, mos e prek jetën e qytetarëve. Te bora që ka ra herën e fundit do të thotë kompania fituese është Lika që ka mirëmbajtjen verore dhe dimërore, domethënë Deçani I ka 386 kilometra asfalt rrugë, që secili krejt këto rrugë kontraktohen per mu mirëmbajtje. Trotualet kan fillu me u pastru ditën e hënë, do të thotë ditën e hënë, më e pastru edhe të martën që të mërkurën ku ka fillu shkolla kanë qenë të pastrume. Të gjitha rrugët e fshatrave, Gjitha rrugët, tuj perjashtu naj degëzim që ka mbet i pa perfundum ditën e 1-rë kur ka ra bore, e deri mbrëmë kanë qenë të gjitha të pastra. Ju qytetaret jeni ju vetë keni mujtë me pa ka pasë në 1 rast të veçantë që ka metë ndonjë rrugë? Janë pastru oborret e shkollave ditën e martë, rrugë deri te qafa, si u shku te shkolla dhe kjo ka qenë e procedurat e koha prej ditës së shtunë deri ditën e mërkurë qe ka fillu shkollat me mësim. Apo për drita më fal, po. Ka ndodhur 2 aksidente e poshtë te Agonisi gaz , jan dy shtylla të dëmtume, e 3-ta është Interexi edhe njo osht te rruga te gjimnazi. Te Agonisi gaz 2 shtylla dëmtume që është vonuar procedura pak për arsye se raporti i policisë ka ardhur kompania sigurimeve, pse aty automjetet ka dalë vendimi zor e ka po domethonë edhe padia që do bejne ri që ka dërgu kompanisë së sigurimit, e cila e ka pranë dëmin që automjetet e ka me pague. E vlerën e dome dhe paguajnë sipas kontrates që e kemi na me kompaninë për mirëmbajtje të 2 shtylla të ndriçimit publik. E besoj që sot ose nesër ata vetëm kompania i ka hek ato shtylla, I ka riparuar dhe me vendos prapë në vend. Do të thotë i kemi 4 shtylla të dëmtume, 2 i kemi të Agonisi gaz, një ball për ball me Interexin e tjetra te rruga “Haki Povataj”.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë, Faton Selmanaj osht lajmëru për fjalë, po Mon a ki diçka shtesë. Oh po gjithsesi zoti Mon Selmanaj e ka fjalën.

Mon Selmanaj

Zoti drejtor ne fshatin Rastavicë, tash po him konkret, ni bashk fshatar imi i ka hap te gjitha rrugët e fshatit edhe rrugën kryesore dhe rrugica, krejt shka ka pasë, por nuk e kam pasë qëllimin këtu. Qëllimi im ka qenë që mu ka duk shumë vonë pastrimi i trotuareve nga Kryqi Carrabregut deri tu Kanali Llukës, deri aty. Prandaj unë për këtë arsye ngrita si çështje që kompania është vonuar ne pastrimin e trotuareve, pavarësisht se nuk e kom dit nxënësat kur e fillojnë mësimin, por edhe për kalimtarë të rastit ata nuk kishin ka u endeshin xhades, rrugës kryesore këmbësorët.

Hajdar Sutaj

Falemnderit skena koment. Faton Selmanaj e pastaj Vatan Istrefaj.

Faton Selmanaj

Faleminderit kryesues. Se pata ne plan hiq te lidhna me temen e pastrimit të rrugëve, por meqë drejtori deklaroi se të gjitha rrugët janë pastruar brenda një kohe shumë të shkurt, kjo nuk qëndron dhe nuk është e vërtetë, sepse siq deklaroi edhe kolegu Mon, jo qe nuk janë pastruar brenda dite, por as të pasnesërmen deri vonë nuk janë pastruar në disa fshatra, sepse edhe na lëvizim jo veq ju. Edhe kjo është shumë e vërtetë edhe po më çuditë fakti që këtë tender e paska një kompani shumë serioze edhe një kompani që ka kapacitet për me kry këtë punë shumë shpejt brenda një periudhe shumë të shkurt. Po si do që të jetë qytetarët le ta vlerësojnë më tutje. Për pyetje se e pata për drejtorin Besnik, e dimë që ka mungesë të kuadrove gati në secilën shkollë, por deklarave që jemi përpjekë me bo zëvendësime të përafërta. Zëvendësimi i përafërt nuk është për shembull me bo me 1 profil të biologjisë me nje profil te fizikes po oshtë komplet e kundërta. Po ashtu ka profile të cilat ka mungesë, por që në konkurset që ju i keni hap nuk janë pranuar, shembull ka mësimdhënës i matematikës që komuna jonë nuk e ka pranuar dhe ai mësimdhënës tashë jap mësim në 1 shkollë në Rahovec. Kështu që kjo është gabim, dhe pyetja është, cili është plani dhe a ka një plan konkret për zgjidhjen e këtij problemi.

Hajdar Sutaj

Falemnderit Faton. Fillimisht drejtori Izet Zenuni.

Izet Zenuni

Legalisht duhet mi përkrahë Monin në këtë rast por realiteti është krejt ndryshe dhe po është normale se e ki bashkëvendas, por realiteti është krejt ndryshe. E konstatimi yt nuk qëndron absolut, nuk qëndron, më vjen keq që del me një konstatim të tillë, por nuk qëndron ajo që thu.

Hajdar Sutaj

Një minutë replikë Faton Selmanaj.

Faton Selmanaj

Faleminderit kryesues, jo nuk është punë lokalizmi, tashme e kemi diskutuar këtë temë, por ka edhe tema të tjera, për shembull është edhe mirëmbajtja verore. Ju jeni drejtorja që mas pakti punojnë në këtë punë. Absolut kam pas kërkesa qysh në vitin e kaluar shembull për mirëmbajtjen verore, krasitjen e drunjve në plot rrugë veçanti në kohën kur vijnë bashkatdhetarët dhe ju si drejtori, absolutisht nuk keni bërë asgjë as për rrugën mbas qe lidhe regjionin e Vokshit asnjë rrugë, plot rrugë të tjera dhe as Prejlep, as plot rrugë, plot rrugë tash mos të lshohna me I përmend se më nuk keni bo asnjë ndërhyrje, pavarësisht që ajo kontratë ka qenë aktive.

Hajdar Sutaj

Falemnderit drejtori Izet Zenuni e ka fjalën shkurt.

Izet Zenuni

Është e qartë, nuk kam nevojë të flas une, flasim punët, flet tereni, flet realiteti i cili është në gjithë territorin e komunës së Deçanit, e ki qytetin ma të paster nivel Kosove, e ke qytetin që ka rrugë të asfaltume ma s'shumi, e ki qytetin që e ka ni qendër, e ka ni infrastrukturë me krahasu me komunat tjera shumë përpara, këto janë gjana që shihen edhe nuk do koment.

Hajdar Sutaj

Falemnderit shum drejtor, jo me fal, drejtori Besnik Hulaj e ka fjalën.

Besnik Hulaj

Nëse ma bon ni pyetje ta kthej ni përgjigje, ndonjëherë nëse dikush e ka t'kryme matematikën edhe osht tu nejt të shpia, ose, ose e njeh ti dikon qe eshte, jo vetëm në Deçan, por në krejt qytetet e Kosovës ka vëndë për me hi në punë, e 2-ta. E 2-ta osht ni rekrutim që bohet,. E 3-ta. Nëse janë disa persona që ju shkrun nëpër diploma, matematikë. Thuaj financiare, nuk osht profesor i matematikës ai, osht kuader ekonomik, nese unë jam gabim, ateher me tregoni ju mua. Matematika osht matematikë, arti osht art, osht mungesë e kesaj ne krejt Kosovë, arti, matematika, fizika jan mungesë në krejt Kosovë. Normal mbaz t'udhëzimit Administrativ dhe ne bazë të ligjit në rekrutim nëse i plotëson kushtet 1 përafërt merret ai, përndryshe nuk merret.

Hajdar Sutaj

Drejtor falemnderit edhe ni pyetje, realisht ni sqarim ne lidhje me përgjigjen qe e dhat ju e ka Faton Selmanaj.

Faton Selmanaj

Faleminderit për pyetjen, për përgjigjen qe e dhat ju drejtor, unë kom edhe ni koment, personi në fjalë është i angazhuar si mësimdhënës në komunën e Rahovecit. Kështu që ju e dini se çka ka ndodh në atë konkurs, nuk po du me qu ma tutje tash.

Hajdar Sutaj

Falemnderit shum, po, Besnik Hulaj, e ka fjalën.

Besnik Hulaj

Unë nuk i kom fajet që ajo u martu në Rahovec e nuk u martua ne Deçan, tash ta kemi ni punë të kuart.

Hajdar Sutaj

Vatan Istrefaj ka fjalën.

Vatan Istrefaj

Falemnderes kryesues, unë kam disa pyetje për drejtorin e shërbimeve publike. Ma sparti drejtor për mirëmbajtjen e rrugëve publike, pra ka rrugë në fshatin Strellec, për shembull, rruga "Miftar Povataj" sosht pastrue hiq ajo, veq kerret që kanë lëvizur kanë bërë pastrimin edhe domethonë pat bo ngrica t'mdhaja t'akullit. Po ashtu tek ndriçimi public, e shoh se shumë qytetarë pot e bojne kërkesa ty direkt në zyrë, pra që po ka defekte gjatë ndriçimit afër shtëpive tyre dhe kështu po më duket se po jau jep nje përgjigje se ka mungesë të materialit shpenzues edhe jon met që disa kohë pa ndriçim në atë pjesë. Po ashtu e kam edhe 1 pyetje rreth Llotit 3, pra që ka qenë për shtrimin e rrugëve dhe rugicave, asfaltim, çfarë po ndodh? A do të përfundojë brenda gjysmës së 1-rë të këtij viti? Pyetja tjetër k ate bej me policët e shtrirë, pra kemi ba kërkesë disa herë si për shembull për Drumin e Telit, në fshatin Strellec e lidh fshatrat, Strellec i ulët, Prapaqani Isniq, Libeniq, e kështu me radhë, pra është 1 numër i madh i aksidenteve që po ndodh në atë pjesë. Kërkesë ka qenë si prej meje si prej qytetarëve, disa here në komunë dhe asnjë herë nuk merret 1 vendim, a po prisni me dekë dikush drejton në ato aksidente a qysh me ja ba drejtor.

Hajdar Sutaj

Falemnderit Vatan drejtori Zenuni ka fjalën.

Izet Zenuni

Faleminderit për pyetjen te ndriçimi public, 1 kërkesë ka ardhë për 1 defekt vitin e kalum 2 dritat që janë dëmtu te rruga ka Bajërat. Nje kërkesë ka ardhur te ajo familje, Ju ka ndrru 2 herë prapë kanë 1 defekt. Problemi është se aty ka ni defect, e s'bashku me KEDS-in dhe kompanitë përfituese të projektit kanë me dalë në teren. Po që është pyetje që disa vende që e lidhin edhe ndriçimin privat, edhe rrymën prej shpije të tyre tuj e lidhë me ndriçim publik. Nuk po aludoj te ajo familje, se aty është në rregull gjithçka. Ata janë njerëz familjarë njerëz të mirë po te ajo dy here është e kryer. Te Lloti 3, është projekt 3 vjeçar, domethonë këtë vit është viti i 2-të që ka filluar, viti i 2-të domethane këtë vit dhe vitin tjetër që është afati i përfundimit të projektit. Te drumi i Telit te Lufaj, te rrethi anej që është parapame për momentin që këta sheh, ne domethënë në mars do të fillojmë me asfaltimin e rrugëve dhe rrugicave. Është e parapame rrethi aty, po edhe pengesat sipas nevojave që vitin e kalum si drejtori kemi marrë ni vrejte prej drejtorisë së rrugëve, në kuadër të Ministrisë së infrastrukturës që mos të jepet pëlqimi për vendosjen e pengesave në përjashtim të institucioneve publike, shkollat, çerdheve, stacioneve dhe objekteve publike. Domethënë ne jemi komuna e më së shumti në Kosovë që kemi lëshu pëlqime të tilla, une personalisht e pëlqej dhe e aprovoi për me vendosë pengesat ne vende ku rrezikohet jeta e njerëzve, qytetarëve, domethonë e prej 380 kilometra rrugë, 300 kilometra kalojnë afër shtëpia të njerëzve që secili e parashihet që mund me pasë rrezikun prej trafikut. Këtë vit te pjesa e Strellcit të Ulet, në momentin që në mars fillon kompania me bo shtrimin e rrugëve e rrugicave, në fshatin Strellc edhe rrethi edhe pengesat ku parashihet prej inxhinierëve të komunikacionit që duhet të vendosen, kanë mu vendosë.

Hajdar Sutaj

Faleminderit drejtor, fjalën e ka Fekri Qufaj.

Fekri Qufaj

Faleminderit kryesues, unë e pata nje pyetje, meqenëse ajo kompania qe e k aba pastrimin e bores ne fshatin Prejlep, mi kanë hjekë edhe polict rrugor, une kam qene edhe ne zyrë te ti per kete gje dhe kekroj te di qysh mendemi me I qitë prap edhe e pata nje kerkese per ndriçim public kurë do ti vjen radha fshatit Prejlep, a kini far liste.

Hajdar Sutaj

Izet Zenuni I ka fjalën.

Izet Zenuni

Unë ja kam adresu ankesen per kete verejte menaxherit te kontrates, e cila ju ka adresu me shkrim kompanise qe me I vendosë ato pengesa ku janë hjekë. Te ndriçimi public, prej te gjitha fshtrave te komunes ma se pari ndriçimi public eshte shtri ne fshatin Prejlep ne rrugen qendra dhe disa rrugica tjera, faza e pare e rrugëve kryesore eshte ne perfundim e siper, ne te gjitha fshatrat ne rruget kryesore, ka fillu faza e dyte e rrugeve dhe rrugicave qe e degëzojnë fshatin prej shkollë ne qender te fshatit, edhe ato rrugica qe jane me prioritet dhe kjo bashk me kryepleqt e fshatit, qe besoj se do te permbyllet brenda ketij viti.

Hajdar Sutaj

Fjalën e ka Vatan Istrefaj.

Vatan Istrefaj

Kryesues pi shof qe e ki ba nje kerkesë per paisje te antarve te kuvendit me Lap topa edhe nuk ja citove drejtoreshes hiq sa ke ketu.

Hajdar Sutaj

Kolegë, meqenëse nuk ka tjerë të lajmëruar për fjalë. Faleminderit për kontributin në ket séance, e shpalli tmbyllur takimin, shihemi në mbledhje të radhës.






KUVENDI KOMUNAL - DEÇAN

Municipal Assembly of Decan

TRANSKRIPTI

DEÇANI

Mbledhjen e Kuvendit të Komunës



DEÇAN, dt.31.05.2024

Kryesuesi I Kuvendit, Hajdar Sutaj

Përshëndetje. Të nderuar koleg. Mirë se keni ardhur në takimin e pestë trregullt të kuvendit të komunës së Deçanit për vitin 2024. Në baz të listës së nënshkrimeve i kemi 25 antar nga gjithsej 27 antar te kuvendit, që nënkupton që kemi korumin e mjaftueshëm për të vazhduar më seancën. Nrend pune e keni materialin të cilin e keni marrë me kohe, por i keni edhe rekomandimet e komitetit për politikë dhe financa. Që kemi 1 ndryshim në emërtim në 2 pika të rendit të ditës. Para se me qit nvotim ju lexoi rekomandimet E Kpf-së që pika e 2-të që është plani për menaxhimin e fatkeqësive natyrore, pas diskutimeve në komitetin për politikë dhe financa, por edhe diskutimeve me drejtorin e shërbimeve publike, zotit Izet Zenuni. Meqenëse planin e punës ka qenë plani për menaxhimin e fatkeqësive natyrore, por në ditën që është formulu rendi i ditës, Drejtori Izet ka qenë 1 udhëtim jashtë vendit. Nashta nuk kem mujt me e pas konsultën e duhur. Kjo pikë quhet miratimi i vendimit për grupin punues për hartimin e planit, për hartimin e planit për menaxhimin e fatkeqësive natyrore. E keni vendim të kryetarit Bashkim Ramosaj të bashkangjitur? Për grupin punues. E këtij grupi punues mundet edhe kuvendi nëse e vlerëson mi shtu antar, por edhe me miratu të tansishme Grupin punues për hartimin e planit për menaxhimin e fatkeqësive natyrore, ndërsa te pika e 3-të Ka qenë plan pune raporti i komisionit për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe hapësira tjera publike. Do të jetë njoftim I komisionit për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe hapësira tjera jopublike. Pastaj e kemi 1 pikë të cilën e ka miratu e komitetit për politikë e financa në mbledhjen e kaluar paraprake edhe këto që ka tbië me kërkesën e Shoqatës së historianëve Ali Hadri. Për ta përkrahur ni aktivitet e tyre në vlerë prej 6.500 euro ose 6.700 euro. Sa të shikoj në materialin se di sakt Atëherë ne më lejoni që ta lexoj këtë propozimin për rendin e ditës.

Nen 1. shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Nen 2. miratimi i vendimit për grupin punues për hartimin e planit për menaxhimin e fatkeqësive natyrore.

Nën 3. njoftim i komisionit për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe hapësira të tjera publike.

Nen 4 e kemi themelimin e komiteteve për shëndetësi, për arsim, për kulturë.

Dhe nën 5 të ndryshme.

Para se me e miratu e renin e ditës, nese ka dikush diçka më thonë për rendin e ditës, ju lus ta marrë fjalën fillimisht Orges Tafilaj. Pastaj Miftar Ahmetxhekaj lus rexin që ta ndez mikrofonin e antarit tkuvendit zoti Orges Tafilaj.

Orges Tafilaj

Fillimisht në plan të punës sipas planit punës ka qenë e paraparë dhe plani i veprimit këshillit rinor lokal. Pse nuk e kemi ket muaj e 2-ta procesverbalet dhe transkriptet e mbledhjes kalume kur do votohen për shkak se u la për shkak të gabimeve drejtshkrimore dhe njëjtin ku e kur duhet marrë procesverbali i mbledhjes jashtëzakonshme që kishin.

Hajdar Sutaj

Falemnderit Orges. E 1 sa i përket planit të punës së këshillit të veprimit rinor lokal na kemi miratu në fund vitin e kalum. Edhe plani po u bojke për ni periudhë 3 vjeçare. Nuk isha domethënë, meqenëse ajo ka qenë miratu. Nashta na nuk e kemi pasur ket informatë dhe kur keni votue planin e punes, mos me pas ne plan pune për këtë Për këtë seanc. E 1 e 2-ta te procesverbalet. Transkriptet në qershor do të jenë të gjitha, ndërsa sa I perket pocesverbalit të mbledhjes së jashtëzakonshme, është i gatshëm. Nuk e kuptoj pse se keni shpërnda. A po a ok. Do të thotë se ç'po thotë edhe sekretarja e kuvendit që ush punu masi që është dërguar materiali për seancë. Po unë e di që ka qenë i gatshëm. Edhe nëse ashtu mundën për me shpërnda edhe tash ose me lanë për seancën e ardhshme. Falemnderit Miftar Ahmetxhekaj.

Miftar Ahmetxhekaj

Kryesues, atëherë përshëndetje për të gjithë. Kryesore me 27 e kam adresuar 1 kërkesë në arkivin e kuvendit te komunës, kërkesë cila si adresuar përmes kryesuesit të kuvendit ju kam drejtuar kuvendit. Unë nuk e di arsyen për vlerësimin tim është brenda afatit ligjor. Nuk e di arsyen pse s'ka ardhur ajo kërkesë e imja në ditën e sotme për të trajtuar. Nëse ka mundësi.

Hajdar Sutaj

Falemnderit koleg Miftar. Po mke njoftuar edhe privatisht. A ka ardh a. E domethënë dje kur jemi taku na ka qenë ora 2. Ne nje ceremoni tvarrimit I jemi takuar rastesisht nuke kam pas deri ather domethonë tashmë, po thot asistente Vjollca që paska ardh po si do që të jet ka ardh dje pasdite dhe me vjen keq domethonë që e kanë vanu me pru. E. Albesa Cacaj.

Albesa Cacaj

Atëherë përshëndetje për të gjithë i nderuar kryesues, kontakto veçantë fund të dhjetorit 2023 është miratuar plani i veprimit rinor lokal veçan edhe sa për gjendjen faktike. Por plani është qeshor 2023 dhe në fund të planit janë të parapara objektiva të cilat duhet të arrihen për gjatë viteve 4 vitet 2023 deri 2026. Domethonë kjo është paraparë në planin e punës dhe të paktën kanë mundur të sjellë pikat ose objektivat janë arritur gjatë kësaj periudhe, sepse 1 objektiva të saktsuara në bazë të viteve për shembull për vitin 2023, e cila qëllime i ka realizuar plani i veprimit, të cilat aktiviteti i ka zhvilluar faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit kolege, kta mundemi me pas si pikë trenit dites raportin e Këshillit veprimit rinor lokal, me pa si e ka zbatu planin e veprimit. Po si pikë që ka qenë e paraparë me plan punës plani i veprimit Këshillit veprimit rinor lokal ka qenë i përfunduar, ndërsa këto që me pasë 1 raport ynë mundën për mjafton seancën ardhshme. Falemnderit dikush tjetër. Po i nderum se Miftar Ahmetxhekaj pastaj Faton Selmanaj.

Miftar Ahmetxhekaj

Falënderit shumë dhe tash unë edhe pak e kam pasur kryesues. Kërkesa që i vjen, por sot asht e pamundshme, mu trajtu në kuvend apo.

Hajdar Sutaj

Mfal propozimin që e pate ti na mundën me kërku me u ba kopje me u diskutu në të ndryshmet, ndërsa antart të kuvendit janë për. Gjithsesi une pyes kuvendin, por meqenëse nuk ka ardh kërkesat dje pas ores 2. Pavarësisht cila ka mujt me kon ashtu kush po i kuvendit këtë rast? Jo për shkak se.

Miftar Ahmetxhekaj

Nashta është faji i zyrës së pranimit absolute, nuk kanë të drejtë mbajë kërkesat për shkak se nuk është organ që shqyrton kërkesa, është organ i cili procedon te institucionet të cilat janë të adresuara. Gjithsesi edhe pse po te kerkoj edhe kisha kërkuar mirëkuptimin e kolegëve asamblesë se nese eventualisht janë mundësi teknike ta kenë si document, nuk ka material shumë dokumenti, ka ni bazë në 1 dokument të cilat paraprakisht e kemi miratuar edhe planin e veprimit në mjedis lokal. Nëse është e mundshme teknikisht kisha kërkuar që në të ndryshme do ta trajtojmë si kërkesë. Faleminderit shumë, kështu, ndryshe, përndryshe mundem edhe me shty me adresu.

Hajdar Sutaj

A nuk premtom koha për seancën është nëse eventualisht? Ok kështu na mundën për me kërku që me bo kopje me shpërnda në fund i pyes antart nese kan vullnetin me diskutue, diskutojmë, un sjom kundër. Faton Selmanaj, për rend dite jem ka diskutojmë ketu.

Faton Selmanaj

Përshëndetje, pata ni pyetje për pikën e 4-të, deri më tani, përveç 2 komiteteve që është komiteti për politikë dhe financa dhe komitetin për komunitete e ligjerisht nuk është leju themelimin. Dhe pyetja është, a lejohet tash, a s'lejohet. Ka ndodhur naj ndryshim, sepse nuk e kam të qartë.

Hajdar Sutaj

Falemnderit, kështu e kuptoj, por ish dasht që kur tvjen reni me diskutu këtu po japim informat shkurt, e keto jan komitete joobligative dhe jon pa pagesë. Edhe mundet me i ba kuvendi nëse ka vullnetin. A ka dikush tjetër diçka me shtu rreth rendit dites, Florim Mataj e ka fjalën. Nëse ke mundësi me afu mikrofoni.

Florim Mataj

Përshëndetje për gjithë, e ngriti kolega nje Kërkesë me shqyrtu. E aprovohet kala kështu që njerëzit i ke arsye pak jemi pak. Kemi kalu m'duket pak ndebat pa kalu nrend tdates që është mirë që propozojmë.

Hajdar Sutaj

Falënderit shumë, atëherë e lus propozuesin që ta lexon se si e ka kërkesën për emertimin e pikës. Nëse jan dakord kolegët, lus Zyrën time që ta bëjnë kopje dhe ta shperndajn materialin, Miftar Ahmetxhekaj e ka fjalën.

Miftar Ahmetxhekaj

Faleminderit shumë kryesues. Kështu, ashtu qysh e kam adresuar për kuvendin komunal të Deçanit si CC ka, kryetari i komunës, Bashkim Ramosaj, e nderuara Dafina Cacaj drejtoreshë për buxhet dhe financa, Ramë Melaj e drejtor për urbanizëm. Përmes kryesuesit, Hajdar Sutaj nga Miftar Ahmetxhekaj, anëtar i kuvendit, lënda është kërkesë për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e 2 projekteve, për rregullimin e hapësirave gjelbra, këndi i lojërave në fshatin Rastavicë, fshatin Isniq, lloji i kërkesës, infrastrukture. Të nderuar kolegë, kërkesa ime ka të bëjë mbështetjen e 1 dokumenti, i cili është miratuar në vitin 2023 me saksisht me 28 të votuar. Kuvendi komunal e ka miratuar në planin lokal të veprimtimit 2023-2028, dokument kyq e derivon nga politika mjedisore që paraqet prioritet mjedisore dhe në bazën e kësaj, si rrjedhojë drejtoria për urbanizëm ka organizuar 1 puntori me datën 27.12.2022 punëtori kjo të cilën e ndoqën anëtarët e asamblesë komunale bashkë me grupet e interesit, ku temë diskutimi ka qenë plani veprimi në mjedis, unë në cilësinë e përfaqësuesit të LDK-së dhe asamblisti nga radhët e PDK-së, Mon Selmanaj, si pjesëmarrës të kësaj punëtorie, parashtruan kërkesa dhe propozime. Rekomandimet tona për 2 projektet, rregullimin e hapësirave gjelbra, këndi i lojërave në fshatin Rastavicë dhe fshatin Isniq.

Ok, kjo është dhe e fundit është, unë e kërkoj paraprakisht të futet si pikë e rendit të ditës. Më pastaj natyrshëm që kërkojnë mbështetje.

Hajdar Sutaj

Falemnderit, Yllarta Thaqi u lajmru për fjalë.

Yllarta Thaqi

Faleminderit, përshëndetje për të gjithë. Mendoj se kërkesa juaj zotëri Ahmetxhekaj duhet kaloi fillimisht përmes KPF-së. Nëse nuk duket është edhe qaq me urgjencë e diskutojmë në muajin ardhshëm, pa kaluar përmes KPF-së, direkt kërkesat këtu nuk vijnë. Falemnderit.

Hajdar Sutaj

Falemnderit Yllarta, Erdogan Dautaj e ka fjalën.

Erdogan Dautaj

Përshëndetje, kjo praktikë nuk është e mirë se unë 7 vjet jam këtu edhe s'është e mirë e tha Yllarta KPF edhe sot e mirë se na jemi 27 asambleist shumë shumë komuna marr edhe kjo praktikë nuk është e mirë dhe tu kisha lute mos me kriju kësaj praktika.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë. Faleminderit shumë, po, Leotrim Hadergjona për rend dite apo. Leotrim Hadergjona e ka fjalën.

Leotrim Hadergjona

E deshta edhe unë të ndërlidhem në këtë temë pak a shumë. Meqenëse kërkesa ka të bëjë kryesisht me përmirësimin e gjendjes nëpër lagje ose fshatra, atëherë nëse është e mundur në koordinim me drejtorinë e financave na me vendosë për jo për kit seancë por ku është rishikimi i buxhetit në qershor e për me propozu në kod buxhetor për me hy për çdo fshat ku kanë lagje të tilla që të bëhet 1 trajtim i njëjtë mos me u nda 2 ose 1 apo për komplet në 1 projekt më dalë në tenderin projektit edhe me ditë saktësisht sa a vlera saj për çdo lagje, çdo fshat kish me qenë ma udhës që mi përfshi të gjitha, jo vetëm 2 lokacione të caktuara.

Hajdar Sutaj

Falemnderit shumë Leotrim, kështu unë muna me qit votim, po mendoj që ish dasht ta lajm për me diskutu mbledhje të KPF-se, mirë po Mon Selmanaj e ka fjalën.

Mon Selmanaj

Faleminderit kryesues. Përshëndetje për ju drejtorët dhe kolegët nga asambleja nuk e pata mendjen me diskutu këtë çështje. Mirëpo, paraqitja e disa anëtarëve, kolegëve këtu nga radhët e AAK-es më detyruan që të them edhe unë një 2-3 fjalë.

Speaker 10

Për qet pikën e fundit që propozoi kolegu.

Hajdar Sutaj

Ani qe pe qes nvotim.

Mon Selmonaj

vetem ni sugjerim e pata vetem 1 sugjerim e pata për kolegët, nbaz rregulloreve dhe statutit, Ju i dini veprimet që mund ti marrim ne si individ apo si grupe të interesit që përfaqësojnë interesat e qytetarëve këtë rast. Ne e kemi drejt me propozu më afate kohore, kemi propozuar një pikë të veçantë për rendin e ditës. Jo. Kur 1 kërkesë vjen me kohë dhe për shkak të neglizhencës së zyrtarëve komunal për të adresuar në vendet e adresuara. Atëherë nuk mbetet faji te anëtarit i kuvendit ose të ne. Në këtë rast ne kemi jemi të vetëdijshëm dhe kemi plot që gjatë séances, çdo seancë pothuajse na vijnë nga 2 3 pika të veçanta, me material aty për aty, për të shqyrtuar dhe për të marrë vendime. Prandaj ju kisha kshillua qe kërkesën në fjalë të futim në rend dite, ne pikën të ndryshme.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë i nderum, nuk esht e vertetë qe esht dorëzu mrena afatit kohor, e dini shumë mirë që tash ja u kallxoj edhe datën dhe ju kam thënë që dej me datën 15 kërkesat i bene. Domethonë eshte ardh kërkesa, masi u përgatitur reni i dits, po si do që të jetë ashtu e kështu fillimisht po du me e mbyll këtë debat për ket pike, se jemi ka folim më shumë sesa që duhet, kush është për me hi kjo pikë nrenin e dits sot. Po ça, veq e qita në votim. Urdhno Faton .

Faton Selmanaj

Përsëndetje kryesues, po është e vërtetë se kemi vendosur disa afate për këto afate nuk janë tu respektu, këtë koment dashta me shtu. Sjan tu rrespektu, janë të ardhur kërkesa në vazhdimësi pas datës 15 dhe tuj trajtu ju. Kështu që ska asgja të keqe nëse trajtohet kjo pike, se e kanë propozuar 2 kolegë.

Hajdar Sutaj

Shumë mirë, shumë mirë kolegë dhe kërkesat e tjera qe jan ardh, unë nuk e thashë që nuk jam mu trajtu kërkesa, por vetëm u kundërpërgjigja nata qe tha, asht ardh ne afat kohor, nuk eshte ardh ne afat kohor, por megjithatë un jam ka e qes nvotim kush a për. Miftar jam tuj shkel rregulloren për ni pik që disa here jam tuj jap argumente unë jam tu e qit nvotim kush a për. Mirë kush kundër? Abstenim. Faleminderit. 11 vota për. Më 12 vota kundër dhe 2 vota abstenim, domethënë nuk oshtë nuk është miratuar për mu diskutuar nren dite, e tani rendi i dites që kemi propozuar, e qes në votim.

1 Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

2. Miratim vendimi për grupin punues për hartimin e planit për menaxhimin e fatkeqësive natyrore,

3 Raporti i komisionit për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe hapësira tjera publike,

4 Themelimi i komitetit për shëndetësi, arsim dhe kulturë,

5 është diskutimi i kërkesës së Shoqates historianëve Ali Hadri edhe

6 Të ndryshme

Kush a për, Falemnderit a ka kundër, a ka abstenim, me 26 vota për, 1 abstenim e kemi miratuar renin e ditës e hapi diskutimin për pikën e 1-rë shqyrtimi dhe miratimi për procesverbalin nga mbledhja e kaluar. Falemnderit, nuk janë lajmru për fjalë e qes në votim kush për. A ka kundër? A ka abstenim. Atëherë ai më 24 vota për me 2 vota abstenim e kemi miratu procesverbalin e mbledhjes kaluar.

Jemi te pika dytë. Miratimi i vendimit për grupin punues, për hartimin e planit për menaxhimin e fatkeqësive natyrore, fillimisht e kisha lut drejtorin e shërbimeve publike, zoti Zenuni ta merr fjalën, faleminderit.

Izet Zenuni

Kryesues, përsëndetje kolegë, Seancën e fundit E kaloni 1 procedurë që duhet grupi punues të kaloj përmes asambleje. Do të thot ka ardh nje propozim vendim prej kryesorit për anëtarët e grupit që këtij grupi mund ti shtohen edhe anëtarë tjerë të kësaj fushe. Kësaj natyre që e parasheh Propozim vendimi që munda 1 pjesë edhe subjektet politike sjellin asamble po edhe institucionet tjera lokale që merren me siguri apo me rreziqe natyrore. Domethënë, si procedurë ne duhet me themelue grupin punues sot me kalu përmes asambleje që dokumenti e shumë shpejt marrë nësa mbledhje mori formën përfundimtare, a ka diçka tjetër në qoftë se ka dikush pyetje.

Hajdar Sutaj

Falemnderit shumë, fillimisht në mes grupeve të subjekteve politike janë, grupi AAK-s, Arjan Dobra e ka fjalën.

Arjan Dobraj

Falemnderit kryesues të nderuar kolegë dhe kolege. Te nderuar drejtor që Jeni prezent këtu, nuk është që kemi diçka për me shut, por besoj që Drejtori Zenuni si kryesues i këtij Formimi tgrupit apo nuk keni kufizim? Po besoj se ka zgjedhur njerëz adekuat që kanë punuar në disa dhe njohim se kemi dhe kolegë dhe bashkëpunëtorë. Epo, besoj që kanë me bo punën e duhur. Nuk kemi diçka me shtu kur vie koha propozimit, apo duhet menjëherë me propozu në anëtar? Nuk e di.

Hajdar Sutaj

Nëse vlerëson kuvendi mundem mi shtu 3 anetar. Po viq shefat e grupeve për –se, Hyrie Dobrunaj.

Hyri Dobrunaj

Përshëndetje për të gjithë. Sa i përket kësaj pike, plani për menaxhimin e fatkeqësive natyrore, kështu shkruan, i kemi dhënë vërejtjet tona edhe në KPF sepse, kjo nuk përputhet me materialin të cilin e kemi marrë. Ne kemi marrë 1 material, i cili është për themelimin e grupit punues, mirëpo nuk e di edhe sa mund me emra, sepse siç po e shohim këtë dokument këtu, ky grup është veç i themelumb. Posti themelumb mos ti zgjedh në kryesuesi dhe anëtarët të caktume dhe nuk e di rolin e kuvendit në këtë dokument me vendim njoftohen po thotë në fund anëtarët e grupit punues dhe arkivi i komunës. Besoj që ka dash me njoftu që anëtarët dhe arkivin e komunës nuk e di asambleja, ka ndonjë rol këtu? Dhe, sa i përket propozimit, atëherë nëse duhet propozuar asambleja, besoj që ndryshe duhet përpilue dokumenti në fjalë, sa i përket planit kur ky grup e punon atë plan, asambleja mundet me diskutu me plotësu ose me e korrigju, falemnderit.

Hajdar Sutaj

Falemnderit kolege, realisht veq sa me tplotsu pak, në dokument po shkruan propozim vendim. O drejtor urdhno.

Izet Zenuni

E tuj mar parasysh rëndësinë e dokumentit, është mirë që me pasë në përmbajtjen e komisionit edhe prej asamblesë komunale, me qenë pjesë e këtij grupi punues, i thonë kuvend si propozim vendim ku është bo rendi i ditës e sqaroi kryesuesin at ditë është emërtuar gabimisht, i ka renditur, ne mbledhjen e kaluar të asamblesë kom thon që sot ka me ardh propozim vendimi për grupin punues me themelue prej asambleje dhe ka qenë shumë e qartë. Duket, por ka qenë mirë që mu përfshi edhe asambleja, pjesë e grupeve, këtij grupi që ka hartuar dokumentin e caktuar, meqenëse është dokument i rëndësisë, beson se edisoni specifike dhe nevojat që duhet, mirëpo si dokument të tillë. Edhe une kisha thone qe me qene edhe ju pjesë e këtij grupi, nëse jeni ju dakord.

Hajdar Sutaj

Falemnderit drejtor, prej vetëvendosjes. Ok zotri, Mon a don ti? Mon Selmanaj e ka fjalën.

Mon Selmanaj

Në diskutimin tim, Mendoj se është e udhës që edhe kuvendi të përfshihet, të jap kontributin e vet në këtë grup punues për hartimin e planit, i cili është mjaft i rëndësishëm për komunën tonë. Nuk e di adresimi i këtij dokumenti. Me këto shka ne posedojmë si material, nuk i adresohet kuvendit për miratim nuk ka bile ni tekst sado i vogël të jetë i shkruar, i adresuar, megjithëse ky dokument kështu dhe nënshkruar nga kryetari, i adresuar siç e potencoi koleg-ja nga LDK-ja. Nuk i adresohet në asnjë formë kuvendit të komunës, prandaj si i tillë si dokument po flas ka shumë mangësi, mirëpo, une mendoj se përderisa kuvendi është vetëm mi qu dhe mi miratu dokumentet. Vendimet propozim vendimet, rregulloret e tjera e tjera. Në disa raste mund të jetë edhe kontribues edhe me anëtarët e vet, për hartimin e planeve të rëndësishme për komunën. Falemnderit.

Hajdar Sutaj

E falemnderit për ni fjalë u lajmëru Leotrimi edhe si antar i kuvendit, e osht lajmruë Hyrie Dobrunaj. Jo e krev Arjani. Mu dok qe u lajmrove për fjalë. Okej Hyrie Dobrunaj. Ok.

Hyri Dobrunaj

Edhe ni plotësim, mos të keqkuptohet që grupi i LDK- së është kundër plotësimit, mirëpo ne jemi kundër përpilimit të këtij dokumenti, Sepse nëse osht dashtë mu plotësu me anëtarët e kuvendit, atëherë titulli është ndryshe. Kërkesë për plotësimin e dokumentit me anëtarët e asamblesë komunale, nuk jemi kundër plotësimit, mirëpo dokumenti si dokument është i paqartë.

Hajdar Sutaj

Faleminderit kolege. Po apo diçka me shtu se është.

Arjan Dobraj

Po kryesues vetëm deshte me konfirmu që jemi të pajtimit që me hy anëtarët kuvendit në komision, për shkak se është mirë me e përcjellë me raportue ku ta di edhe na kemi propozim Leotrim Hadërgjonaj.

Hajdar Sutaj

Faton Selmanaj e ka fjalën.

Faton Selmanaj

Faleminderit kryesues. Pika 2- Plani për menaxhimin e fatkeqësive natyrore, ka qenë si pikë në planin e punës për muajin e kaluar. Ekzekutivi në këtë aspekt ska ba asgjo, tashë në këtë seancë ni muji pas Propozimin për 1 grup punues, i cili ende formulën mos u punu diçka ti. Kshtu qe është më mirë, më është pak më ndryshe dhe drejtori. Edhe ju se sa më thonë që jemi ardh, sepse jemi vlerësuar na tash antar të kuvendit. S'kemi mujt me punu diçka është në rregull.

Hajdar Sutaj

Falemnderit, Faton drejtori Izet Zenuni e ka fjalën.

Izet Zenuni

Ni sqarim t' thjesht dhe mendoj që duhet ti mor pak më. E dokumenti si dokument është i gatshëm. Meqenëse njanar asht zgjidh 1 udhëzim administrativ që ka hartohet plani i reagimit kombëtar që edhe komunat janë pjesë e ekipeve punuese në hartimin e planit të reagimit kombëtar si procedurë ka qenë e do shum q ni grup punues kaloi përmes asambleje të shiqojë materialin, i cili është i grumbulluar dhe është i gatshëm. 99 për qind 1 diskutim publik edhe me mori formën e dokumentit përherë kjo është si procedurë edhe ne mbledhjen e kalume e kam dhan sqarimin Faton që na duhet si procedurë me kalu, me plotësu ligjshmërinë. Dokumenti si dokumentit thuhej se është i gatshëm, por prej grupit punues duhet per mu shiku me mare formën zyrtare përmes asamblesë kur te vjen dokumentin asamble dhe me përfundim që plani i reagimit kombëtar në shtator pritët me qenë i gatshëm. Të gjitha dokumentet e krejt komuna u kan me u mor në shqyrtim që inkorporohen 1 pjesë e tyre. Në planin e reagimit kombëtar, por kjo ka qenë si procedurë dhe e kon diskutua edhe seancën e kaluar.

Hajdar Sutaj

Po Faton tu ka përmend emri dhe ki drejtë 1 minutë, pastaj Florim Mataj.

Faton Selmanaj

Faleminderit kryesues, drejtor, po, meqenëse plan i posaçëm i gatshëm, pse nuk është, nuk usht ardh më herët propozim vendimi për këtë komision? Sepse na e kem kalu edhe afatet, domethonë mujin e kalum në planin e punës ka qenë kjo pikë e rendit të ditës dhe kjo vjen më pas. Pse s'ka ardh ma heret.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Faton Izet zenuni ka fjalën.

Izet Zenuni

E sqarova që me udhëzim administrativ që ka ardhur së fundi, si procedurë duhet grupi punues me kalu përmes asambleje edhe mu plotësua në qoftë se është nevoja edhe prej policisë duhet të marrë miratimin edhe nga asambleja mu bashkangjit edhe policai. Policia me qen pjesë e grupit punues, po edhe anëtarët e asamblesë, por kjo ka qenë vetëm si procedura si dokumenti. Si dokument është i gatshëm thuhej ndodhnin për qind shumë voluminoz, por duhet me kalu po edhe prej anëtarëve të grupit punues po edhe prej asambleje që kur të kalon merr formë ligjore me qenë i gatshëm.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë Florim Mataj e ka fjalën.

Florim Mataj

Komisioni ka qene në përputhje me vendimin, e na mbetet vetëm ta diskutojmë mirë dhe kisha kërku qe herave tjera kur na vinë vendimet, pak te na jepet ni arsyeshmeri edhe n vendim a ka mu votu asambleist si ka me shku procedura. Vendimi është si form e kryme. Morim vendim kisha propozu që ta ndryshojë pak vendimin diskutimeve anëtarët nga 1 përfaqësues.

Hajdar Sutaj

Falemnderit sa antar pi propozojmë prej kuvendit, 3 ose 5. Okej 3 urdhno Arjan Dobraj.

Arjan Dobraj

Mendoj që 5 antar, 3 nga ne, kurse 2 nga opozita. Që të jetë edhe pse jo përbërja, pak ma e madhe e kuvendit ne at formimin.

Hajdar Sutaj

Ok, kush është për 5 antar Falemnderit. Kush është kundër këtij propozimi? Abstenim a ka. Atëhere me 15 vota për dhe 11 vota kundër e miratoi propozimin e grupit të AAK-s. I kisha lut qe nëse keni nevojë për më konsultue mund ta merrni pak pauzë. Ok jepni propozimet prej grupit tAAK-SE dhe opozita 2, 3 nga grupi AAK-se Po Arjan Dobraj.

Arjan Dobraj

Falemnderit kryesues nga AAK ja propozojmë zotëri Leotrim Hadergjonaj Afrim Demhasaj edhe zoti Fikri Qufaj. Dojm me shku komplet merr.

Hajdar Sutaj

Si i nderum veq edhe niher me na e përsërit propozimin.

Arjan Dobraj

Leotrim Hadergjonaj, Afrim Demhasaj, edhe Lendita Berisha.

Hajdar Sutaj

